

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7851 E diel 14 Prill 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**

Bankat tregtare te ne mbajnë rreth 7 miliardë euro, lekë, dollarë dhe valuta të tjera të qytetarëve tanë si depozita. Ato janë baza e ekonomisë së vendit dhe ...

Vijon në faqen 21

Nga **FATOS ÇOÇOLI**

Bankat si pjesë e sigurisë kombëtare



Dje *në* **"FAZ"**

Në botën arabe rrota e historisë po kthehet pas, sepse që nga Egjipti në Algjeri deri në Sudan po e marrin pushtetin ushtarakët. Ata po imponojnë ..

Vijon në faqen 22

Nga **RAINER HERMANN**

Asnjë të ardhme diktaturave ushtarake!



Dy dokumentet për t'u dorëzuar në ISSH

Kompensimi i energjisë për pensionistët, ja si përfitohet

Skeda informuese, përfitimet për nënat me shumë fëmijë. Dosja për kompensimet

Një pensionist për të përfituar kompensim të energjisë elektrike duhet të dorëzojë në ISSH dy dokumente. Vërtetim për pagesën e energjisë elektrike dhe deklarata për kompensimin e energjisë elektrike. Dokumentet duhen dorëzuar nga vetë personi, sipas formatit të ALSSH-së. Përfitues të kompensimit janë të gjitha kategoritë e individëve që marrin pension ...

Në faqeb 6-7

GAZ LOTSJELLES PARA PARLAMENTIT, PD: U PLAGOSEN 15 PROTESTUES OPOZITA 4 ORE NE PROTESTE, PLAGOSEN GAZETARE E POLICE

Lulzim Basha: Demokraci a vdekje. Kryemadhi: Ata që urdhëruan sulmin i kanë hesapet e hapura me shqiptarët. Djali i Sokol Olldashit në protestë



(Në foto) Protesta e djeshme e opozitës

Në faqen 2-5

REAGIMI

Protesta, Rama: PD-LSI parti të verbuara, po ecin drejt shkatërrimit

Në faqen 4

UNIVERSITETI

Pezullohet Mynyr Koni, reagimi: Duan të marrin pronat e UT-së

Në faqen 11

INTEGRIMI

Johanes Hahn: Shqipëria është shembull pozitiv në Ballkan


Në faqen 5

ANTIKRIMI

Goditet banda e prostitucionit në Itali, pranga disa shqiptarëve

Në faqen 10

"MILOSAO"



Jeta ndryshe e Sami Frashërit, ja pse u martua me kunatën e vet

Suplement

Prokuroria regjistron 4 vepra penale, hetim për shpërdorim zyrtarëve të aeroportit

Grabitja në Rinas, një nga autorët iku në këmbë

Admir Murataj, zbulohen miliona investime në prona të patundshme

TURANË - Dy nga pesë grabitësit, të cilët vodhën 6.5 milionë euro në pistën e Rinasit kanë qëlluar mbi Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë, me të cilët u përplasën me armë në afërsi të fshatit Tapizë. Sipas raportit të zyrës operative të Kryeministrit, bën me dije TV



"Klan", jepen detaje edhe për shkëmbimin e zjarrit ku mbeti i vrarë Admir Murataj. Aty sqarohet së një nga grabitësit u ekzekutua, ndërsa një grabitës i dytë është larguar në këmbë, duke qëlluar në drejtim të fshatit Tapizë e Poshtme ...

Në faqen 8-9

PROTESTA OPOZITA

Kreu i PD-së: Largimi i kryeministrit, kushti i panegociueshëm

Protesta, Basha-Ramës: Liri a vdekje, shporru dhe ik

"S'do të ketë pazare politike, as kompromise"

Valentina Madani

Protestë në muzg, por për kreun e opozitës, Lulzim Basha, ky është muzgu i zi i Edi Ramës. Mes protestuesve të shumtë të mbledhur pasditen e djeshme në bulevardin "Dëshmorët e Kombit", përpara godinës së Kryeministrit, Lulzim Basha shprehu bindjen e plotë se, "asgjë nuk e ndal më këtë bashkim, as frika, as gazi lotsjellës, as propaganda nuk na ndan dot, nuk na përçan dot". Kryetari i opozitës u bëri thirrje forcave të rendit, që të hedhin kapelat dhe të bashkohen me popullin në protestë. Basha tha se edhe policia duhet të dëgjojë thirrjen e popullit dhe sipas tij, të bashkohen me thirrjen e tyre "Liri a vdekje". Basha u bëri thirrje shqiptarëve për "të varrosur fenomenin Rama". "Po bie muzgu i zi për bandën kriminale në pushtet. Lumi i sovranit e ka rrethuar ishullin e padrejtësisë si kurrë më parë sonte. Ja ku jeni! Ja ku jemi, më shumë se kurrë më parë, më të bashkuar se kurrë më parë. Më të vendosur se kurrë më parë, më të fortë se kurrë më parë kundër padrejtësisë, kundër korrupsionit. Bashkë me këtë vërshim të paparë e të padëgjuar për Tiranën dhe bulevardin "Dëshmorët e Kombit", me këtë bashkim zemrash dhe vullnetesh, burrash dhe grash fisnike të Tiranës dhe të të gjithë Shqipërisë. Po bie muzgu i zi për bandën kriminale në pushtet. Po bie muzgu i zi për bandën e korrupsionit më të paparë, të padrejtësive dhe krimeve më të përbindshme ndaj shqiptarëve. Që nga koha e pushuesve më mizorë, nuk kanë parë shqiptarët një pakicë dhe një kryekriminel kaq barbar dhe urrejës ndaj popullit të tij. Një njeri që hyn në histori si ai që hodhi gaz në shtëpitë e qytetarëve, në shtëpitë e fëmijëve të tyre, që nisi rruspat për t'u prishur shtëpitë, për të pasuruar veten e tij dhe krimin e organizuar, që e ka ulur në institucionet e republikës sonë. Ky muzg është i bashkimit të bashkimit më të



Kreu i opozitës, Lulzim Basha, dje në protestë

Kryemadhi: Ata që urdhëruan sulmin, i kanë hesapet e hapura me shqiptarët

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, u shpreh dje se në protesta çdo ditë qytetarët shtohen, ndërsa theksoi se çdo mjet që qeveria po përdor për të ruajtur pushtetin tregon fundin e saj. Kryemadhi shtoi se çdo kryeministër që do të vijë në detyrë duhet të bëjë analizë psikologjike, në mënyrë që vendi të mos mbetet në dorë të një sëmuri psikik, duke iu referuar këtu Ramës. "Orari nuk ka të bëjë fare. Të gjitha ditët janë të Zotit, edhe orët. Nuk na kushtëzon dhe detyron njeri. E rëndësishme është që çdo ditë shtohet pjesë marrja e qytetarëve. Nëse 16 shkurti ishte më e madhja, sot mjafton të shohësh se si rrugët e Tiranës buçasin. Çdo mjet që përdor sot qeveria në ikje, tregon fundin dhe rënien. Sa më shumë e zgjat, zgjat vultajin dhe dhimbjen për qytetarët. Çdo kryemi-



nistër duhet të bëjë analizë psikologjike, sepse vendi nuk mund të rrëjë në dorë të një të sëmuri psikik. Të pastrojmë politikën nga krimi. Ne duhet t'u sjellim shqiptarëve ata politikanë që mendojnë për qytetarët", theksoi zj.Kryemadhi. Nga selia e LSI pas mbylljes së protestës, Monika Kryemadhi deklaroi se kjo ishte protesta më e madhe, ndërsa shtoi se kryeministri Rama

ar konturet e çdo partie, të opozitës së bashkuar", u shpreh z.Basha.


SAKRIFICA

Për kreun e PD-së, kjo është dita për të mos bërë më kompromise. "Ne e dimë fare mirë se ky mandat besimi shkollon përtej një rotacioni poli-

tik. Është rizgimi kombëtar i një aspirate për të cilën kemi sakrifikuar shumë, kemi pasur përparime, dhimbje e zhgënjime. Sot është dita që të mos bëjmë kompromise. Nuk duam asgjë më shumë se standardet europiane. Ta dëgjojë bota se nuk ka dhe nuk do të

MESAZHI

"Një popull i tërë i bashkuar për të drejtat dhe liritë themelore, për mirëqenie, nuk mund të mbahet peng as nga Edi Rama, as nga banditët e tij, as nga horrat me uniformë. Ju bëj thirrje, vëllezër dhe motra të Policisë së Shtetit, hidhni kapelat e bashkohuni me ne! Dëgjojeni mesazhin e popullit, liri a vdekje, demokraci a vdekje", u shpreh z.Basha.



Protesta e djeshme e opozitës para Kryeministrit

RUDI EREBARA: T'I JAPIM FUND QEVERISË

Shkrimtari dhe publicisti Rudi Erebara ftoi dje shqiptarët të bashkoheshin në protestën e thërritur nga opozita para Kryeministrit, teksa numëroi edhe arsytet se pse "duhet të jemi të gjithë në protestë". Erebara, njëherësh edhe përfaqësues i Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit, theksoi: "Duhet të jemi shumë, të tregojmë se nuk jemi ne, ata që vjedhin aeroporte, por është qeveria. Nuk jemi ne, ata që mbrojnë krimin, por qeveria dhe me këtë qeveri nuk ka zgjedhje. Të dalim t'i japim fund".

PD: Gjoha 5 milionë për të penguar transportin e protestuesve

Ish-deputeti demokrat, Luan Baçi, pak para nisjes nga Fieri drejt Tiranës denoncoi dje se drejtuesve të mjeteve private dhe atyre të transportit publik u është bërë presion me gjoha deri në 5 milionë për të penguar transportin e protestuesve. Baçi u shpreh i bindur se asnjë lloj presioni nuk do t'i pengojë. "Kanë vazhduar presionet në Fier të protestuesit e 16 shkurtit dhe 16 marsit, duke i thirrur në polici. Janë rreth 140-150 emra të proceduar. Ka presion shumë të madh të drejtuesit e mjeteve private dhe ato të transportit publik. U kanë bërë presion me gjoha 5 milionëshe, nëse do të vihen në dispozicion të qytetarëve për të shkuar në Tiranë. Nuk do të na pengojë asgjë", - u shpreh ish-deputeti i PD-së.

ketë kompromis me ëndërrtonë 'E duam Shqipërinë si e gjithë Europa'. Pengesa e vetme për Shqipërinë si e gjithë Europa është Shqipëria e bërë njësh me krimi, që i ka mbyllur dyert e Integrimin e Europian", deklaroi kreun i PD-së. Sipas tij, nga sot shteti, ligji dhe drejtësia është populli. "Me Edi Ramën nuk ka shtet, por vetëm krim, korrupsion, dhunim të të drejtave dhe liritë tuaja. Ndaj, ne i themi sot nga ky shesh, që sot e tutje ju nuk jemi më shteti, jeni antishteti. Ju nuk jeni ligji, jeni antiligji, jeni padrejtësia. Që sot e tutje ligji, drejtësia, shteti është sovran i derdhur në këtë shesh", - u shpreh kreun i PD-së. Ne jemi në këtë betejë për ju, tha Basha, për të varrosur sipas

tij fenomenin "Rama". "Ne jemi në këtë betejë jo thjesht për kalkulime politike, jemi në këtë betejë për ju, pavarësisht bindjeve politike. Ne jemi bashkë për të varrosur fenomenin 'Rama'. Kushti i panegociueshëm është qeveria tranzitore pa Edi Ramën. Asgjë më pak se standardet europiane. Një popull i tërë i bashkuar për të drejtat dhe liritë themelore, për mirëqenie, nuk mund të mbahet peng as nga Edi Rama, as nga banditët e tij, as nga horrat me uniformë. Ju bëj thirrje, vëllezër dhe motra të Policisë së Shtetit, hidhni kapelat e bashkohuni me ne! Dëgjojeni mesazhin e popullit, liri a vdekje, demokraci a vdekje", u shpreh kreun i opozitës, Lulzim Basha.



Tymuese të zeza, domate, lakra, qumësht e çadra 'ik' mbi Kryeministrinë

Opozita 4 orë protestë kundër Edi Ramës, tension para parlamentit

Hidhet gaz, PD: U plagosën 15 protestues

Valentina Madani

Opozita u rikthye sërish dje në protestë për largimin e Kryeministrit Edi Rama, por më e shumtë në numër përgjatë bulevardit "Dëshmorët e Kombit" duke sfiduar edhe shiun. Qindra mijëra mbështetës të opozitës u mbledhën përpara ndërtesës së qeverisë, me parulla "Rama ik", "Parlament i krimi", "Qeveri e korruptuar". Opozita protestoi për më shumë se 4 orë me sloganin 'Shqipëria ngrihet përpara kryeministrit', ndërsa kërkesat janë po ato, qeveri tranzitore që do të çojë vendin në zgjedhje të parakohshme. Me një bandlerolë të madhe me mbishkrimin "Qeveri e krimi" ishin banorët e Astirit të parët që marshuan drejt Kryeministrit. Punonjësit e policisë e pozicionuar krijuar kordonin rrethues para kryeministrit, ndërsa sipër institucioneve kryesore në bulevard u vunë re edhe snajper. Qytetarët kërkuar dorëheqjen e kryeministrit Rama.



AKUZA
Partia Demokratike deklaroi se: "Nuk janë protestuesit ata që i kanë vënë flakën makinës tek parlamenti. Ajo ishte e vetmja makinë e lënë në zonën e zbratur nga çdo automjet tjetër përveç atyre të policisë dhe të medias. Kjo do të thotë se makina është lënë nga vetë policia, që ta digjnin vetë dhe të akuzonin protestuesit për zjarrvënien".

PD SHPËRNDAN 1 MIJË ÇADRA PËR PROTESTUESIT
Protesta e Partisë Demokratike u shoqërua dje me reshje shiu, të cilat vijuan përgjatë gjithë ditës së djeshme. Lidhur me këtë PD mori masa, duke shpërndarë për protestuesit 1 mijë çadra ku shkruhet slogani "ik". Ndaj pak para nisjes së protestës së paralajmëruar të opozitës së bashkuar në bulevardin "Dëshmorët e Kombit", Partia Demokratike shpërndau për protestuesit edhe çadra, kjo për shkak të kushteve jo të përshtatshme të motit ditën e djeshme. Edhe me çadrat Partia Demokratike është kujdesur të japë mesazhin politik të protestës, ndërsa mbi to shkruhet 'Rama ik'.

Berisha: Rama s'ka shpëtim as në vrimën e miut

Ish-kryeministri Sali Berisha deklaroi dje se kryeministri Edi Rama i ka ditët e numëruara, duke shtuar se Tirana është kthyer në kryeqytetin botëror të protestave. "Kjo protestë do të përmbysë Edvin Zograftin e dytë. Forcë në botë që ta shpëtojë atë nga ky vrull i fuqishëm nuk ka dhe nuk do të ketë. Le të shkojë në shkretëtirat e largëta të Azisë dhe të Afrikës, por ai në këtë vend i ka kohërat e numëruara. Protesta siç e sheh ti ka një vrull të madh në rritje. Sot Tirana është kryeqyteti i botës për protestën. Sot protesta botërore ka për kryeqytet Tiranën. Atë fat që pësoi diktatori dhe junta, atë fat do të pësojë Edi Rama në Tiranë. Rama të jetë i bindur



që edhe në vrimën e miut të shkojë nuk do të mund të shpëtojë nga ky cunam. Një herë ia mbath në shkretëtira, një herë në tunelet e Skraparit"-u shpreh ish-kryeministri Berisha.

Këngët e grupit "Troja" në protesta, vokalisti: Në pushtet festojnë me Çiljetën

Këngëtari i grupit rock, "Troja", Bujar Berisha reagoi dje me anë të një statusi në "Facebook", pasi këngët e tij po përdoren në protestat e ndryshme në Shqipëri dhe në Kosovë. Vokalisti i grupit "Troja" theksoi në statusin e tij, se partitë politike në Shqipëri dhe Kosovë kur janë në opozitë përdorin këngët e këtij grupi, ndërkohë që kur marrin pushtetin festojnë me Çiljetën dhe me Medën. Ai theksoi se asnjë forcë politike nuk merr leje për përdorimin e këngët, të cilët i cilëson si pronë. "Dy fjalë për demagogjinë e partive politike Shqiptarë (Kosovë Shqiptarë)! Kur janë në opozitë përdorin këngët e grupit Troja në protesta kundër qeverisë, e kur e marrin pushtetin, festojnë me Çiljetën e me Medën... Paramendo çfarë reforma mund të bëjë dikush që e përdorë pronën e dikujt pa e pyetur (e vjedh djersën e tjetrit) në të njëjtën kohë që akuzon tjetrin për hajni!", thekson këngëtari. Në protestën e PD-së janë vënë si kolonë zanore, këngët "Mbretëresha Kohë", "Demokraci" dhe "Vendi im", të cilat janë disa nga hitet e grupit Troja.



Djali i Olldashit në protestën e opozitës

Protesta e opozitës grumbulloi dje në shesh këmbësorë, të cilët kërkuar largimin e qeverisë dhe kryeministrit, Edi Rama. Në shesh është vënë re dhe prania e djalit të ish-ministrit të Transporteve, ish-deputetit demokrat, Sokol Olldashi. Glauk Olldashi u fotografua tekna ndiqte tubimin e Partisë Demokratike para godinës së Kryeministrit. Mësohet se Glauk Olldashi ka ardhur nga Anglia për t'u bashkuar mijëra shqiptarëve, të cilët kanë dalë në protestë për të kërkuar largimin e Edi Ramës nga qeveria.

SYMBOLIKA
Në shenjë proteste drejt kryeministrit u hodhën tymuese të zeza, bojë, domate, lakra ndërsa fermerët derdhën qumështin dhe hodhën produktet bujqësore. Fermerët kundërshtojnë skemën e re të TVSH. Tingujt e grupit kosovar "Troja" dhe kënga e tyre "Vendi im" shoqëroi gjatë gjithë kohës protestën e mbërshme të opozitës. Ndryshe nga protestat e mëparshme në të cilat militantët e partive opozitare kanë mbajtur vetëm flamurin kombëtar, dje ata janë shfaqur edhe me flamujt të Partisë Demokratike, ndërkohë që ajo që u vu re ishte mungesa e flamujve të LSI. Por flamujt e PD-së qëndruan vetëm disa çaste në duart e protestuesve ndërkohë që më pas u hoqën nga duart e qytetarëve. Policia krijoi një kordon përpara Kryeministrit për të përballuar çdo situatë që mund të krijohet gjatë protestës së opozitës. Në krahasim me protestat e tjera numri i tyre ishte më i shtuar. Ndërsa organizimi i punës së policisë u drejtua nga zv/drejtori Dhimitraq Ziu.

PËRPLASJA
Situata në bulevardin para Kryeministrit nisi të tensionohet menjëherë pas fjalës së kryedemokratit, Lulzim Basha. Protestuesit

nisën të gjuajnë me kapsolla e tymuese në drejtim të policisë. Gjithashtu, protestuesit kanë kordonin e policisë, dhe u ngjiten në shkallët e kryeministrit. Ata qëndruan gjatë para derës së kryeministrit ndërsa pati shtim të forcave policisë përmes një kordonit shtesë. Protestuesit qëndruan si sfidues ndërkohë që policia bëri thirrje për ruajtjen e qetësisë. Protestuesit në mënyrë simbolike morën shkallët e kryeministrit, por pa goditur derën e godinës që gjë kaloi pa incidente protesta para godinës qeveritare. Mbi muret e godinës së qeverisë u hodh bojë e zezë, domate ndërkohë që në tokë u derdhën bidonët me qumësht në shenjë proteste.

MARSHIMI
Lulzim Basha udhëhoqi turmën e protestuesve drejt parlamentit. Nën kryetari i Partisë Demokratike, Edi Paloka, u bëri thirrje qytetarëve protestues që të ndjekin krye-

demokratit Lulzim Basha në marshimin drejt Kuvendit. Para godinës së parlamentit pati përplasje mes policisë dhe protestuesve, ndërkohë që mbi ta u hodh gaz lotsjellës. Nuk munguan as bombat Molotov. Kishte momente kur u përdor dhe uji mbi qytetarët. Pas përplasjeve për disa minutash ku protestuesit hodhën në drejtim të efektivëve sende të forta, këta të fundit i janë përgjigjur me gaz lotsjellës me qëllim shpërndarjen e turmës. Gaz lotsjellës u hodh edhe në drejtim të Lulzim Bashës dhe krerëve të tjerë të opozitës së bashkuar. Pas hedhjes së gazit, protestuesit e vendosur para parlamentit u shpërndanë. Një makinë me targa AA 703 NT u përfshi nga flakët teksa bëhet e ditur se i përket një kuzhinieri, por që brenda saj kishte rroba policie. Fillimisht zjarri në makinë u tentua që të fikje nga disa protestues, por disa të tjerë e dogjën atë. Mësohet se makina ka qenë me

benzinë, ku si pasojë ka pasur disa shpërthime të vogla. Pas një qëndrimi të gjatë para godinës së parlamentit, protestuesit u grumbulluan në selinë e PD-së nga ky kryetari, Lulzim Basha lajmëroi mbylljen e protestës së mbërshme, por vazhdimin e protestave deri në rrezimin e Edi Ramës nga pushteti. Sipas Bashës fundi i Ramës po afrohet ndërkohë që e akuzoi se u soll si pushtues mbi qytetarët në protestë. "Le ta vazhdojmë këtë betejë pasi jemi të sigurtë në rrugën e lirisimit të vendit nga kriminelët. Nesër me zgjedhje të lira, me zotimin e madh për të ndërtuar mbi gërmadhat e diktaturës kriminale, vlerat e demokracisë, mirëqenien e çdo shqiptari pavarësisht bindjeve politike. Në protestën e 9-të, në 8 javë dhe të 3-tën kombëtare kërkuam largimin e Edi Ramës si kusht i panegociueshëm për zgjedhje të lira", deklaroi z.Basha para selisë së PD-së.

PROTESTA REAGIMET

Përplasja, paralajmërimi i Lleshajt: Dhunë e verbër, autorët do mbajnë përgjegjësi

Rama: PD-LSI parti të verbuara, marshojnë në rrugën e vetëshkatërrimit "Protesta nuk ishte e denjë, por e turpshme"

Kryeministri Edi Rama reagoi për protestën e opozitës para zyrës së tij kryeministore, duke shprehur keqardhje për punonjësit e policisë që kanë mbetur të plagosur. Rama shkruan se ata u plagosën nga goditje qorre të dy partive të verbuara. "Solidaritet me çdo punonjës policie që në ditë si kjo, duhet të përballimet me ekzeset fizike të një politike të dëshpëruar, pa kokë, pa drejtim, pa të nesërme! Keqardhje për policët e plagosur nga goditjet qorre të dy partive të verbuara, që marshojnë në rrugën e vetëshkatërrimit", shkruan Rama në Twitter.

Kryeministri Rama reagoi sërish për protestën e opozitës, që u shoqërua me tensione të shumta. Në një postim në Twitter, Rama shkruan se protesta nuk ishte e denjë, sikurse citohet nga opozitarët, por e turpshme për PD dhe LSI. "Nëse kjo ishte protestë e madhe atëherë filxhani është shkençë. Saliu është astronom dhe pakica është shumicë! Në fakt kjo s'ishte as e madhe, as e denjë po thjeshtë e turpshme për pd/LSI! Këta humbës të pashërueshëm po rrisin çdo ditë fatëruen që do u presë Sovran në 30qershor", shprehet z.Rama. Në një kohë që opozita organizoi një tjetër protestë para godinës së Kryeministrit dhe poshtë zyrës së tij kreu i qeverisë, Edi Rama zhvillon një tjetër vizitë zyrtare jashtë vendit. Pas Kroacisë, ku u mbajt edhe samiti i 16+1, Rama iu drejtua një tjetër shteti, atij të Kuvajtit. Protesta e djeshme ishte e treta e opozitës para godinës së Kryeministrit, përmes së cilës kërkon largimin e kryeministrit Edi Rama. Ashtu si në protestat 16 shkurtit dhe 16 marsit edhe këtë herë Rama nuk ishte i pranishëm në Tiranë. Ndërkohë 1500 efektivë policie ishin të angazhuar në terren për mbarëvajtjen e protestës. Godina e Kryeministrit, nga ana tjetër u blindua me gardh metalik për të shmangur çdo incident të mundshëm në protestë.

PARALAJMËRIMI

Fishekzjarrët e shumta të hedhura në drejtim të policisë nga ana e protestuesve, sollën disa pasoja. Gjatë protestës së opozitës u plagosën 6 efektivë policie dhe 4 protestues. Fillimisht një efektiv i forcave policore është transportuar me ambulancë për në ambientet e Qendrës Spitalore Universitare, për të marrë ndihmën mjekësore. Kjo pasi ai ishte djegur në fytyrë nga fishekzjarret e hedhura, ndërsa ende nuk dihet shkalla e dëgjies. Drejt qendrave spitalore u dërguan edhe 4 efektivë policie të tjerë, për t'u trajtuar nga plagët e ndryshme të



Kryeministri Edi Rama

JEHONA

Protesta e organizuar nga opozita përpara Kryeministrit në Tiranë nuk kaloi pa u vënë re edhe nga mediat botërore. Ndërkohë televizioni prestigjioz 'EuroNews', si dhe VOA (Zëri i Amerikës) po e transmetuan live protestën e shqiptarëve në Tiranë, e cila ka startoi në orën 18:00 të ditës së djeshme.

Ambasadorja gjermane, Schütz: Çdo element dhune përbën vijën e kuqe

Ambasadorja gjermane në Tiranë, Susanne Schütz kërkoi dje që protesta të jetë paqësore, çdo element dhune përbën vijë të kuqe. Ajo bëri thirrje në prag të protestës së opozitës, që ajo të jetë "paqësore, pasi çdo element dhune përbën vijë të kuqe". Thirrjet për shmangjen e dhunës kanë karakterizuar qëndrimin e BE, trupit diplomatik dhe organizatave ndërkombëtare të pranishme në Tiranë që kanë vënë në dukje njëzëri të drejtën themelore të protestës në demokraci, por pa ushtruar asnjë akt dhune dhe shkatërrimi. Për të shmangur aktet e mundshme të dhunës në protestën e së



shtunës që është paralajmëruar se do të fillojë në orën 18.00 dhe do të zhvillohet kur të ketë rënë mbrëmja, janë angazhuar rreth 1300 efektivë të policisë së shtetit, të përqendruar në

mbrojtje të godinës së Kryeministrit, ku në 2 protestat e mëparshme protestuesit kryen akte dhune dhe shkatërrimi", deklaroi ambasadorja e Gjermanisë në Tiranë.

marrë në protestë. Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj reagoi dje pas protestës së opozitës dhe tentativës së demokratëve për të hyrë me forcë në godinën e parlamentit. Lleshaj shkruan se dhuna e verbër po godet institucionet kushtetuese dhe Policinë e Shtetit. "Edhe sot (dje) dhuna e verbër po godet institucione kushtetuese dhe Policinë e Sh-

tetit shqiptar. Plagosja e policëve është një turp dhe shkelje e madhe e ligjit dhe autorët do të mbajnë përgjegjësi", thekson Lleshaj. **REAGIMI**
Zëvendëskryeministri, Erion Braçe publikoi pamjet të protestës së opozitës nga lart, ku thekson se në shesh siguria publike u cenua nga një grup politiqenësh, të cilët

nuk i bënë asgjë shumicës politike. Braçe thekson se opozita ka ngrënë grushte nga politika amerikane dhe ajo gjermane, por pavarësisht këtyre, vazhdojnë të behen me të dhunshëm. "Një grusht politiqenësh të korruptuar, tamam ata që kanë vjedhur duke vrarë e kanë vrarë për t'u mbrojtur, po shkatërrojnë ekonominë tuaj! Atë ekonomi që e keni ngri-

Protesta, presidenti Meta: Të evitohen konfrontimet

Tëksa opozita e bashkuar protestonte para Kryeministrit, erdhi reagimi nga Presidenti Ilir Meta. Kreu i shtetit bëri thirrje për një protestë paqësore dhe kërkoi që të evitohen konfrontimet. "Protesta të vijojë paqësore, të evitohen konfrontimet", shprehet z.Meta. Reagimi i Kreut të Shtetit erdhi pasi protestuesit e opozitës shembën barrierat e rrethimit të Kryeministrit. Megjithëse kanë kaluar në shkallë të godinës, protestuesit nuk kanë bërë përpjekje për të hyrë brenda ndërtesës. Protesta e djeshme nisi rreth orës 18:00. Pas fjalës së mbajtur nga kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, disa protestues çanë kordonin rrethues të policisë para godinës së Kryeministrit, ndërsa nuk kanë munguar tymueset, flakadanët, apo edhe boja e zezë, po në drejtim të Kryeministrit.

Protesta e opozitës, Balla: Përpjekje për të dëmtuar negociatat!

Kreu i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla reagoi me anë të një statusi në 'Twitter' lidhur me protestën e dhunshme të mbajtur nga opozita. Ai shkruan se sinkronizimi i protestës së opozitës në Shqipëri me ato në Beograd dhe Mal të Zi nuk janë koincidence. Sa për protestat e organizuara para Kryeministrit ai shkruan se janë protesta të qarta të organizuara nga disa politikanë të korruptuar kundër Reformës së Drejtësisë, duke u përpjekur të dëmtojnë hapjen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE. "Çfarë koincidence? Në të njëjtën orë 18.00 protesta u organizua në Tiranë, Beograd dhe Mal të Zi (disa qytete). Në Shqipëri janë protesta të qarta të organizuara nga disa politikanë të korruptuar kundër Reformës së Drejtësisë, duke u përpjekur të dëmtojnë hapjen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE", shkruan Balla.

vetë, me mund, djersë e sakrifica të ardhurat tuaja. Për të tjerët, atë ekonomi që ju jep punën e prej saj edhe të ardhurat e përditshme! Mos i falni këta fundërrina që nuk janë si ju, nuk kanë hall të nxjerrin fondin e muajit, të paguajnë rrogat e punëtorëve çdo fund muaji. Janë tamam politiqentë që as e vrasin mendjen për ekonominë tuaj, por po bëjnë çmos të kenë eko-



Nga protesta e djeshme para parlamentit

nominë e tyre! Duan para më shumë, ndaj duan pushtet sa më parë! Pa zgjedhje, sepse e dinë që ju si votoni më kurrrë. Me dhunë! Me dhunë mbi çdo polic të shtetit të angazhuar për sigurinë publike, me dhunë mbi secilin prej jush, ekonominë tuaj e të ardhurat tuaja! Kur ndodh kjo, ligji duhet të mbrojtë interesin publik! Ligji mbi të gjithë!", thekson Braçe.



Komisioneri: Ballkani Perëndimor tani ka një ditare reale të mundësive

Integrimi i Ballkanit në BE, Hahn: Shqipëria, shembull pozitiv!

"Maqedonisë së Veriut t'i hapen negociatat para verës"

Komisioneri i BE-së për Zgjerimin, Johannes Hahn, komentoi ecurinë e vendeve të Ballkanit Perëndimor në rrugën për integrimin në Bashkimin Europian. Në deklaratë, Hahn ka marrë si një shembull pozitiv Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut se si "angazhimi i BE në Ballkan po ndihmon rajonin të ndërtojë një të ardhme më të mirë". Komisioneri për Negociatat e Zgjerimit, Johannes Hahn, shprehet se Ballkani Perëndimor ka një ditare reale për perspektivën e integrimit, duke theksuar se BE, ka kohë që është angazhuar fuqimisht në rajon dhe ka mbështetur të ardhmen e tij si pjesë integrale e Unionit. "Është në interesin tonë të angazhohemi në rajon, pasi kjo e bën BE-në më të fortë. Viti i kaluar ishte thelbësor, pasi u morën vendime historike mbi të ardhmen e Ballkanit Perëndimor. Strategjia e Ballkanit Perëndimor u miratua nga Komisioni Europian. Strategjia ripohon një perspektivë të qartë europiane të rajonit", shpjegon Hahn në një artikull të publikuar në revistën "Parliament Magazine". Ai nënvizon se Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut janë një shembull i mirë se "si angazhimi i BE-së me Ballkanin Perëndimor po ndihmon rajonin të ndërtojë një të ardhme më të mirë". Duke folur për marrëveshjen e Prespës midis Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë, ai është i bindur se shtetet anëtare të BE do të pranojnë përparimin e dukshëm të Maqedonisë së Veriut, duke hapur negociatat e pranimit para verës. Shqipëria është një tjetër shembull pozitiv edhe në rajon, shton ai. "Ballkani Perëndimor tani ka një ditare reale të mundësive. Megjithatë, pranimi në BE është një sfidë, që kërkon përpjekje të forta të përbashkëta. Mbeten ende shumë për t'u bërë. Anëtarët e ardhshëm duhet të respektojnë vlerat e BE-së dhe të punojnë për pajtimin dhe bashkëpunimin rajonal. Përveç kësaj, shtetet anëtare të BE-së duhet të përmbushin angazhimet e tyre në të cilat ata gjithmonë kanë rënë dakord në mënyrë unanime", thekson Hahn.



Komisioneri i BE-së për Zgjerimin, Johannes Hahn

DEKLARATA

"Ballkani Perëndimor tani ka një ditare të hapur mundësish. Megjithatë, pranimi në BE është një sfidë që kërkon përpjekje të mëdha të përbashkëta. Megjithatë ka ende shumë për t'u bërë. Anëtarët e ardhshëm duhet të respektojnë vlerat e BE-së dhe të punojnë në pajtimin dhe bashkëpunimin rajonal. Përveç kësaj, shtetet anëtare të BE-së duhet të përmbushin angazhimet e tyre në të cilat ata gjithmonë kanë rënë dakord në mënyrë unanime", -tha z.Hahn.

Denoncimi i Nikollë Lesit: Policia më dhunoi, tentoi të më arrestonte

Drejtori i të përditshmes "Koha Jonë", Nikollë Lesi denoncoi Policinë e Shtetit se ka ndërhyrë për ta arrestuar, ndërkohë që po shkante në zyrat e redaksisë së medias që drejton. Gazetari dhe drejtori i gazetës "Koha Jonë" Nikollë Lesi në një lidhje të drejtpërdrejtë në "News 24" tha se është dhunuar nga policia. Për shkak të masave të shumta të marra për mbarëvajtjen e protestës, policia kishte bllokuar disa akse rrugore, ndërsa efektivët e policisë rrethuan makinën e Lesit. Megjithatë gjithçka u sqarua, pasi drejtori i "Koha Jonë" telefonoi kreun e Policisë së Shtetit, Ardë Veliu dhe u la i lirë të shkojë në vendin e tij të punës. "Më bllokuan rrugën dhe me dolën para makinës. U kërkova arsyen duke iu shpjeguar se jam gazetar dhe drejtor gazetare e më duhet të shkojë në gazetë, ku rrugica ishte 14 metra më tej se sa më ndaluan. Nuk hanin pykë. Atëherë ngrita zërin. Në moment erdhën mbi 6 policë dhe tentuan me merrnin me forcë nga makina për në polici. Mbylla derën e makinës dhe ndërkohë mora drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Shtetit, zotin Ardë Veliu. Më pas forcat e shumta të policisë ikën. Më lejoni të them se kjo sjellje nuk është aspak korrekte dhe ligjore. Merrret me mend se ç'u punojnë njerëzve të thjeshtë! Nuk është puna për mua pasi jam mësuar në 28 vite si gazetar të përplasem me pushtetet, por më duhet të shtoj se nuk duhet në këtë mënyrë, pasi janë sjellje brutale dhe jo ligjore. Nuk mund të them se i urdhëroi njeri nga lart për mua, pasi nuk kam fakte, porse fryma e pushtetit dhe sidomos e kryeministrit ndaj njerëzve të medias sjell këtë mënyrë reagimi, aq me tepër kur marrin vesh apo ndjekin gazetarët që kritikojnë kryeministrin", tregoi Nikollë Lesi.



AKUZA

"Jam dhunuar nga policia. Ishin 8 deri 10 policë që më kanë dhunuar. Isha në makinën time dhe po ika në redaksi. Policët ishin të tensionuar sapa më njohën. Unë si gazetar po ndiqja protestën. Dolën përpara meje dhe më rrethuan makina policie, Shqiponjat etj", -tha z.Lesi.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 1/165+1-8/1, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 6, FAQE 179, SIPERFAQE 57 M2, ZONA KADASTRALE 8350, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. PËLLUMB META DHE ZNJ. RITA META.
ÇMIMI 3.850.000 LEKË - Data e zhvillimit të ankandit do jetë 09.05.2019.
CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

"Sulmet ndaj policisë, të turpshme"

PS: Lufta kundër krimit po intensifikohet çdo ditë

Kreu i deputetëve socialistë Taulant Balla beson se lufta kundër krimit po intensifikohet çdo ditë, me goditje dhe arrestime. Balla i referohet goditjes së bërtit nga Policia e Shtetit ndaj grupit kriminal në Elbasan. Por, edhe duke u ndalur në reagimin sipas tij, të menjëhershëm e si kurrë më parë ndaj grabitësve në Rinas, Balla, thekson se sulmet ndaj policisë janë të turpshme. "Lufta kundër krimit po intensifikohet çdo ditë, me goditje dhe arrestime, duke hyrë në një fazë tjetër kontrollesh dhe reagimesh parandaluese në mënyrë të dedikuar ndaj të gjithë ata që janë një bezdi për komunitetet, ata që kultivojnë apo shpërnda-



jnë lëndë narkotike dhe që kanë plot precedent të tjerë penalë. Këta s'u duhet të jenë përditë nën presionin goditës të Policisë së Shtetit. Goditja e djeshme e një grupi kriminal me tentakula në disa qytete të Shqipërisë, duhet

të vijojë me goditje dhe arrestime të tjera. Sulmet e përsëritura këto ditë për rastin e "Rinasit" ndaj Policisë së Shtetit janë gjëja më e turpshme. Si kurrë më parë, Policia e Shtetit iu përgjigj grabitjes në mënyrë të menjëhershme, duke u vënë në ndjekje të keqbërësve dhe duke eliminuar organizatorin e grabitjes. Policia e Shtetit iu përgjigj edhe pse përballë nuk kishte disa grabitës të zakonshëm, por një grup të strukturuar kriminal, i armatosur deri në dhembë, i përbërë nga individë tejet të rrezikshëm që kanë qënë në gjendje të arratisen edhe nga burgje të vendeve të Bashkimit Europian", shprehet z.Balla.

SHPLLJE ANKANDI

Zyra Permbarimore "E.G Bailiff Service" me përmbareus gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Ruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 26.04.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: ANKANDI I -rë për shitjen e pasurive të paluajtshme në pronësi të Z. Shpëtim Barjam Boci:
- Trulli me sipërfaqe 2863 m², Nr.pasurie 88/16, Zona Kadastrale nr.2007, Volumi 9, Faqe 107 ndodhur në Jorgucat Gjirkastër, me vlerë fillestare në ankand 86.712 (Gjastëdhjet e tetë mijë e shtatëqind e dytëdhjetë) EURO
- Trulli me sipërfaqe 2317 m², Nr.pasurie 88/25, Zona Kadastrale nr.2007, Volumi 9, Faqe 121 ndodhur në Jorgucat Gjirkastër, me vlerë fillestare në ankand 55.608 (Pesëdhjet e pesëmijë e gjashtëqind e tetë) EURO
- Trulli me sipërfaqe 790 m², Nr.pasurie 88/23, Zona Kadastrale nr.2007, Volumi 9, Faqe 119 ndodhur në Jorgucat Gjirkastër, me vlerë fillestare në ankand 18.960 (Tetëmbëdhjet mijë e nëntëqind e gjashtëdhjet) EURO
- Trulli me sipërfaqe 780 m², Nr.pasurie 88/20, Zona Kadastrale nr.2007, Volumi 9, Faqe 111 ndodhur në Jorgucat Gjirkastër, me vlerë fillestare në ankand 18.720 (Tetëmbëdhjet mijë e shtatëqind e njëzet) EURO
- Trulli me sipërfaqe 1750 m², Nr.pasurie 88/18, Zona Kadastrale nr.2007, Volumi 9, Faqe 109 ndodhur në Jorgucat Gjirkastër, me vlerë fillestare në ankand 42.000 (Dyzet e dy mijë) EURO
Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

bërë thirrje klasës politike shqiptare që të bashkëpunojë për përmbushjen e reformave në vend me qëllim që t'i hapet rruga drejt BE-së. Raportuesi për Shqipërinë në BE, eurodeputeti Knut Fleckenstein pak javë më parë ishte i ashpër në qëndrimin e tij për krizën politike në Shqipëri. I pyetur nëse BE do të ndërhyjë për të zgjidhur situatën e tensionuar politike që ka mbërthyer Shqipërinë, ai tha "jo". "Përgjigja është jo. Mendoj se ka ardhur koha që ky vend të tregojë se mund t'i zgjidhë vetë problemet e veta, theksoni Fleckenstein.

PENSIONET E PLEQERISE UDHEZUESI I ISSH-së

Skeda informuese, përfitimet për nënat me shumë fëmijë dhe ish-të përndjekurit

ISSH: Pensioni i pleqërisë, dokumentet për të përfituar shtesa

Si plotësohet dosja dhe merren kompensimet

Instituti i Sigurime Shoqërore ka përgatitur një skedë informuese për t'u ardhur në ndihmë të gjithë personave që janë në prag pensioni, apo që kanë dalë në pension për të përfituar shtesa që u garanton ligji. Përveç pensionit të pleqërisë, që duhet të plotësohet mosha dhe periudha e sigurimit për ta përfituar, për të marrë shtesa të tjera sipas parashikimeve ligjore duhen plotësuar një sërë dokumentesh. Referuar skedës së publikuar nga ISSH-ja, mësohet se dokumentacioni i detyrueshëm për të marrë pension pleqërie është: fotokopje e kartës së identitetit të vetë personit, certifikatë familjare, e cila merret nga portali "e-Albania" ose DRSSH, certifikatë martesë (kur ka ndryshim mbiemri) nga Zyra e Gjendjes Civile, deklaratat për vitet e punës, vetë personi; librezë pune, librezë kontributesh, vërtetim për periudhën e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, për meshkujt Qendra e Personel- Rekrutimit dhe diploma e shkollës së lartë (e detyrueshme vetëm për femrat).



Foto ilustruese

ISH-TË DËNUARIT POLITIKË

Për rastet e ish-të dënuarve politikë kërkohen dokumente shtesë. Sipas skedës së ISSH-së, personi duhet të përfshijë në dosje vërtetim për faktin e dënimit për motive politike dhe kohën e vuajtjes së tij nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe vërtetim i gjendjes gjyqësore Zyra e Gjendjes Gjyqësore.

NËNAT ME SHUMË FËMIJË

Për nënat me shumë fëmijë, ISSH-ja bën të ditur se

duhet të paraqesin tri certifikata. E para, certifikatë lindjeje e fëmijëve, e cila merret nga portali "e-Albania", ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore; certifikatë martesë e fëmijëve, që merret nga "e-Albania", ose DRSSH. Ndërsa për rastet kur janë ndryshuar gjenaraliteti, përfituesi duhet të bëjë pjesë të dosjes vërtetimin nga njësi administrative/bashkia për ndryshimin e gjenaralitetit dhe vërtetimin nga qendra e fundit e punës për ndryshimet e gjenaralitetit.

PENSIONI SUPLEMENTAR

Personat që përfitojnë dhe përfshihen në skemën e pensionit suplementar për titullin shkencor akademik duhet të paraqesin në ISSH fotokopje të kartës së identitetit, dëshmi për marrjen e titullit shkencor, vërtetim për kohën e gëzimit të titullit dhe vërtetimin për pagën referuese.



Dosja



ISH-USHTARAKËT

Ish-ushtarakët duhet të paraqesin pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore fotokopje të kartës së identitetit, të cilën duhet ta dorëzojë vetë përfituesi i pensionit dhe certifikatë familjare, e cila mund të merret në portalin "e-Albania", ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore.

Ndërsa dokumentacioni i detyrueshëm për të përfituar pension pleqërie, është si më poshtë:

Nr.	Dokumentacioni i detyrueshëm	Institucioni që lëshon dokumentin
1	Fotokopje e Kartës së identitetit	Vetë personi
2	Certifikatë familjare	Portali e-Albania, DRSSH
3	Certifikatë martesë (kur ka ndryshim mbiemri)	Zyra e Gjendjes Civile
4	Deklaratë për vitet e punës	Vetë personi
5	Librezë pune	Vetë personi
6	Librezë kontributesh	Vetë personi
7	Vërtetim për periudhën e Shërbimit të Detyrueshëm Ushtarak, për meshkujt	Qendra e Personel Rekrutimit
8	Diploma e shkollës së lartë (e detyrueshme vetëm për femrat)	Shkolla e Lartë

Dokumentacioni shtesë në rastet e mungesës së Librezës së punës dhe asaj të Kontributëve:

1	Vërtetim nga Qendra e punës për periudhat e punës	Qendra e Punës
2	Vërtetim page, sipas së cilës është derdhur kontribut që nga viti 1994 deri në vitin 2011	Qendra e Punës
3	Vërtetim page, sipas së cilës është derdhur kontribut që nga viti 2012 deri në momentin e lënies së punës	Portali e-Albania, DRSSH
4	Vërtetim i pagesës së papunësisë (asistencë)	Zyra e Punës
5	Vendim gjykatë për njohje vjetërsie në punë	Gjykata
6	Mandat-pagesat për derdhjen e kontributëve	Vetë personi
7	Vërtetim për Pagesën kalimtare (si ushtarak)	Qendra e Punës

Dokumentat shtesë në rastet e përfitimt si ish - i dënuar politik:

1	Vërtetim për faktin e dënimit për motive politike dhe kohën e vuajtjes së tij	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
2	Vërtetim i gjendjes gjyqësore	Zyra e Gjendjes Gjyqësore

Dokumentacioni shtesë për përfitimt e pensionit si nënë me shumë fëmijë:

1	Certifikatë lindjeje e fëmijëve	Portali e-Albania, DRSSH
2	Certifikatë martesë e fëmijëve	Portali e-Albania, DRSSH
3	Certifikatë vdekjeje për fëmijët që jetojnë me prindërit	Portali e-Albania, DRSSH

Dokumentacioni shtesë në rastet e ndryshimit të gjenaralitetit:

1	Vërtetim nga Njësia Administrative/Bashkia për ndryshimin e gjenaralitetit	Zyra e Gjendjes Civile
2	Vërtetim nga qendra e fundit e punës për ndryshimet e gjenaralitetit	Qendra e Punës



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje pajisje dhe aksesori për zonat e sigurisë për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 4,900,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të kenë bërë paraprakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkrahimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje pajisje dhe aksesori për zonat e sigurisë për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 08 Maj 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



Dy dokumentet që duhen dorëzuar në ISSH

Kompensimi i energjisë, si e përfitojnë pensionistët

Një pensionist për të përfituar kompensim të energjisë elektrike duhet të dorëzojë në ISSH dy dokumente. Vërtetim për pagesën e energjisë elektrike dhe deklaratë për kompensimin e energjisë elektrike. Dokumentet duhen dorëzuar nga vetë personi, sipas formatit të ALSSH-së. Përfitues të kompensimit janë të gjitha kategoritë e individëve që marrin pension pleqërie, invaliditeti apo familjar. Instituti i Sigurimeve Shoqërore bën me dije se të sipërpërmendurve iu lind e drejta për të marrë këtë lloj kompensimi në masën 350

dhe 700 lekë individuale që jetojnë në qytet. Ndërkohë, iu jepet masa prej 200 lekësh pensione të pleqërisë, invaliditetit dhe familjare kur përfituesit banojnë në fshat.

Ndërsa, pensionistët e fshatit kur banojnë në qytet përfitojnë 350 lekë. Kështu, për të marrë kompensimin prej 350 lekësh të interesuarit duhet të dorëzojnë: një deklaratë per-

sonale, që plotësohet nga përfituesi pranë Agjencisë Lokale të Sigurimeve Shoqërore, në vendbanimin e tij si dhe një fotokopje e kontratës të energjisë elektrike nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike. "Dokumentacioni që kërkohet për përfitimin e shtesës prej 700 lekëve: a) Dokumentet e përkrahura në pikën 2. b) Certifikatë familjare, kur ka fëmijë në ngarkim, me kusht që ata të jenë deri në moshën 18 vjeç dhe kur vazhdojnë shkollën deri në 25 vjeç, duke paraqitur vërtetimin e shkollës. Kur ka persona në ngarkim mbi këtë moshë, duhet të paraqitet edhe vërtetim nga zyrat e punësimit, nga zyrat tatimore të bashkisë dhe komunave dhe nga zyra e tatimtaksave", - thekson ISSH.



Foto ilustruese

Dokumentacioni shtesë në rastet kur personi ka punuar si kuader në ish-kooperative bujqësore:		
1	Vendimi i emërimit në punë, si kuader	Arkiva e Shtetit
2	Diploma e shkollës së mesme/lartë	Drejtoria Arsimore/Shkolla e Lartë

Dokumentacioni shtesë në rastet e përfitimit të pensionit të reduktuar:		
1	Vërtetim për ushtrim të aktivitetit privat	DRSSH
2	Vërtetim si kërkuar pune	DRSSH

Dokumentacion shtesë për përfitimin e pensionit të minatorit, konform nenit 3, të Ligjit nr. 150/2014:		
1	Fotokopje e Kartës së identitetit	Vetë personi
2	Certifikatë familjare	Portali e-Albania, DRSSH
3	Deklaratë për vitet e punës	Vetë personi
4	Librezë pune	Vetë personi
5	Librezë kontributesh	Vetë personi
6	Vërtetim për periudhën e Shërbimit të Detyrueshëm Usharak	Qendra e Personel Rekrutimit
7	Vërtetim për derdhjen e kontributit suplementar	Qendra e Punës

Dokumentacioni shtesë për kompensimin e energjisë elektrike:		
1	Vërtetim për pagesën e energjisë elektrike	OSSHE
2	Deklaratë për kompensimin e energjisë elektrike	Vetë personi, sipas formatit të ALSSH-së

Për të përfituar një pension suplementar shtetëror, konform Ligjit nr. 8097, datë 21.03.1996, i ndryshuar, duhet paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:		
1	Fotokopje e Kartës së identitetit	Vetë personi
2	Certifikatë familjare	Portali e-Albania, DRSSH
3	Vërtetim i vjetërsisë në shërbim/detyrë/funksion	Qendra e Punës
4	Vërtetim i pagës referuese të detyrës/funksionit	Qendra e Punës
5	Fotokopje e Librezës së punës	ALSSH
6	Vërtetim i gjendjes gjyqësore	DRSSH

Dokumenta shtesë për pension suplementar si ish-ushtarak, konform Ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009, i ndryshuar:		
1	Fotokopje e Kartës së identitetit	Vetë personi
2	Certifikatë familjare	Portali e-Albania, DRSSH

Dokumenta shtesë për pension suplementar si pilot, konform Ligjit nr. 9128, datë 29.07.2003, i ndryshuar:		
1	Fotokopje e Kartës së identitetit	Vetë personi

Dokumenta shtesë për pension suplementar si efektivi lundrues i nëndetëseve, konform Ligjit nr.9361, datë 24.03.2005:		
1	Fotokopje e Kartës së identitetit	Vetë personi

Dokumenta shtesë për pension suplementar për titull shkencor akademik, konform Ligjit nr. 10139, datë 15.05.2009:		
1	Fotokopje e Kartës së identitetit	Vetë personi
2	Dëshmi për marrjen e titullit ose vërtetim për marrjen e titullit shkencor	Komisioni i Kualifikimit Shkencor/Komisioni i Vlerësimit të titujve
3	Vërtetim për kohën e gëzimit të titullit	Qendra e Punës
4	Vërtetim për pagën referuese, në zbatim të Ligjit nr. 10139, datë 15.05.2009	Qendra e Punës

PËRFITUESIT

a) Kryefamiljarët që përfitojnë pension invaliditeti shtetëror dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar në sektorin publik ose të vetëpunësuar në sektorin privat.

b) Kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie shtetëror dhe jetojnë të vetëm, ose kanë fëmijë në ngarkim, të cilët janë pa të ardhura.

Dokumentacioni që kërkohet:

a) Deklaratë personale që ndodhet pranë Agjencive Lokale të Sigurimeve Shoqërore.

b) Fotokopje e kontratës të energjisë elektrike, lidhur midis OSSH-së dhe personit.

c) Certifikatë familjare;

d) Për fëmijët mbi moshën 18 deri në 25 vjeç, vërtetim që vazhdojnë shkollën.

MINATORËT

Personat që përfitojnë pension minatorit duhet të paraqesin në ISSH fotokopje të kartës së identitetit, e cila dorëzohet nga vetë personi, certifikatë familjare, deklaratë e viteve të punës, librezë pune dhe kontributesh vërtetim për periudhën e shërbimit të detyrueshëm ushtarak vërtetim, për derdhjen e kontributit suplementar.



info@primall.al

www.primall.al

Shoqëria PRIMALL shpk, distributor i autorizuar për Shqipërinë e markave të kompanisë ndërkombëtare "JT International", njofton mbi cmimin e produktit të ri që do tërëtohet duke filluar nga data **15/04/2019** i cili është si më poshtë

Marka	Cmimi perfundimtar me date 15 Prill (TVSH e perfshire)
Winston XStyle Silver Long	230

Njoftimi behet ne perputhje me udhezimin Nr.6 date 30/01/2015 te Ministrise se Financave "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar)

Rr.Brahim Rugova
Pallati Kontakt nr.10, kati 4
1000 Tirana, Albania
t. +355 44 500 909
f. +355 44 500 910

GRABITJA NE RINAS HETIMET

Organi i akuzës, hetim për shpërdorim detyre për zyrtarët e Rinasit

Grabitja e 6.5 milionë eurove në Rinas, një nga autorët u largua në këmbë

Ngjarja e rëndë në aeroport regjistrohet nga Prokuroria e Krimeve të Rënda për 4 vepra penale

TIRANË

Dy nga pesë grabitësit, të cilët vodhën 6.5 milionë euro në pistën e Rinasit kanë qëlluar mbi Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë, me të cilët u përplasën me armë në afërsi të fshatit Tapizë. Sipas raportit të zyrës operacionale të Kryeministrit, bën me dije TV "Klan", jepen detaje edhe për shkëmbimin e zjarrit ku mbeti i vrarë Admir Murataj. Aty sqarohet se një nga grabitësit u ekzekutua, ndërsa një grabitës i dytë është larguar në këmbë, duke qëlluar në drejtim të fshatit Tapizë e Poshtme, e cila të nxjerr në rrugën kombëtare Fushë Krujë-Kamëz. Gjatë ndjekjes është marrë informacion se autorët janë larguar me një furgon të bardhë drejt Fushë-Krujës. Por, edhe në këtë dokument nuk sqarohet nëse grabitësi i dytë është plagosur gjatë shkëmbimit të zjarrit. Në raport sqarohen edhe veprimet e Autoritetit Civil. Ky institucion është njoftuar nga koncessionari që menaxhon aeroportin e Rinasit në orën 15:30 minuta, pra 33 minuta pas grabitjes. Interesante është që ditën e ngjarjes një grup i Drejtorisë së Mbrojtjes në avion, po kthehej në Tiranë pas një inspektimi të planifikuar. Pasi morën dijeni për atë që kishin ndodhur, ata u kthyen përsëri për të qenë pjesë e komitetit të emergjencës, i ngritur nga TIA. Po sipas të dhënave të Aviacionit Civil, TIA ka bërë një raport ngjarjeje të paplotë. Aviacioni Civil i ka renditur në raport disa problematika të vazhdueshme që ka koncessionari. Kompania që siguron perimetritin e brendshëm të aeroportit ISTS ka mungesa patrullash, cilësia e rrethimit është e dobët, mungesë kamerash sigurie, mungesë ndriçimi. Ajo që është më shqetësuesja në raport është se TIA ka refuzuar vazhdimisht kërkesat e Aviacionit Civil për përditësimin e programit të sigurisë. Ndërsa në



Admir Murataj



Policia në ndjekje të grabitësve

të gjitha testet e sigurisë bërë nga policia dhe Aviacioni Civil, TIA ka dështuar.

HETIMI

Prokurorët e Krimeve të Rënda, Klodian Braho dhe Arenc Çela, që po hetojnë grabitjen e ndodhur në aeroportin "Nënë Tereza" shkuan paraditen e së premtes në zyrat e aeroportit. Organi i akuzës e ka regjistruar grabitjen e Rinasit me 4 vepra penale: "Vjedhje me armë të bankave ose arkave të kursimit", në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, "Vrasje e punonjësit të policisë", e mbetur në tentativë,

"Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve e municioneve", si dhe "Shpërdorim detyre". Vepra e fundit, sipas burimeve, është regjistruar për të vendosur para përgjegjësisë strukturat dhe zyrtarët përgjegjës të institucioneve që kishin përgjegjësi për të garantuar sigurinë në Aeroportin e Rinasit pa lënë jashtë verifikimit edhe tri bankat që u grabitën menjëherë pasi kishin dorëzuar në aeroport 6.5 milionë euro, që do të transportoheshin më pas nga Shqipëria drejt Vjenës. Burime nga prokuroria thanë se janë rihapur dos-

AKUZAT

Prokuroria e Krimeve të Rënda e ka regjistruar grabitjen e Rinasit me 4 vepra penale: "Vjedhje me armë të bankave ose arkave të kursimit", në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, "Vrasje e punonjësit të Policisë", e mbetur në tentativë, "Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve e municioneve", si dhe "Shpërdorim detyre".

jet e pezulluara për Admir Murataj, i dyshuar edhe për 3 grabitje të tjera, por që çështja nuk u gjykua ndaj tij, pasi ai rezultonte në kërkim ndërkombëtar.

Rihapja e dosjeve për grabitësin e vrarë gjatë shkëmbimit të zjarrit me policinë po kryhet për të verifikuar edhe një herë personat e tjerë që përmenden aty, disa prej të cilëve janë të paidentifikuar e disa të tjerë janë në kërkim. Oficerët e Prokurorisë për Krimet e Rënda kanë sekuestroar të gjithë praktikën, që është ndjekur nga ky institucion në grabitjen e së martës në pistën e avionëve. Ndërsa, Policia e Shtetit vazhdon të jetë në vendet e ngjarjes duke mbledhur prova të reja. Detyrat e prokurorëve që janë pjesë e hetimit janë të ndara. Grupi hetimor përbëhet nga tre prokurorë, ku njëri prej tyre do të ketë detyrë hetimitin e zyrtarëve të aeroportit apo institucioneve shtetërore, të cilët dyshohet se kanë shpërdoruar detyrën. Ndërsa dy prokurorët e tjerë janë fokusuar te zbulimi i bashkëpunëtorëve të Admir Muratajt dhe zbardhjen e dinamikës së ngjarjes, sidomos episodit e shkëmbimit të zjarrit me grabitësve dhe policisë, ku u ekzekutua edhe Murataj.



Grabitësit me armë në aeroportin e Rinasit

RIHAPJA E DOSJEVE

Burime nga prokuroria thanë se janë rihapur dosjet e pezulluara për Admir Murataj, i dyshuar edhe për 3 grabitje të tjera, por që çështja nuk u gjykua ndaj tij, pasi ai rezultonte në kërkim ndërkombëtar. Rihapja e dosjeve për grabitësin e vrarë gjatë shkëmbimit të zjarrit me policinë po kryhet për të verifikuar edhe një herë personat e tjerë që përmenden aty, disa prej të cilëve janë të paidentifikuar e disa të tjerë janë në kërkim.



Gazeta gjermane "Bild": Pas vrasjes së Muratajt, do të ketë hakmarrje?

GJERMANI - Media e njohur gjermane "Bild" shkruan detaje mbi vrasjen e grabitësit Admir Murataj. Kjo media gjermane ka postuar fotografi nga varrimi i Muratajt në Tropojë. "Udhëheqësi i grabitësve, Admir Murataj u vra nga policia. Ai u varros të premtën në vendlindje", shkruan media në fjalë. "Bild" në një postim të ngjashëm dhe po për të njëjtën ngjarje, ngre një pyetje: "A do të ketë hakmarrje?". Gazeta gjermane nënvizon se vëllai i Admir Muratajt është betuar për hakmarrje, ndërsa citon fjalët e tij: "Nëse grabitësit e tjerë që lanë vëllanë tim në mes të rrugës, e hodhën në lumë, nuk gjenden nga policia, do t'i gjejmë vetë". Pak ditë më herët, grabitës të armatosur sulmuan Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit. Ata morën afërsisht 10 milionë euro prej andej, ndërsa gjatë aksionit, policia vrau Admir Muratajn, organizatorin kryesor, 47 vjeç. Admir Murataj, i cili mbeti i vrarë para pak ditësh ka përdorur plot 13 identitete për t'u shmangur drejtësisë shqiptare dhe asaj greke. Ai zotëronte edhe një pasaportë false greke me identitetin Christos Papadias. Krahas këtij identiteti, Admir Murataj përdorte edhe identitete të tjera. Në Shqipëri, ai rezultonte në kërkim me identitetet Nikaj dhe Murataj, kurse me të tjerat në shtetin grek. Admir Murataj ka qenë në kërkim edhe në Greqi për disa ngjarje kriminale, për grabitje bankash e bankomatesh me vlerë 2 milionë euro, për vrasje dhe për arratisje nga burgu i Trikalas në vitin 2013 së bashku me 10 persona të tjerë.

Më 4 mars 2019, Krimet e Rënda identifikuan seri pronash të blera në vitet 2008-2016

Hetimi i Admir Muratajt ekspozon pastrimin e "thasëve me para" në prona të patundshme

Transaksione të tjera multimilionëshe dyshohet se janë kryer nga ish-bashkëshortja e Muratajt

TIRANË

I kërkuar në Greqi dhe Shqipëri, Admir Murataj, akuzohet se organizoi grabitjen e mbi 7 milionë eurove në tri goditje ndaj bankave dhe investoi miliona në blerjen e pasurive të patundshme para se të mbetjet i vrarë gjatë grabitjes së katërt dhe më të madhe në Rinas. I arratisur nga një burg grek në vitin 2013 dhe prej gjashtë vitesh në ilegalitet në Shqipëri, Admir Murataj akuzohet se realizoi tri grabitje bankash dhe investoi miliona lekë në pasuri të patundshme para se të mbetjet i vrarë në goditjen e tij të katërt dhe më të madhe, të 9 prillit, në aeroportin ndërkombëtar "Nënë Tereza". Prokuroria e Krimeve të Rënda e akuzon 46-vjeçarin me origjinë nga Trojopa si "trurin" e një grupi të strukturuar kriminal, përgjegjës për grabitjen e armatosur të rreth 7 milionë eurove në ngjarjet e 13 shkurtit 2015 pranë stacionit të Trenit në Tiranë si dhe dy grabitjet e tjera të ndodhura në afërsi të Qafë-Kasharit në dhjetor 2015 dhe shkurt të vitit 2017.

Të dhënat e siguruar nga BIRN përmes një hetimi pasuror të kryer nga Prokuroria e Krimeve të Rënda ngrënë dyshime se si një ndër personat më të kërkuar në Shqipëri dhe në Greqi arriti të kryente grabitjet të sofistikuara dhe të pastronte shumta të konsiderueshme parash, pa u diktuar nga institucionet e zbatimit të ligjit. Hetimi i Prokurorisë së Krimeve të Rënda tregon gjithashtu detaje nga tri grabitjet e mëparshme të bankave, shumata e sakta të parave të zhdukura si dhe skemën thaujse të njëjtë të përdorur nga grabitësit, suksesi i të cilëve duket se qëndronte tek "informacioni" mbi transferat bankare.

Admir Murataj ishte grabitësi i vetëm i paarrestuar gjatë operacionit policor të vitit 2017, ku nëntë anëtarët e tjerë të bandës, mes të cilëve edhe vëllai i tij, përfunduan në prangat e policisë. Në mars 2019, Gjykata e Krimeve të Rënda i dënoi ata me 104 vjet burg në total për tri grabitjet e parave të bankave. Më 4 mars 2019, prokurorët e Krimeve të Rënda, Ened Nakuci dhe Manjola Kajana nisën procedimin pasuror mbi bazën e ligjit "Antimafie" ndaj Admir Muratajt, vëllait të tij, Aleksandër



Murataj dhe familjarëve të tjerë. Nga ky hetim u identifikuan një seri trojesh, apartamentesh dhe makinash, të cilat u sekuestruan nga Prokuroria e Krimeve të Rënda. Admir Murataj akuzohet si organizatori kryesor i grabitjes së armatosur të ndodhur më 9 prill 2019 në barkun e avionit të "Austrian Airlines", në pistën e aeroportit të Rinasit. Ngjarja nxori në dritë problemet e rënda të sigurisë në aeroport, si dhe shkaktoi përplasje mes qeverisë dhe kompanisë koncesionare për përgjegjësitë. Sipas një njoftimi të policisë, Murataj, i cili në pamjet e rrjedhura në media u shfaq me një maskë silikoni në kokë, mbeti i vrarë gjatë shkëmbimit të zjarrit me Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë. Autorët e tjerë të grabitjes së të paktën 5 milionë eurove i shpëtuan ndjekjes policore dhe mbeten të paidentifikuar.

GRABITJET E "THASËVE ME PARA"

Procedimi penal i Prokurorisë së Krimeve të Rënda për hetimin pasuror të familjes Murataj bazohet te hetimi i kryer për tri grabitjet e bankave, ndërkohe që këto të fundit po tentonin të transportonin valutë drejt aeroportit të Rinasit përgjatë viteve 2015-2017. Procedimi penal ndaj Muratajt nuk përfshin grabitjen e parë brenda pistës së aeroportit të Rinasit, e ndodhur në fund të qershorit të vitit 2016 dhe ende pa autorë. Të dhënat e siguruar nga hetimi i prokurorisë tregojnë se katër banka të nivelit të dytë në Shqipëri kanë humbur mbi 7 milionë euro së bashku nga tri grabitjet e mëparshme që mbajné vulën e Admir Muratajt. Megjithatë, valuta fizike e grabitur përbëhet më së shumti nga poundi britanik, franga zvicerane si dhe dollarët kanadezë dhe australianë. Grabitja e parë e reali-

zuar nga anëtarët e grupit të Admir Muratajt ndodhi më 13 shkurt 2015, kur "Union Bank" vendosi të transferonte një shumë të konsiderueshme valute në drejtim të bankës "Raiffeisen" në Vjenë të Austrisë. Por, punonjësit e sigurisë u sulmuan ndërsa ndodheshin ende brenda tunelit të bankës në zonën e Stacionit të Trenit nga grabitësit e armatosur. Sipas hetimit të prokurorisë, vlera e destinuar për transport ishte 900 mijë franga zvicerane, 800 mijë paund britanikë dhe 16 100 euro.

"Paratë ishin të paketuara në katër qese me peshë totale 49.80 kilogramë", thuhet në kërkesën e Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Me hapjen e qepenit të tunelit të bankës, punonjësit e sigurisë u gjendën nën sulmin e befte të tre grabitësve të armatosur. Personi qëllor një herë të vetme. Së bashku me katër thasë, me mjetin e eskortës, ata u larguan. Mjeti u gjet më vonë i braktisur në rrugën "Sulejman Vathi", në Tiranë. Grabitja e dytë, e ndodhur në 3 dhjetor 2015 shënjestroi transferimin drejt Rinasit të parave të bankës "Credins". Sipas Prokurorisë, këtë herë vlera e parave të grabitura ishte më e madhe.

"Dërgesa përbëhej prej 1 800 000 paund britanikë, 800 000 dollarë amerikanë, 200 000 dollarë kanadezë dhe 200 000 dollarë australianë...", thuhet në kërkesën e prokurorisë.

Gjatë udhëtimit në drejtim të Rinasit, poshtë Qafë-Kasharit, në kryqëzimin ndërmjet rrugëve të Ishatrave Bërxull, Domje dhe Laktas, mjeti të blinduar u përerrua nga një fuoristradë me ngjyrë ulliri, me fenelinë policie dhe xhama të zinj. Personat e zbritur nga mjeti, të maskuar, të armatosur dhe të

veshur me uniformë policie qëlluan me armë dhe me ndihmën e një varreje çanë xhamin e blindit dhe hapën derën. Personat e armatosur morën sasinë e parave të ndodhur në blind dhe u larguan. Makina me të cilën ata udhëtonin u gjet e djegur vetëm pak kohë më pas pranë Urës së Limuthit.

Grabitja e tretë e ndodhur më 9 shkurt 2017 ka të njëjtin skenar me të mëparshmen. Vetëm se këtë herë, valuta që po transferohej jashtë vendit i përkiste Bankës Kombëtare Tregtare.

Transferta përbëhej nga 2.4 milionë euro, 200 mijë dollarë amerikanë, 260 mijë paund si dhe 85 mijë franga zvicerane dhe nga 30 mijë dollarë australianë dhe kanadezë. Sipas prokurorisë, paratë ishin të paketuara brenda tetë thasëve.

Eskorta e bankës u sulmua sërisht në afërsi të Urës së Kasharit, pranë universitetit "Epoka", ku një makinë "Jeep" me xhama të zinj u përplas me makinën e parë në radhë.

"Persona të armatosur, të veshur me uniformë policie dhe me maska zbritën dhe qëlluan me armë, goditën me varre xhamin e blindit dhe me një gur fresibël, hapën kasafortën e morën paratë. Ata u larguan me mjetet e tyre, të cilët u gjetën të djegur ditën e ngjarjes, në fshatin Gjec-Fushë", thuhet në kërkesën e prokurorisë.

"PASTRIMI I PARAVE"

Procedimi penal i datës 4 mars 2019 i Prokurorisë së Krimeve të Rënda ka identifikuar një seri pronash të rrethit të ngushtë familjar të Admir Muratajt, të blera përgjatë viteve 2008-2016, të cilat Prokuroria e Krimeve të Rënda i ka sekuestruar tashmë. Ndërkohë, transaksione të tjera multimilionëshe dysho-

het se janë kryer nga ish-bashkëshortja e Muratajt apo në emër të personave të tretë, edhe gjatë kohës kur ky i fundit ndodhej në kërkim.

Dokumenti i prokurorisë tregon se janë sekuestruar tashmë një apartament me sipërfaqe 100 m², një garazh si dhe një sipërfaqe trualli në Yzberisht të Tiranës, blerë nga Aleksandër Murataj me vlerë rreth 70 mijë dollarë.

Ndërsa në emër të Admir Muratajt është e regjistruar vila dykatëshe në fshatin Prezë të Vorës si dhe një sipërfaqe trualli e blerë në vitin 2016.

"Aktualisht në këtë banesë nuk banon asnjëri dhe herë pas here shkon bashkëshortja e shtetasit Admir Murataj, e cila bën pastrimin e kësaj ndërtese", deklaroi prokuroria.

Prokuroria ka gjetur gjithashtu se pjesa më e madhe e pronave është blerë nga Albana Alidhima, divorci i së cilës me Admir Muratajn shihet me dyshim nga hetuesit.

Sipas kërkesës së prokurorisë, në emër të saj janë sekuestruar një apartament 71 m², i blerë për 3.6 milionë lekë në vitin 2013 në Sarandë, një apartament i dytë në Sarandë me vlerë 90 mijë euro si dhe një truall prej 608 m² në Mjull Bathore, i blerë për 1.2 milionë lekë. Megjithatë, prokuroria dhe policia dyshojnë se në emër të Alidhimës janë blerë prona të tjera të patundshme në Tiranë, të cilat dyshohet se janë regjistruar në emër të personave të tjerë.

"Një rrugë operative është mësuar se ish-bashkëshortja Albana Alidhima ka blerë një apartament në rrugën 'Mihal Grameno' në Tiranë në vlerën 185 mijë euro si dhe posedon edhe pasuri të tjera që nuk janë regjistruar në emër të tyre", thuhet në një raport të policisë, të dorëzuar në Prokurorinë e Krimeve të Rënda.

"Kjo shtetase ka lidhur disa kontrata për prenimin apartamentesh si dhe ka një vilë trekatëshe në zonën e ish-repartit 3700", shtohet në kërkesë.

Prokuroria e Krimeve të Rënda ka gjetur gjithashtu transaksione bankare me vlerë mbi 90 mijë euro të kryera përgjatë viteve 2014-2016 si dhe ka sekuestruar 8 automjete dhe një motocykletë në pronësi të vëllezërve të Admir Muratajt.



47-vjeçari Murataj, i dyshuar për grabitje edhe në Kosovë

TIRANË - Prokuroria e Krimeve të Rënda ka njoftuar Admir Muratajn se më 16 maj do të niste gjyqin ndaj tij për grabitjet e kryera që nga viti 2015. Ndërkaq, 47-vjeçari nga arratia u kundërpërgjigj me grabitjen spektakolare të 9 prillit në aeroportin "Nënë Tereza". Ndërkaq, mësohet se prej më shumë se 3 muajsh, ai ishte i dyshuar edhe nga policia kosovare për grabitjen e bankave në Prishtinë e Istog ku mbeti i vrarë dhe një polic. Gjithashtu, mësohet se autoritetet kosovare kanë kërkuar nga pala shqiptare që të intensifikojë hetimet për kapjen e tij, pasi ka genë i dyshuar edhe si pjesë e grupit që grabiti më 3 dhjetor 2018 një bankë në Prishtinë. Kosova do të tronditej sërisht pak javë më pas nga grabitja e një banke dhe vrasja e efektivit të policisë, Izet Demaj, në Istog tekta u përball me grabitësit. Por përgjimet, hetimet, kontrollet në disa zona të vendit nuk kanë dhënë rezultat dhe Murataj do të rikthehej sërisht këtë herë më 9 prill 2019 në aksin e tij të preferuar, Tiranë-Rinas e pikërisht në aeroportin e Rinasit. Kjo grabitje ka ndodhur pikërisht kur Prokuroria e Krimeve të Rënda kishte njoftuar në arrati Muratajn për ngritjen e akuzave zyrtare ndaj tij.

Kishin 30 apartamente në mbarë Italinë, në qytete të ndryshme

Goditet banda e prostitucionit në Itali, ka edhe shqiptarë

Rrjeti udhëhiqej nga Spanja, me anë të një kompanie të maskuar si "Call Center"

ITALI

Mediat italiane raportojnë se 5 persona janë arrestuar në Peskara, të akuzuar se janë organizatorë të një grupi prostitucioni që vepron në zona të ndryshme të Italisë. Të arrestuarit, ndërmjet së cilëve ka edhe gra, akuzohen se kanë krijuar një organizatë kriminale në shfrytëzim prostitucioni. Nga 5 të arrestuarit, 4 përfunduan në qeli, ndërsa një grua, Hesabel Gutierrez Ruiz, u la në "arrest shtëpiak". Edhe një kolumbian 37 vjeç po hetohet në "arrest shtëpie", pasi akuzohet se ka dhënë ndihmë ndaj rrjetit të prostitucionit. Kolumbiani do të lirohet për tutorët apartamentet e tij në Xhenoa, ku dhe kryej një pjesë e prostitucionit e aktivitetit ilegal. Policia italiane aktualisht ka shpallur në kërkim dy gra të dyshuara tutore, njëra rumune dhe tjetra shqiptare. Hetimi filloi në vitin 2017, kur shërbimet policore raportuan për aktivitet të prostitucionit, ndërsa kishin pikasur një shqiptare që shfrytëzohet si prostitutë. Dy italianë, të dy të dyshuar si "krerë" të bandës së prostitucionit, Fabrizio Sola, 28 vjeç dhe Daniele Toro, 26 vjeç janë në mesin e 5 të arrestuarve. Një tjetër i arrestuar, 52-vjeçari Fiorenzo Berardi



nga Milano, u gjurmua në Milano dhe ishte përgjegjës për mbledhjen e një pjese të të ardhurave nga prostitucioni. Në pranga ra edhe Alessandro Scarafile, 29 vjeç nga Leçe, drejtues i një hoteli në Salento, ku disa prej grave të reja të shfrytëzuara u gjurmuan. Scarafile ishte përgjegjës edhe për publikim të reklamave për vajzat që ofronin shërbime seksuale ndaj klientëve. Shfrytëzuesit kishin 30 apartamente në mbarë Italinë, në qytete të ndryshme, të cilat i përdornin si ambiente për shfrytëzim prostitucioni. Ndërsa, rrjeti udhëhiqej edhe nga Spanja, me anë të një kompanie të maskuar si "Call Center".

Shpërndante heroinë në disa zona të kryeqytetit, pranga 35-vjeçarit

TRANË - Një 35-vjeçar me iniciale M.H. është arrestuar nga policia e Tiranës ditën e djeshme, pasi akuzohet për shpërndarje të lëndëve narkotike. Sipas policisë, shtetasi në fjalë shpërndante lëndë narkotike të llojit heroinë në formë dozash në zonën e "Selitës", "Kombinatit",

"Astirit" dhe "Yzberishtit". Në cilësinë e provës mësohet të jenë sekuestruar 25 doza heroinë, 2 aparate celular dhe një biçikletë. Sipas burimeve policore, ky shtetas është konstatuar duke qarkulluar me biçikletë në rrethrotullimin e bulevardit të "Kasharit" dhe është ndaluar për kontroll nga shër-

bimet e policisë. Gjatë kontrollit fizik të ushtruar i janë gjetur 5 doza me lëndë të dyshuar narkotike të llojit heroinë. Në vijim, shërbimet e policisë kanë ushtruar kontroll edhe në banesën e këtij shtetasi, ku kanë gjetur dhe 20 doza të tjera me lëndë të dyshuar narkotike të llojit heroinë.



Plagosi në atentat kryeplakun pranë banesës së tij, shpallet në kërkim autori

GRAMSH - Një ngjarje e rëndë ka ndodhur rreth orës 22:00 të së premtes në fshatin Gribë të Gramshit. Kryeplaku i fshatit, Tajar Veliu, 54 vjeç ka qenë në ballkonin e shtëpisë së tij kur është qëlluar me shumë se tri herë me armë zjarri. Sipas të dhënave paraprake, dyshohet të jetë qëlluar me armë automatik. Ndërkohë, policia ka zbardhur ngjarjen në Gramsh, ku mbeti i plagosur rëndë Veliu. Autori që plagosi në këmbë kryeplakun është identifikuar, ndërsa vijon puna intensive për kapjen dhe vënien e tij para drejtësisë. Burime spitalore bëjnë me dije për "GSH" se kryeplaku i fshati fatmirësisht është jashtë rrezikut për jetën. Sipas policisë, ngjarja në fshatin Gribë ka ndodhur për motive të dobëta. "Si rezultat i veprimeve të shpejta dhe profesionale të kryera nga specialistët për Hetimin e Krimin në Komisaratin e Policisë Gramsh, në bashkëpunim me specialistët e Hetimit të Krimin ndaj Personit, në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, u bë i mundur identifikimi dhe shpallja në kërkim e autorit të dyshuar S.V., ku vijon puna për kapjen e tij. Ky shtetas mbrëmjen e djeshme në fshatin Gribë, për motive të dobëta dyshohet se ka plagosur me armë zjarri shtetasin T.V., 54 vjeç dhe është larguar, ndërsa forcat e policisë po punojnë për kapjen e tij si dhe për gjetjen e sekuestrimit e armës së zjarrit. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Elbasan dhe po punohet për kapjen e shtetasit S.V., për veprat penale 'Vrasje me dashje e mbetur në tentativë' dhe 'Mbahjta pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyeshe dhe municionit', njoftoi policia.

Godet mjekun e urgjencës, arrestohet agresori në Lezhë

LEZHË - Një 65-vjeçar është vënë dje në pranga, pasi ka goditur një mjek në urgjencën e spitalit të Lezhës. Sipas policisë, në pranga ka përfunduar shtetasi me iniciale P.P. Ai dyshohet se ka dhunuar mjekun për shkak të detyrës, ndërsa ka nisur procedimin ndaj agresorit. Bluzat e bardha kanë rënë pre e dhunës jo vetëm në Lezhë, por raste të tilla janë shënuar në Tiranë dhe në qytete të tjera të vendit. Materialet procedurale në ngarkim të tij do t'i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë, Lezhë, për veprën penale "Goditje për shkak të detyrës".



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje letër fashetimi, shirit plastik, lidhëse sigurie e plasmas, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 4,518,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje letër fashetimi, shirit plastik, lidhëse sigurie e plasmas, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 09 Maj 2019, ora 14:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerja e suportit vjetor te produkteve Cisco"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 5,466,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerja e suportit vjetor te produkteve Cisco"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 07 Maj 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Besa Shahini: Mynyr Koni është kordial me mua, por më duhet të zbatoj ligjin

MAS pezullon Rektorin e UT, kërkon nga Meta shkarkimin

"S'ka iniciativë për të zgjidhur problemet"

Ministria e Arsimit i kërkon presidentit Meta, shkarkimin e Rektorit të Universitetit të Tiranës, Mynyr Koni. Përmes një deklarate për mediat, ministrja Besa Shahini tha se institucioni që ajo drejton ka vendosur pezullimin e Rektorit Koni, ndër-
sa tha se i është drejtuar me kërkesë kreut të shtetit për shkarkimin e tij.

"Më ka bërë përshtypje mungesa e iniciativës së Rektorit për të zgjidhur problemet në universitet. Rektorit është ankuar shpesh për dekanët, por kurrë nuk ka ardhur me një kërkesë të mirë-argumentuar që t'ia aprovojimë heqjen e tyre. Shpresova se do të shfrytëzonte momentin e krijuar nga protesta e studentëve për të ndërmarrë masa dhe përmirësuar klimën e punës në universitet, por kjo nuk ndodhi.

Na duhet një frymë bashkëpunimi mes studentëve e pedagogëve, pedagogëve e udhëheqësve të universitetit, udhëheqësve mes tyre apo edhe me ne si ministri - gjë që është bërë e pamundur në Universitetin e Tiranës dhe sot jemi në këtë pikë ku unë detyrohem të marr një vendim të vështirë si ky i pezullimit të Rektorit.

Më vjen me të vërtetë keq për Profesor Konin, i cili ka qenë gjithmonë shumë korrekt dhe kordial me mua si person. Por, përkundër kordialitetit, jam udhëheqëse e



Ministria Besa Shahini

një institucioni që ka për detyrë të sigurohet se ligji po zbatohet dhe reforma po realizohet në të mirë të të gjithëve. Sidoqoftë, është gjithmonë vështirë të merret vendim për pezullimin e

një personi të zgjedhur me vota nga institucioni që përfaqëson dhe më vjen keq që kemi arritur deri këtu.

Vendimin për shkarkimin e Rektorit e merr Presidenti dhe ai do të ketë

Koni: Kuptohet kush kërkon të gllabërojë pronat tona

Rektori i Universitetit të Tiranës, Mynyr Koni ka rreaguar përmes një postimi në 'Facebook', pas vendimit për pezullim të tij nga Ministria e Arsimit.

"Sapo mësova nga media se Ministria e Arsimit, ka vendosur pezullimin tim nga detyra e Rektorit të Universitetit të Tiranës dhe i paskërka kërkuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë, shkarkimin tim.

Dhe këtë vendim e paskërka mbështetur në një inspektim të Ministrisë që ajo drejton.

Në dijeninë time, nga kjo ministre, nuk ka ardhur asnjë grup inspektimi, sepse, në rast të kundërt, do të isha unë i pari që do ta mësoja një gjë të tillë. Në fakt, ishte e pritshme nga ana ime që situata do të shkonte deri këtu, pas gjithë atyre sulmeve të pashembullta që prej shumë kohësh, janë adresuar ndaj personit tim.

Përpara se të merrte një vendim të tillë, ministrja duhet të më kishte mundësuar një takim apo të më kishte dëgjuar se çfarë realisht po ndodh në Universitetin e Tiranës, por siç duket, e tremb e vërteta.

Edhe një herë, me prononcimin e saj të fundit, u kuptua edhe më qartë se kush e urdhëron ministrin dhe se kush kërkon të "gllabërojë" pasuritë e Universitetit të Tiranës." - shkruan Koni në 'Facebook'.



në dispozicion të gjithë materialin e përgatitur nga grupet e inspektimit.

E kam dëgjuar me kujdes fjalën e Presidentit Meta dhe në një universitet privat ku tha se: "Protesta e dhjetorit ka treguar se zbatimi aktual i ligjit për arsimin e lartë ka probleme."

Jam plotësisht dakord me Presidentin, sidomos për sa i përket Universitetit të Tiranës, ku ligji nuk është zbatuar, e rrjedhimisht universiteti është keqmenaxhuar dhe kjo ka rezultuar me probleme serioze për të gjithë gjeneratën e studentëve që sot janë duke ndjekur studimet në Universitetin e Tiranës.

Duke marrë parasysh shqetësimin e shprehur nga Presidenti për moszbatimin e ligjit të arsimit të lartë, jam e bindur që do të marrë vendimin e duhur për zgjidhjen e ngërçit në Universitetin e Tiranës", - u shpreh Ministria Shahini.

Kujtojmë se mes kryeministrit Edi Rama dhe rektorit Mynyr Koni ka patur akuza e replika në distancë lidhur me zhvillimet në arsimin e lartë.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID



BalkanWeb

1111

1111

DESHMI

Asimilimi i shqiptarëve, domethënia e vizitës së Papës në Maqedoni

Nga Dom Nikë Ukgjini

Pas vizitave, kohët e fundit, të Papa Françeskut në Emiratet e Bashkuara Arabe, më 4 mars 2019 dhe Mbretërinë e Marokut, më 30 - 31 mars, tani vëmendja e Selisë së Shenjtë është përqendruar në Ballkan, pikërisht në vizitën e Papës në Bullgari, më 5-6 maj dhe më 7 maj në Maqedoninë Veriore. Papa Françesko ndërmoi këtë turne ballkanik, si falënderim ndaj Zotit që hap rrugët e paqes dhe miqësisë, për të cilat sot kanë shumë nevojë shtetet ballkanike, por njëherazi për të na rikthyer në vëmendje, se Thrakia dhe Dardania, ishin pellgu nga gjeneroi dhe gjallëroi krishterimi si qytetërim, në të gjithë Evropën e sotme. Eterit kishtarë në shekullin II na dëshmojnë se Krishterimi hodhi rrënjët në trevat e Ilirisë që në kohën e Krishtit nga vetë Shën Pali, duke kaluar nga Jerusalemi në Epirin e Ri (Durrës) në rrugën "Via Egnatia", për në Romë. Shën Andrea predikoi në Epirin e Vjetër; Shën Luka në Dalmaci dhe Shën Matia në Dardani, për të cilën jemi duke bërë fjalë. Si kudo, edhe këto vatra të krishterimit u bënë qendrat qytetare ku i ngrihën bashkësitë e para fetare e kulturore. Me përsosjen e organizimit kishtar, në qytetet kryesore më të mëdha e më të vjetra u krijuan peshkopatat që e shtrinin juridiksionin e tyre në gjitha krahinat e Ilirisë.

Dardania ilire ishte njëra ndër krahinat më të mëdha e më të zhvilluara në fushën e prodhimeve të ndryshme si dhe pasurive nëntokësore. Ajo si e tillë kishte qytete të zhvilluara dhe të njohura si: Sardikën, Naissus (Nishin), vendlindja Konstantin të Madh (306-337), i cili legalizoi në vitin 313 Krishterimin në Perandorinë Romake; Remesianën, ku veprroi ipeshkvi, Shën Niketa (340-414), i cili kompozoi himnin e Krishterimit botëror, "Te Deum" (Ty Hyj të Lavdërojmë); Ulpienën nga dolën martirët e parë të Krishterimit, Flori dhe Lauri në kohën e mretit Hardian (117-138) dhe Shkupin, si kryeqytet dhe vendlindja e Justinianit të Parë (527-565), i cili njihet si reformatori më irëndësishëm i Perandorisë Bizantine. Por, Krishterimi i Dardanisë ilire, si vend i lakmueshëm zhvillimor, gjatë viteve pati shkatërrime të mëdha nga horditë pushtuese: sllave, bullgare, bizantine. Ajo pësoi dëmtime dhe nga grindjet juridike e doktrinare që zhvilloheshin në mes Romës e Konstantinopolit, filluar që nga koha e skizmës Akacije (484), lëvizjeve ikonoklaste (730) e deri të ndarja përfundimtare e dy kishave në vitin 1054, kur dioqezat e Dardanisë dyzoheshin në mes Lindjes dhe Perëndimit. Sidoqoftë, pjesa më e madhe e dioqezave kishtarë të Dardanisë i mbeten besnik papatit deri në shekullin XIV.

Dyzimet mes Lindjes e Perëndimit dhe diskriminimi, si u rruhdhën bashkëkombësit në shtetin fqinj



Kryepeshkvi i Shkupit, Mati Ulogoreci

Kisha katolike në Dardani, edhe përkundrejt vështirësive, presioneve, luftërave të pandashme, që zhvilloheshin për nënshkrimin e saj, nga bullgarët, bizantinët dhe nga fillimi i shekullit XII, me serbët, megjithëse e goditur rëndë, do të vazhdonte ta ruante vazhdimësinë e mëparshme të ndritur, duke qëndruar e lidhur shpirtërisht dhe juridikisht me Romën.

Duke filluar nga viti 1219, në Dardani, përballë trysnive të sllavo-ortodoksizmit për përvetësimin e kishave romake, sipas dokumenteve, dëshmohet prania e kishave katolike arbërore, në Shkup, Tetovë, Prizren, Graçanicë, Trepçë, Novobërdë etj., në të cilat kultivohej gjuha shqipe. Për prezencën e elementit arbëror në këtë trevë, flet shumë qartë shkruartari bizantin i Atalietes, kah fundi i shek. XI, duke u shprehur se albanët janë latinë, që do të thotë të rritit romak.

Situata në Dardani ndryshoi mënyrë drastike me shpalljen e ligjit të Car Dushanit "Kodi i Dushanit" në vitin 1349 në Shkup, me anë të cili u nxit një armiqësi e madhe ndaj kishës katolike dhe arbërore në përgjithësi. Më këtë rast pothuajse

qind vjetësh, tokat shqiptare në fillimet e shek. XVI u përfshinë tërësisht në sundimin e këtij pushteti shkatërrues për pesë shekuj me radhë.

Turqit rrënuan shumë kisha katolike deri në themel, të tjerat i tjetërsuan dhe ipeshkvinjtë latinë përndiqeshin duke ua ndaluar të udhëhiqnin grigërin nga selitë e veta siç ishin: Shkupi, Ohri e Prizreni, por ata duhej të vepronin nga fshatrërat e vendet malore për rreth e qark dioqezave. Këto masa dhe të tjerat ndëshkuese sollën edhe islamizimin e arbërorëve të Dardanisë së dikurshme, duke arritur në shek. XVIII të islamizoheshin në masën deri në 90% të tyre. Politika perandorake në qarqet ndërkombëtare masën e islamizuar e ka paraqitur si turke, pjesën katolike si latine, ndërsa atë ortodokse si greke.

Si pasojë e trysnive turke, me vdekjen e Andre Bogdanit, në vitin 1656, u shua përfundimisht kryedioqezat e katolike e Ohrit, ku që më herët pjesa më e madhe e besimtarëve kishte kaluar në Kishën Ortodokse. Dhe si fanar e ruajtjes së traditës të Kishës romake dhe identitetit kombëtar, tani e vetme kishte mbetur kryedioqezat e Shkupit, e cila administronte katolikët në "Serbinë e vjetër" të emërtuar kështu nga Car Dushani, dhe një pjesë të Bullgarisë. Po kështu, nga përndjekjet e turke, ndihmuar nga kisha serbe, ipeshkvinjtë e kësaj kryedioqeze nuk mund të qëndronin për të ushtruar detyrat e tyre baritore nga selia e Shkupit, por e bënin nga famullitë e ndryshme si: Hasi, Janjeva, Gjakova, Prokupje e gjetiu.

Sipas relacionit të Kuvendit të Arbrit, imbijtur në Merqit të Lezhës në vitin 1703, e ku Papa Albani - Klementi XI, i pat bashkuar përfaqësuesit e të gjitha trevave arbërore, Kryedioqezat e Shkupit kishte rënë në minimumin e saj, duke pasur 6 famullitë, më 770 shtëpi dhe 5.296 besimtarë katolikë. Më këtë rast ajo administronte edhe 2.061 katolikë në Bullgari.

Në përballjet shumëshekullore me pushtuesit turq e serbë, në ruajtjen e historisë dhe traditës dardane, qëndruan stoikisht prelatët e shquar të kishës katolike si: Imzot Pjetër Budi, poet e përkthyes i "Doktrinës së Krishtenë", në vitin 1618; Imzot Pjetër Bogdani, autor e "Çetës së Profetëve", 1698; Imzot Gjon Nikollë Kazazi, letrar, zbulues i "Mesharit" të Buzukut, 1740, në Romë dhe shkruer në shqip i librit, "Doktrina e Krishtenë" 1743; Imzot Andre Ulogoreci, 1887-1901, përkthyes dhe organizator i rihapjes së disa shkollave shqip, në Shkup, Gjakovë e Prizren; Imzot Lazër Mjeda, 1909, nxitës i përhapjes i kulturës shqiptare në këto treva dhe luftëtar i paepur në ruajtjen e tërësisë territoriale të Shqipërisë etnike, gjatë luftës Ballkanike e tjerë.

Në kohën kur po shkatërrohej Perandoria osmane, sidoqoftë evidentohet se kishte mbijetur një numër i konsiderueshëm i sh-

qiptarëve në Maqedoninë e sotme. Sipas statistikës turke të vitit 1908, në Maqedoninë e Veriut jetonin 341.639 shqiptarë. Ndërsa pas krijimit të Mbretërisë Serbe - Kroate - Sllavene, më 1 dhjetor 1918, llogariten në Maqedoni, e cila quhej Banovina e Vardarit, në vitin 1921 jetonin 28.4% të shqiptarëve. Ndërsa shqiptarët të besimit katolik në Maqedoni e Kosovë, për të cilët përkujdesej kryedioqezat e Shkupit, ishin 30.336. Mbas shkatërrimit të ish-Jugosllavisë dhe përfundimit të luftës në Kosovë, në vitin 1999, situata kishtarë mori një kaheje tjetër: Për shkak të rrethanave politike, dioqezat e Shkupit më 25 maj të vitit 2000, që shkëputur nga dioqezat Prizrenit, me të cilën ka bashkëvepruar nga viti 1969, duke vepruar tani secila për llogari të vet. Shkupi, vendlindja e nobelistës shqiptare, Nënë Terezës, tani kishte mbetur me 6.320 besimtarë, nga të cilët pjesa më e madhe janë katolikë të rritit bizantin, që mbahen si maqedonas apo bullgarë dhe 2.000 prej tyre janë shqiptarë të përqendur në Shkup, të cilët për çdo ditë janë duke u asimiluar.

Sot Maqedonia e Veriut, sipas statistikave të Eurostatit të vitit 2016, ka 25.2% ose 600.000 shqiptarë. Ndërsa të dhënat nga terreni flasin për një shifër deri në 30-35%. Sidoqoftë, në krahasim më vauajtje e pa masë, si: shpërngulja në Turqi më 1938 dhe 1953, diskriminimi në forma të ndryshme që i ka shoqëruar shqiptarët në të kaluarën nën regjimin sllavo-ortodoks, sot mbetet prezent një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve në këtë republikë.

Sot duke pasur parasysh ndryshimet nacionale, politike e ekonomike etj., në këtë pjesë të Ballkanit, të gjitha analizat serioze janë të një mendimi se, edhe përkundrejt gjendjes me gotën gjysmë të zbratur në aspektin shpirtëror, moral, mendor, ekonomik, në të cilën gjendemi, ky gjysmëshekull konsiderohet se është në favor të shqiptarëve. Në këtë vështrim, vizita në Maqedoninë e Veriut e Papa Françeskut, i cili personifikon shtetin sipas modelit "De Civitatis Dei" (shteti i Hyjit), të Shën Agustinin, është edhe një ditë e jona, kur të gjithë pa dallime, më 7 maj të këtij viti, të organizuar nga të gjitha trevat, duhet të nisemi drejt Shkupit, në shenjë vlerësimi e ndërimi për çfarë ka bërë Selia e Shenjtë në të kaluarën për ne shqiptarët.

Po kështu, vizita e Papës në Maqedoninë Veriore ka për qëllim të hapë rrugët e paqes dhe miqësisë në këtë vend tejskajshëm të përgjakur gjatë tërë historisë, në dyzimet mes Lindjes e Perëndimit. Për ne shqiptarët është edhe momenti, kur Papati na ofron si në Kuvendin e Arbrit, goftë edhe në aspektin shpirtëror, ngjiten e fijos së shkëputur, e cila ndodhi në Kongresin e Berlinit në vitin 1878, kur trojet tona u qenë shpërndarë shteteve fqinje padrejtësisht.



të gjitha kishat dhe manastiret katolike u përvetësuan, duke i shndërruar në Kisha dhe manastire ortodokse sllave dhe popullata arbërore asimiloheshin ditë për ditë. Ardha e pushtuesve turq në Ballkan ndryshoi gjeopolitikën edhe në trevat arbërore si dhe hapësirën e Dardanisë. Ajo çfarë nuk u arrit të shkatërrohej nga mbreti Dushani, u zbatua nga turqit aziatikë, kur pas një qendrese prej më tepër së një-

E DIEL
14 Prill
2019

MILOSA O

Jeta ndryshe e SAMI FRASHËRIT,

martesa me të kunatën!

NGA HIKMET FERIDUN ES
DHE KUJTIM NURO

Në kohën që ishte 40 vjeç, ai do të tregonte sikur të ishte në moshën 80 vjeçare. Samiu, megjithëse e donte jetën mjaft të qetë, ai do të dukej me tepër në moshë, në shkallen që do t'i habiste të gjithë. Në kohën që ai ndodhej në moshën 45 vjeç, do të qëndronte sikur ishte në moshën 80 vjeç. Fotografia, e cila është bere kur ai ishte plotësisht në moshën 46 vjeçare, sot njerëzit do të kujtojnë që ai ka kaluar të 80-tat. Dhe ndofta, në çdo vend të botes, në të gjithë sipërfaqen e rruzullit tokesor, asnjëri nuk mund të tregojë se është me tepër nga moshën në këtë shkallë. Mjekra e tij e gjate ishte krejtësisht e bardhe. Flokët, i cili kishte në koke, i kishin renë plotësisht. Aq sa ana e renë e flokëve

mund të shihej mjaft mire mbrapa festes se tij. Në mes të burrave, në moshën e mjaft të rinjve, rënia e flokëve të tij dallohej në të gjithë familjen. Por, ai në mënyrë absolute, nuk do t'i jepte rëndësi pamjes që dukej 80 vjeç, kur ai në të vërtetë ishte 40 vjeç. Bile, nëqoftesë ai vinte menjëherë festën e tij, përpara, rënia e flokëve nuk do të dallohej. Ai nuk kishte gjera, që mendonte se të tjerët do të pëlqenin atë. Në fakt, nuk kishte aspak kohe të mendonte për veten e tij, përveç shkrimeve dhe librave. Fotografitë e fundit që botuan ditën që kaloi se bashku me dy shokët e tij, e tregonte atë me flokë dhe vetulla krejt të bardha si një plak i vjetër, që i ngjante Tolstoit. Mirëpo, në një moshë që do t'i thuhet i ri, ndërroi jete në moshën 54 vjeçare.

Si u grabit dyqani i Samiut. Në dhomën e tij të fjetjes një fotografi e një gruaje dhe një tufe flokësh të saj brenda një kornize me ngjyrë të zeze. Dyqani që ndodhej në Salkimsogut. Tabela shkruan:

Shemseddin Sami. Përse fjalori Arabisht (Kamus-i Arabi) mbeti përgjysmë? Gjashtë raftë të mbushura me zarfa librash. Sultan Abdylhamidi mua nuk me do. Kush shkroi, kush e morri medaljen. Kravaten e mbajti deri në grisjen e saj. Kepuce 10 vjeçare.

Një fotografi e një gruaje të re qëndronte e varur në murin e dhomes se fjetjes se Samiut. Një grua e re me fytyrë romantike rreth moshës 20-21 vjeçare. Sytë e dijetarit të madh do të ktheheshin shumë shpesh, deri në vdekje, tek ajo fotografi. Do të binte në sy një kornize e trashë me ngjyrë të zeze e kesaj fotografie. Kjo fotografi me kornize të zeze përreth saj, ishte në formën e një tabloje kujtimesh. Brenda fotografisë, të tërhiqte vëmendjen një tufe flokesh me ngjyrë të kuqerremte, të vendosur në një rrip druri të gdhendur mbi fotografi. Te gjitha këto, Samiu i kishte bere me dorën e tij.

→Vijon në faqen 14



Jeta e panjohur e Kostë Çekrezit në rininë e tij

Jeta aktive në Uashington e b.n t, njohur në qarqet politike e diplomatike. Ndërkohë, Çekrezi plotëson shkollimin e tij në Harvard. Diplomohet në 1918 me gradën Bachelor of Arts dhe, pas kësaj, jep leksione si profesor i historisë në Columbia University.

Prej 2 Marsit 1920 (deri në 1922), Kostë Çekrezi është i pari përfaqësues i akredituar nga qeveria e Kongresit të Lushnjës pranë Qeverisë Amerikane, si Komisioner i Shqipërisë në Uashington. Në 1925 kthehet në Shqipëri dhe boton në Tiranë gazetën "Telegraf" dhe "Ora" deri në 1932.

Në këtë numër: HIKMET FERIDUN ES DHE KUJTIM NURO PËR SAMI FRASHËRIN, ANDON ANDONI PËR KOSTË ÇEKREZIN, ANASTAS KOSTANDINI PËR MAKS VELO, ROLAND GJOZA, RUDINA PRODA, ALEKSANDËR ÇIPA ETJ

P

PERSONAZH

NGA HIKMET FERIDUN ES
DHE KUJTIM NURO

Avijon nga numri i kaluar ty, ai kishte vendosur dhe vargje në Ara bishit dhe në Persisht, sepse Samiu ishte një nga kaligrafet me të njohur artizanë të periudhës. Bile, në kohën që i duhej shume, ai u ul dhe e ka shkruar shume bukur tabelen e dyqanit. Për kete do të flasim me poshtë. Fotografia me kornize të zeze i përket zonjës Eminë, gruaja e pare e dijetarit. Samiu, kete tablo të një kujtimi të trishtuar, me gishtat, të cilat i dridheshin nga trishtimi, e ka bere, kur ajo ndërroi jete. Fotografia, me të njëjtën gjendje qëndron akoma, thotë vajza e tij, Samije. Samiu, në shtratin e vdekjes se gruas se re, e cila e kishte lenë vetem, nga qe e donte shume, i kishte prerë një tufe flokësh.

Duke gdhendur e duke shkruar vargje në gjuhe të ndryshme, ai i kishte vendosur ato në kete fotografi. Samiu është martuar për here të dyte me një grua të re, e cila ishte e një nga te afermit e tij. Kjo grua ishte bashkeshortja e re e një nga vellezerve, i cili kishte nderruar jete. (Është fjala për bashkeshortën e Abdyl Frasherit - Ballkezes, te cilet kishin se bashku dy femije: Mit'hat dhe Eminë Frasherin. Nga martesë e dyte e Samiut me Ballkezen ka lindur Skender Frasherit, i cili ka qenë muzeolog dhe mesues i gjuhës frenge K.N.) Kjo martesë ishte e nevojshme për tu bere, akoma me tepër ishte e domosdoshme. Sepse dy femijet (Mit'hat Frasherit dhe Eminë Frasherit-K.N.) e gruas se ve (Ballkezes - K.N.), (Abdyl Frasherit-K.N.) ia kishte lenë amanët atij për tu kujdesur. Në kete menyre, Samiu me një buxhet fare te pakët, kishte qenë i detyruar te shikonte dy shtepi. Ai kishte humbur bashkeshortën e tij, kjo grua, e cila kishte humbur bashkeshortin e saj dhe femijet ishin shume te dashur me njëri-tjetrin si një familje. Nga njëra anë, një burrë me femije jetime, nga ana tjetër një grua me femije pa baba, kishin nevojë te madhe për njëri-tjetrin. U martuan bashke. Femijet e donin shume kete grua te re. Vajza e madhe e Samiut, e nderuara Znj. Samije Erer thote: Ishte një grua shume e bukur. Iu ngjante prince-shave. Në na beri qe te mos e ndienim edhe një dite mungesën e nënës sonë. Kishte një zemer te mire.

GRABITET DYQANI QE HAPI SAMIU

Ai ishte një njëri shume i lënduar në fatin e tij. Por për fat te mire, Samiu ishte indiferent ndaj gjerave te pafata. Në jetën e tij, me te vertete kishte shume ngjarje te fatekeqesive. Psh: në ceshtjen e konsolidimit te parase, me gjithë përpjekjen e tij, fati e kishte thyer vazhdimisht kunder tij. Ai filloi

Po vijojmë pjesën e katërt me shkrimin e një gazetari turk, i cili përshkruan jetën e Sami Frashërit, përgatitur nga Kujtim Nuro, një osmanolog i shquar. Hikmet Feridun Es e ka botuar në gazetën "Aksham" (Stamboll), Dhjetor 1944-Janar 1945 me titull: Personalitetet e famshme që nuk i njohim- Shemseddin Samiu - Një gjigand mendim-P tari, të cilin nuk e njohim aspak (Arkivi i Taha Toros - Universiteti i Qytetit të Stambollit). Në këtë numër do të shohim përkorjen e jetës së tij por edhe episode shumë intime familjare, që shoqërohen edhe me përshkrime interesante të panjohura

Jeta ndryshe e Sami Frashërit, martesë me të kunatën!



vepren me titull: Kamus-i Arabi (Fjalori Arabisht). Tregoi një interes të madh për fillimin e përgatitjes, duke menduar se kjo vepër do ta bente te pasur, nëqoftese ai nuk do te ishte përballur me fatekeqesinë e tij te pafat. Në kohën që ai dëshironte te përgatiste Fjalorin Arabisht, për llogari te ventes, hapi një dyqan në Salkunsogut (Stamboll). Bile, u ul dhe shkruajti vehte mbishkrimin e tabelës se dyqanit mbi një pjese alumini te bojatisur. Dhe kete e vendosi sipër bibliotekës, e cila ndodhej në Salkunsogut. Kjo ngjarje është ana me e patreguar e Sami Frasherit. Në dyqan, u ul njëri qe familja e njëjthe prej kohësh, Haxhi Musai, një përson shume i sigurte. Vepër përparonte, fashikujt me te dale, i merrnin menjëhere. Te gjithë blesit ishin nga Egjipti, Arabia, deri tek Adeni (Jemen-K.N.) Fjalori erdhri në germen "C". Plasi ngjarja Armenë. Gjate kesaj kohe, dyqani u grabit. Ishte përmbysur u gjithë, në cdo anë. Nuk kishin mbetur as fashikuj, as doreshkrime, as kopje. Haxhi Musai do te shpetonte me veshitësi, bile shpirtin e tij. Shpresat qe ishin aq te shumta, për kete arsye Fjalori Arabisht, i cili u lidh, mbeti në germen "C".

SAMIU SHKRUAN, KUSH E MERR MEDALJEN

Brenda 16 vjeteve qe i kushtoi, mbaroi Fjalorin Enciclopedik "Kamus-ul Alam" (gjashte velleime-K.N.) dhe fitoi vetem 300 lira. Ky fjalor zgjoi një interes te madh në te gjithë botën Lindore, bile në te

gjithë rruzullin tokesor. Miqtë e tij kembengulnin duke i thenë: Një pjese nga vepër dergoje në Pallatin Mbretëror. Samiu u jepte atyre kete përgjigje: Sulltan Abdul-

amidi mua nuk me do. Me në fund një nga miqtë e tij i thote: Te mbështës duke i besuar fjales tende, por pa e derguar vepren, nuk duhet besuar vetem tek fjala. Dergo qe ti te punosh i qete. Për kete, lidhen gjashte velleime me kapak te purpurte. Vepër iu derguaa Sulltan Hamidit. Dhe mbas një jave në krye te faqevete te gazetave, te cilat shpallnin marrjen e medaljeve, njoftuan se medalja e larte e shkalles se dyte i ishte dhënë z. Mihan për botimin e vepres Kamus-ul Alam. Është e cuditshme!

KRAVATA QE KA PËRDORUR DERI SA U GRIS

Dhe një nga karakteristikat me te rendesishme dhe me te medha te Samiut është se ai ka kaluar një jete mjaft te thjeshtë, bile te shkallës se fundit. Vajza e madhe thote: Përdorte një kravate. Ate e përdorte gjithmonë, deri sa u gris. Kur do te behej mjaft e vjetëruar, ai do te blinte një tjetër. Ishte gati qe te mos e shihte te nevojshme përdorimin e kravatës. Duke u ankuar, do te vishte dhe kemishat e kollarisura ash-për. Megjithate, veshja e Samiut nuk dukej aspak e vjetër. Sepse, ai do te dilte në rrugë, ndonjëhere, vetem dy here në muaj. Për kete dhe

vrobat njëmbëdhjete- dymbëdhjete vjeçare do te qendronin mjaft te reja, ashtu sic i kishte veshur dhete vjet me pare. Turmat e njerëzve dhe rruga për kete njëri te madh, ishin një vend marrje mendsh. Ai ishte aq i lidhur me bojen, penën, minderin ku shkruante, kur ndahej nga keta, bile dhe nga një shetjetje me shkurter dhe e detyruar, do te kthehej shume i lodhur. Te njëjten menyre veshjeje te thjeshtë, e kishte pranuar si një parim te zakonshem dhe për femijet. Te gjithë se bashku, në cdo fillim stinë dilnin në Beyoglu (Stamboll) dhe hynin në Beyker. Vajzave do t'iu merrte dy fish stof dimri. Dhe ngyrat e ketyre për cdo kohe ishin te caktuara. Ngyre blu e erret, ose vishnjë po e erret. Shapkat ishin shapka angleze, pa thembra. Floket do t'i mbanin te leshuara dhe jo floke te mbledhura mbrapa në forme topuzi. Mirepo, shoket e tij thoshin se Samiu në moshë te re ka qenë një djale i hijshem, elegant, i pispillosur. Atehere, Samiu i ri do t'i bente rrobat tek Miri. Ai do te vishte kepuce nga Jorgji, i cili ishte kepuçari me i njohur i Gallates, qe përpara 80 vjeteve. **vijon**

P

PIKTURË

NGA BENANDONI

Ky album i fundit, që i është dedikuar piktores Rudina Proda, është institucionalizimi i krejt veprimtarisë së saj për shumë vite. Familja e saj, streha, e cila jo vetëm e ka ruajtur por edhe e mbrujti artin e saj, është frymëzuesja dhe angazhuesja e një projekti që është tejet mbresëlënëse, e në një farë menyre fryt i një pune kushtuar një individi me cilësi shumë të veçanta që duhet vlerësuar. Pa u futur akoma në shpjegimin e tij, një homazh i madh i duhet bërë kësaj familje, si shembull për rastet e ngjashme por edhe për përballjen me realitetet e sotme të jetës, ku ka humbur humanizmi dhe mbi të gjitha sakrificat në vazhde të idealeve. Të dedikuar të thjesht ndaj një familjari të

Ky album i fundit, që i është dedikuar piktores Rudina Proda, është institucionalizimi i krejt veprimtarisë së saj për shumë vite. Familja e saj, streha, e cila jo vetëm e ka ruajtur por edhe e mbrujti artin e saj, është frymëzuesja dhe angazhuesja e një projekti të tillë tejet mbresëlënëse, por në një farë menyre fryt i një pune kushtuar një individi me cilësi shumë të veçanta që duhet vlerësuar...

tyre të veçantë dhe me talent gati të bekuar, por të fokusuar drejt një qëllimi që ka bërë punë të madhe gati me angazhimin e një institucioni. Familja Proda është shembulli i një vetëmohimi, në funksion të nxjerrjes pah së vlerave të vazhës së tyre, që tashmë i ka lenë veten një emër të mirë në komunitetin artistik shqiptar.

Rudina Proda është një vajzë me cilësi speciale, nga ato të tillat, që shumë prej familjeve të cilat i kanë këto problematika, në pamundësi i konsiderojnë si halle. Qysh kur e kanë dalluar këtë cilësi të saj, ata kanë mbrujtur aftësitë e saj në pikturë dhe arritën të dhurojnë për artin shqiptar një zë, që percepton në kushte shumë të jashtëzakonshme. Për vlerësimin e Rudinës gjithmonë një kritik duhet të veshi dhe robën e përbashkët të



K

KRITIKA

Maksi afirmon si mesazh identiteti-pikturën, një pikturë që shfuqizon materien, strukturat, dritën fizike apo hije-dritën për t'i gjetur ato indirekt mes ngjyrave. "Gjeja e vetme që duhet pasur parasysh - thotë Zhorzh Brak - është marrëdhënia e artistit me realitetin. Tabloja lind nga relata që ka me një motiv të caktuar dhe ndonjëherë ndodh që tabloja t'i ngjasojë më shumë motivit se sa artistit. Për mendimin tim, gjerat marrin vlerat e tyre vetëm kur kanë të bëjnë me mua".

Për ekspozitën e Maks Velos

"Fshati primitiv ndriçohet nga meteorë"

NGA ANASTAS KOSTANDINI

Pothuajse çdo muaj Maks Velo udhëton drejt Korçës, vendlindja e familjes së tij. Është njëherësh qyteti ku u rrit dhe kaloi adoleshencën dhe fitoi shumëçka. Ky ritual destinacioni, ne moshën e tij ka arsye të shumta shoqërore, kulturore, miqësore, shpirtërore etj. Gjithsesi, kjo trajektore është sa e kuptueshme aq dhe një inerci dhe nevojë inkoshience. Ajo duket si pike referimi kulturor. Rajoni i Korçës përbehet prej një numër fshatrash interesante, gjithmonë brenda gamës ngjyore shqiptare.

Korça përmes piktorit Mio duket që ka provokuar fillesat e artistit të ardhshëm. Ndoshta ndryshe nga të tjera vise, rajoni korçar është portë hyrëse dhe dalese brenda një Ballkani ku përzihen natyrshëm ngjyrat e forta të kulturave dhe nënkulturave me minoritetet. Ne ketë mozaik, bie në sy arti popullor me të cilën është organizuar jeta e qyteteve dhe fshatrave dhe ne rrafshin urban. Dhe trashëgimitë ikonografike që në këtë zonë janë të shumta, përbëjnë një



veçori të rrallë. Ato e mistifikojnë realitetin e pasur të këtyre aneve. Qytete dhe fshatra dikur të lulëzuara, papritmas humbasin në terren e viteve. Maksi shkon dhe në fshatin Dardhe, fshat i mirënjohur si fshat-qytet, plot sqime dhe histori, aq sa do e kish zili dhe një qytet i madh. Në të, jetojnë bashkë ende qytetaria me primitivitetin, komunikimi me botën e vogël që të kujton eremitët. Maksit i pëlqen të ndalojë buze liqenit të qytetit tim për të me takuar si të njohur të vjetër. Çdo takim me një njëri aq të veçantë sa ai do

të që ngjarje për këdo. Për mua është vërtetë privilegj të bisedoj me të për çdo temë. Ai nuk njuh limit dhe kufizim në biseda dhe shprehje. Nuk ka tabu dhe paramendim. Kurioz i madh ndaj të gjitha dimensioneve dhe eksperienca. Vetë formimi i tij është një raport solid mes të qenit artist dhe rob i se vërtetave të sakta. Ajo që sundon ato caste relaksi e pushimi nga rruga a gjatë është tema e artit kombëtar dhe botëror. Me mua parapëlqen të debatojë për pikturën dhe grafiken, vizatimin dhe skulpturën. Ato përbejnë pasionet me sensitive me reagimet me të

parashikuara teksta flet me nerv. Ai vazhdon të jetë në sytë e mi ish profesori i perspektives. Ne vitin e pare të Institutit të Arteve, ai na ka mësuar atë lende. Gjithmone përfaqësonte diçka të fortë në pamjen dhe menyren si fliste dhe shikonte. Ishte atipik dhe simpantik. E lidhja me arkitekturen dhe ndertimin. Vellai im ishte si ai inxhinier. Nuk besoj se është pandehme ajo që, perspektiven e personifikonte ky njëri, ndoshta me atë ekuilibrin e paarrtshëm prej meje; artistin dhe inxhinjerin. Arti si inxhinjeri dhe e kundërta me duken dhe sot tepër bashkëkohore. Prej tij me dilnin parasysh pikturat e Lezherit me konstruksionet metalike futuristë ne qiellin blu. Konstruksioni si ndjenjë lirie dhe ëndërrimi. Takim pas takimi me ka rrëfyer një pjesë të madhe të pikturave që realizonte fill sapo shikohet. Keshtu me shpjegonte kohën e krijimit. Mirëpriste komentet e mia të cilat buronin fill sapo shikojta fotot e punëve. Krijova kohe pas kohe një përfytyrim mbi to. Dukshem me pelqente koloristika e tyre e shfrenuar që shoqërohej me buzëqeshjen e Maksit sa here vezhuroja tablotë. Cikili karakterizohej nga fizionomia e pangatërrueshme e stilit të fortë. Stili i njo-

hur tashme prej publikut të gjere, kish të tjera dimensione. Dukej fort e unifikuar pavarësisht prej temave mjaft të pasura dhe të ndryshme. Ajo që potenconte fizionominë ishte padyshim elementi ngjyre e cila përcaktonte të veçantën, ndoshta dhe përmbi fuqinë shprehëse të formave për të cilat Maksi ish i njohur. Pra duket që rivaliteti mes piktorit dhe skulptorit brenda vetë Maksit, është ne favor të pikturës. Ndersa vizatimi nen të cilin jetojnë format dhe ngjyrat, shfaqet shoqërueshëm nën dominancën koloristike. Pra, ekspozita në fjalë është e lidhur se pari me ngjyren e cila është dhe kuptimi i imazheve njëherësh dhe bartësja e të gjitha iluzioneve mire të orientuara nga krijuesi.

Me sa duket, Maksi afirmon si mesazh identiteti - pikturën, një pikturë që shfuqizon materjen, strukturat, dritën fizike apo hije-dritën për t'i gjetur ato indirekt mes ngjyrave.

"Gjeja e vetme që duhet pasur parasysh - thotë Zhorzh Brak - është marrëdhënia e artistit me realitetin. Tabloja lind nga relata që ka me një motiv të caktuar dhe ndon-


➔ Vijnë në faqen 16

sociologut dhe psikologut për të treguar e shpjeguar një rast pothuaj unik sesa një artist, që nuk ka mundësi socializimi të zakonshëm të perceptojë dhe të krijojë në këto lartësi. "Ka një cilësi të rrallë, që ajo hulumonit çdo gjë dhe për çdo moment ajo është në kërkim të atyre gjërave që neve pak i konsiderojmë", thotë i ati i saj. Alkimia që prodhohet në trurin e saj pastaj sjell gjëra të jashtëzakonshme duke sjellë krijime shumë të arrira ku fuqia e ngjyrës lidhet me abstragime të formës, që vinë natyrshëm në mendjen e saj. Si një nga përfaqësuesit autikë, Rudina nuk mund të konsiderohet më si femija me fat apo artistja e përkëdhelur. Edhe pse për raste të ngjashme ka manuale pa fund, ka libra dhe protokolle sjellësh, por çdo rast i tyre, sidomos elementëve që kanë cilësi artistike përbën sfida të veçanta. Dhe, Rudina e ka fituar qytetarinë dhe veçantinë në këtë komunitet me punët që prodhon dhe një rendiment, i cili i tejkalon normat e zakonshme.

Rudina është një individ që ka marrë dhe e ka ndërprerë disa arsimimin, por që falë këmbënguljes ka arritur të përshtatet. Tashmë, duhet vlerësuar gjykimin dhe zgjidhja e prindërve të saj që arritën ta kanalizonin 30 vite më parë drejt pikturës dhe ndihma e

parë e

piktorit udhëheqës Bashkim Dervishi. Ky i fundit e disiplinoi brenda hapësirës dydimensionale të telajos, ku dimensionin e tretë vajza e shtoi me përfytyrimet dhe realizimet e saj. Prindërit kapën momentin dhe i dedikuan bashkë me jetën e tyre dhe një studio, ku ajo krijon sot e kësaj dite. Sot, Rudina mund të numërojë me mijëra punë, kurse kritikëve vendas dhe të huaj i bëri që të gjykojnë për botën e këtyre njerëzve me cilësi të veçanta, e me një ndjeshmëri të rrallë. Teknikat e saj janë të larmishme dhe vajza përdor lapsin, stilolapsin, lapsa me ngjyra, grafit, akuarel, tempera, tush kinez, guash, pastel, akrilik, vaj, kurse baza që mbështet është bejza,



kartoni, letër, dru, letër alumini, qelq, etj.

Shkrimi që nuk ka punë qëllim të bëjë kronologji të punëve të saj do të shtojë se pikturat e Rudinës janë shpërndarë dhe u ekspozuan Kosovë, Bullgari, Bosnje-Hercegovinë, Danimarkë, Estoni, Hungari, Itali, Irlandë, Francë, Zvicër, Finlandë, Poloni, Kroaci, Sloveni, Greqi, kurse asaj i janë kushtuar 30 cmime, diploma, certifikata, dhe vlerësime nga kritikët.

Pra këtij albumi jetësor ku duket se është bërë një përmbledhje e arritjeve dhe një koncentrim i gjashtë albumeve të mëparshëm, punët e saj gjejnë tashmë vend në galeri e ekspozita private ne Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi, Serbi, Itali, Sloveni, Greqi, Bullgari, Zvicër, France,

Kroaci, Luksemburg, Gjermani, Estoni, Letoni, Finlande, Suedi, Rusi, Kinë etj.

Në rastin e saj duket se edhe shkencën nuk mund të thotë më shumë: pasi puna e saj e jashtëzakonshme ka qenë një lloj mediumi, ku njerëzit njohin imagjinatën e një njeriu me të cilin nuk komunikojnë, regëtimat e shpirtit të një qenie tejet të ndjeshme, por edhe një lloj instikti artistik, që falë saj ne e kemi si të gjallë në krijimet e veta, e që shërbejnë si një aparat regjistruar i impulseve të jashtëzakonshme artistike. Bukuria e të gjithë punës së saj është vlerësimi që ajo gëzon dhe sot paraqitet si një nga artistët me një aftësi për ta veçuar dhe për ta paraqitur ashtu si është përballë nesh.

Rudina nuk është më fenomen, ajo është një realitet që na është imponuar me formën dhe mënyrën sesi e administrojnë kompozicionin dhe ngjyrën, kurse për kritikë shumë finë punët e saj paraqesin një mistikë që e prodhon instikti dhe që ajo di ta përcjellë me artin e vet brenda hapësirës dy dimensionale, por që i vendos regjistrat e duhura të ngjyrave dhe mënyrën sesi përcjell genien humane. Rudina me këtë album kap një stad institucional të artit të saj.

→ Vijn nga faqja 15

jëherë ndodh që tabloja t'i ngjasojë me shume motivit se sa artistit . Për mendimin tim , gjerat marrin vlerat e tyre vetëm kur kanë të bëjnë me mua " . Kjo thenie përsëhendet sagen piktorale të Maksit . Vetë titujt e pikturave misherojnë artistikisht vetë artistin qoftë me simboliken ashtu dhe artndërtimin .

U gezova fort për tablotë e tij të reja që u ekspozuan tek galeria FAB . Dallova një Maks plot shkëlqim dhe shpërthim . Ndonëse formatet ishin jo të mëdha , habija është e madhe . Titulli alegorik - " Fshati primitiv ndriçohet nga me-teorët " , me tingëlloj si : Shqipëria ndriçohet prej ngjyrave të Maksit . Dhe vet fjalët e titullit janë transferuar në ngjyra . E besoj që kjo nuk është rastësi . Ai është mjesh-tër i fjalës por mbi të duket se preferon fuqinë e ngjyrës . Të gjitha eksperiencat që zotëron i janë dorë-zuar ngjyrave të tij . Titulli gjith-ashtu le të kuptosh destinacionin ku me në fund piktori ka mbërritur . Ndriçimi përmes ngjyrave është një apoteozë . Prandaj miku im duke qaj i shqetësuar në prag të ekspozitës . Nder tablotë e fundit të Maksit shpallet një interpretim nga një kendveshtër i kundërt me artin e realizmit socialist , madje duke e sfiduar atë . Piktori u shpreh se tablotë e fun-



shijen e lartë . Cilësi tjetër e ciklit primitiv është konceptioni i pastër monumental , thjesht se piktori është i prirur ndaj kësaj gjeje që në zanafille . Tabloja virtuozë - " Nata e Shen-Bartoleumit " është ideale për tu realizuar në tekniken murale të mozaikut në eksterier . Vërtet e shoh qartë këtë transferim në tjetër material . Miro , Chagall , Leger , etj na kanë treguar suksesin e këtij arti . Tradita murale duket është shuar tek ne . Imazhet e Velos duhet të aplikohen . Ato e meritojnë . Pengesa është vetëm ligësia dhe paragjykimi . Ne figurat që lëvizin balle njerëz-tretës dhe që të kujtojnë komplek-sitetin e marrëdhënieve njerëzore dhe nen ritmin e dansit kozmik të

vetëshpjegojnë simbolikat e shumta dhe krijojnë iluzione . Përplasja e ngjyrave komplementare në tekniken e akrilikut mbi letër shpesh i provokon dëfrimot . Të gjitha format dhe raportet kromatike janë të animuara dhe gjallojnë sipas programit drama-turgjik .

Dhe dekorativiteti është tipar dallues . Shpesh imazhi është i rrafshët , për pasojë me primitiv dhe i ngathet në ngurtësimet e formës . "Mosmarrëveshja " , " Byroja politike " , të kujtonin kaligrafinë ose dhe grup skulptur-at moderne me tentacionet dhe gjestet agresive . Ngjyra ne-to është me flagrantë . Brenda një ngjyre ka shume kalime . Velo përdor shume teknikë që shpesh nuk kuptohen si janë realizuar . Pikturat të çojnë në thellësitë e jetës . Format organike apo sende arkeologjike , rizgjojnë dhe duan të jetojnë , në paqe apo konflikt , të kërcejnë apo flasin në një jetë të re . Shpesh flas me prof. Velon për ato që ne shohim , ne galeritë dhe galeritë Parisiane . Ai shkon shpesh atje . Vizitat ne muze janë rituale dhe seanca purifikimi dhe verifikimi . Tepër kurioz për të ditur dhe prekur direkt , ato që i janë ndaluar i bën të tjtat duke i vizatuar direkt si një student . Një seri skulpturash bashkëkohore nëpër qarqet , detaje pikturash dhe zbulime ne muze ende të pa njohura për të . Udhëtimet piktorale Parisiane , me pastelet dhe bilok vizatimi janë tash të publikuara prej tij në dy libra artistit . Me përpara ai nuk mund të shihte "Fshatin primitiv " prej sallave të Louvrit por , sot dhe prej vitesh e ka këtë pike veshtrimi që i jep mundësinë të ridimensionojë gjithçka që përjeton

Një episod që qëndron bukur krahas ciklit të fundit janë dhe disa nudo . Ndër to spikat studio nga ku piktori dhe modeli i femrës nudo që pozon mbi divanin intim të dhomës së ngushtë të artistit . Interieri , në tre faqet e dhomës mbyllet me piktura . Poshtë mbi qilim r i një qen i vogël me shikim të gjallë . Shapkat poshtë divanit të kujtojnë detaje e pikturave të Gogenit , Manet , Matisit etj . Cepi i tablosë në krahun e djathtë krijon një trekëndësh që thymen qetësinë dhe ekuilibrin paqësor të skenes . Poshtë diagonale se telajos një vazo penelash zbukuro-n strehen ku pikturohet . Vetë piktori me fytyrën e tij flet shume për "fshatin primitiv" rregullimi i formave dhe ngjyrave të kujton Matisin . Gjithçka është paqësore . Maks i gjen në pikturë atë që jeta nuk ja ofroi për një mijë arsy-e dhe ajo që ka kërkuar nuk është me shume se kaq .



dit janë produkt i fantazisë dhe improvizimit . Fantazia është forca shpirtërore që lind figurat prej gjerave që nuk ekzistojnë . Arti i tij nuk buron prej botës se natyrës po prej përfytyrimeve . Ai ka zhvilluar marrëdhënien me vetveten . Maksi është rast i veçantë brenda artit Shqiptar të akademizuar dhe dogmatizuar si prej politikës ashtu dhe ideologjisë . Ndryshe prej shumicës , ai ndoqi tjetër rrugë veformimi dhe deshi-ron të tjetër destinacion . Besonte të arti i lire dhe bashkëkohor për të cilën u persekutua . "Kurajua dhe forca për të krijuar - thotë Leonardo da Vinci - lind përmes sh-trëngatës dhe vdes prej lirise " . Por , mjeshtri Velo nuk di të abuzojë me lirine dhe me ekspozitën e tij të fundit i thur lavde asaj . Fshati primitiv të FAB u shfaq si një sip-par teatri , plot aktores , ngjyra , forma dhe fondale të dramave njerëzore

Piktura e Velos ngjet me një orkestrim muzikor dhe frymezo-het prej saj . Personazhet ne episod-et kryesore të kujtojnë baletin modern ku gjithçka leviz harmoni-shem . Tabloja " biseda e papërfunduar " dhe " zemërimi i butë " të mahnitin me spontanitetin dhe

pikturës - " Zogu i artë " na dhuro-het plot talent një bukuri e pa-shembullt e ndërthurjes se ngjyrave me volumet delikate . Lëvizjet e qenieve humane ne hapë-sirën e ultramarines dhe menyra si ndriçohen ato , paraqesin pa medysheje nivelin e lavderuar të mjeshtrisë së Velos . Gjithashtu një si kjo vepër mund të ridimen-sionohet me sukses në tekniken e vitrazhit të sotëm dhe me siguri do ngrohe sallat e flohta të bu-rokracise

Tjetër tipar që shoh ne tablotë e fundit por jo vetëm ne to , është mënyra stilizuese e formave , ngjyrave dhe vetë kuadrimit të motivit . Dhe pavarësisht kësaj , bazat e ndërtimit të tablove nuk prishen . Nevoja e autorit për reduktim dhe thjeshtëzim të for-mave vjen prej prirjes modernistë drejt një forme puro . Ai synon for-men e pastër dhe për këtë , përdor ngjyren , ashtu si bënin L'Corbusier apo Ozenfant . Kjo verohet të tabloja - "parade mode " , një shpër-thim i spontanitetit dhe muzikes ritmike

Tani piktura e Velos është e çliru-shem nga shpjegimet e tepërta . Ajo është bere me e filtruar , përparësi-kane raportet ngjyrore . Ato

HISTORI

NGA ANDON ANDONI

I shte e shtuna e dytë, 12 qer-shor 1910 , kur djaloshi i ri, Kostë Çekrezi, me cul lufen e ngritur mbi ballë, hinte rrugicat e kalldrë-m-ta të Korçës dhe ndiqte pas, në të dalë të Mborjes, të atin, një bur-rë i shkurtër e fjalëpakë. Në një-rën anë të mushkës kishin ngarkuar një valixhe druri të mbushur me libra dhe fletore dhe, në anën tjetër, dy velenxa leshi të punuar në vegjë.

I ati e kishte pyetur për për-fundimin e shkollës dhe ai, pa dashur të fliste, i kishte zgjatur dëftesën. I ati e dinte më mirë se kushdo tjetër se ç'do të thoshte t'i kishë në dëftesën e gjimnazit grek të Korçës të gjitha lëndët "shkëlqyeshëm" . Ai vetë, një nëpunës në fshatin e tij, në Ziçisht, ndihje krenar për të bi-rin, i cili, në përfundim të gjim-nazit, vlerësohej me notën sh-këlqyeshëm (9.55), duke i hapur vetë udhë për të ndjekur stu-dimet universitare. Pas lëndëve dhe notave shënoheshin edhe emrat e profesorëve, ku Anastasi, i ati, mbajti sytë mbi emrin e njërit prej tyre, Spiro Kondës , të cilin e kishte takuar disa herë gjatë atyre viteve...

Në të përpjetën e Moravës, përmbi Mborje, Kosta veshetroi edhe njëherë mbi çatitë e mur-rme të qytetit të Korçës. Shën Triadhën e mbuluar nga selvitë e gjelbërimi, Mitropolinë dhe, pak më tej, brenda oborrit të saj, ndërtesën dykatëshe të gjimna-zit, ku kishte kaluar gjashtë vitet e shkollës, dy në ciklin e ulët dhe katër në klasat e larta . Tani, për djaloshin tetëmbëdh-jetëvjeçar po niste një jetë e re, e çelur prej diturish të nxëna në gjimnazin e vetëm të asaj kohe në qytetin e Korçës. Por gjithë ata libra që kishte shkruar nëpër duar , sidomos ata të historisë që e ndillnin më shumë, kishin hapur një rrugë të pashkelur në jetën e tij. Por ai u josh së tepërmi edhe nga lënda e "poli-tikës", të cilën, në gjimnaz e jepte "një nga edukatorët më mendjen-dritur që ka sot Greqia (në vitin 1927- A. A.) , profesor Pandeli Handeli, i cili ardhni në Korçë më 1909 drejt e nga Universiteti i Berlinit... Ne, studentët e tij, e mbajmë mend atë arsimitar të çuar me mirënjohjen më të gjallë dhe me dashurinë më të sinqertë" , do kujtonte Çekrezi.

Si lanë pas Mborjen, morën përpjetë drejt Gurit të Cjapit nëpër udhësitën e ngushtë të malit, të mbuluar nga shkurret e drizave dhe ahishtave. Dolën në Çardhak. Fusha e Korçës shtri-hej deri në këmbë të Malit të Thatë dhe, më tej, në Grykë e malit të Ivanit, dukej zona e Pre-spës, me malin e Pellës atje tej. Pella e Aleksandrit të Madh të Maqedonisë dhe Korça janë shumë afër .

Udha ishte e rrahur nga fsha-

tarë e druvarë që zbrisin drejt qy-tetit dhe të tjerë që lëvrinin malit: kaçakë, çobanë, muhaxhirë, hyzmeqarë.

Pylli oshtinte nga cicërimat e zogjve dhe bilbilat ia buçitnin këngës pranë ujërave të përrenje që rridhnin me gurgullimë diku larg. S'është çudi, që prej kësaj ndjesie, ai do të vendoste të jetonte, vite më vonë në Amerikë, pranë një pylli në Arlington Virginia (1918 North Kirkwood Road), që nga filli-mi i Luftës së Dytë Botërore e deri sa vdiq, më 1959-ën.

Djali pyeti për shokët: Gaqo Pe-tren, Vasil Dumen, Grigor Sotirin, Andon Spiron, Spiro Donushin, Thimi Kiçon, Petro Llazin, Thoma Nasen! I ati i kishte folur për të gjithë me radhë.

"Vasili, ja, ashtu, aguridhe, me çomagën e kolendrave gjezdis fs-hatit akoma. Andon Spirua u kthye pe Amerikës së bardhë. Ka sjellë një gërnëtë. Phë! Fare budalla, gjer në Amerikë për një gërnëtë! Gaqo Pe-tren e kemi bërë kryeplak. Është pak më i madh se ti, posi!ë". Të tjetër, në Amerikë...

Djaloshi tetëmbëdhjetëvjeçar tani s'mund të barabitej me shokët. Edhe pse i kishte zili, se mjaft prej tyre ishin treguar më trima tek-sa kishin kapërcyer oqeanin dhe kish-in marrë udhën e botës, duke punu-ar nëpër ca fabrika e miniera deri në zemër të tokës, ai kishte sh-kollën. Pa folur pastaj për lemer-inë e nënave dhe grave kur ndiqnin në udhën e kishës pa Dhimitrin tek drejtohe në ndonjë portë për të dhënë "mandatën e zezë" për ndon-jë nga burrat e ikur.

Nërsa jetonte me historitë e fs-hatit, sidomos me të ikurit drejt Amerikës dhe letrat që dërgonin prej andej dhe ndiente një tundim të fortë për t'iu bashkuar të ikurve, Korça, nga ana tjetër, me jetën e saj të quditshme, kishte lënë gjurmë në rininë e tij të parë, saqë, në vitet e mëvonshme, do ta quante "Korça, qyteti më Evropian dhe më i ndry-shmi i Shqipërisë".

Doemos që kishte sjellë ndër mend dhe shoqëzat e dikurshme: Gligjirinë e Gaqove, Lirikën e Prift-it. Disa javë më parë, në ditën e Pa-shkës së Madhe, Gligjirinë e kishte takuar në rrethinat e kishës së Ziçishtit. Njerëzia ndiqnin papa Dhimitrin që këndonte troparen. Lulet e verdha të pashkës kundër-monin dhe, në atë gjysmë terr, të ndricuar nga qirinjtë e besimtarëve, ai i ishte afruar Gligji-risë së Gaqove. Merrte frymë me zor. I pengohet gjoksit dhe i dridhej zëri. Ndoshta nga freskia e natës së fillimmajit.

Gligjiri! Dalim nga Llënga...ë Ajo e kishte parë drejt e në be-zëzat e syrit...

Kostë, ti tashi je djalë me sh-kollë të madhe dhe unë...

Atëherë, ai i kishte shkuar dorën pas belit dhe e kishte puthur rrëmbimthi nëpër faqet që i mban-in tërë emjan. Kishin fërgëlluar dhe dridhur si degët e qiparisave në

Kostë Çekrezi është një nga katër liderët e komunitetit shqiptar të Amerikës, pas Faik Konicës, Fan Nolit dhe Kristo Dakos, ndërsa vet Fan S. Noli do ta rendiste si "ndër tre njerëzit që mund t'i sillnin dobi fatit të Shqipërisë" dhe "punëtori më i madh që ka nxjerrë Përlindja Shqiptare". Autori, që ka shkruar një monografi për të përpikët të shpjegojë hershmërinë e kësaj figure të shquar dhe gati të harruar...

Jeta e panjohur e Kostë Çekrezit në rininë e tij

(31 mars 1892- 10 janar 1959)

krah të kishës. Ky ishte një fshat i veçantë. Me djem e vajza çapkëne, që i binin deficit në dasma dhe mbushnin sofatet e portave me gaz rinie deri në agim, aq sa në ato kohëra më hokatori i fshatit kishte thënë: "Sa sisë shtridhen në këtë fshat, nuk shtridhen në tërë botën".

A thua se ky djalosh, pa dërsur ende mustaqet, do ta merrte me vete ketë shpeng dashurie dhe lirie nga Ziçishti i tij, për ta përndarë deri në sallonet më të larta të aristokracisë amerikane, franceze, si i barbartë mes të barbartëve? Ja, si do të shkruante gazeta amerikane, "The Charleston Gazette" për të:

"Diplomatët beqarë janë gjithmonë tepër të kërkuar nga të zonzat e shtëpisë (ku organizohen mbremjet)... Katër a pesë vjet më parë (është fjala për vitin 1922 - A. A.), ata që merren me llafe kujtojnë një "komisioner" i cili i bëri mjaft vend vetes në shoqërinë e kryeqytetit (Neë York - A. A.). Ky ishte Konstandin A. Çekrezi, njeri i paraqitshëm e burrë i fjalës nga çdo anë që ta zije. Asnjë mbremje s'quhej e plotë pa të. Janë të shumta vajzat me të cilat shoqërohej ngado".

Ngjiteshin në udhën e malit të Moravës, ndërsa përballë u vinin karvanët e kuajve të ngarkuar me qymyr, bulmet në varela druri dhe qepë të thata, aq sa ishin gati të përplaseshin me hajvanët. Kaluan Gurin e Cjapit dhe udha fillonte të shtronte në të tatëpjetë nëpër pyll. Si u gjendën mbi Bradvicë, qëndruan te varri i dhespotit.

Pamja që hapej përpara tyre ishte e mahnitshme. Tërë fusha e Devollit, deri në Kosturin e llamburitit nga çatitë e mbuluara me teneqe të ndritshme, dukej si në pëllëmbë të dorës. Prapa kodrave, në lindje, gjendeshin Negovani, Ballkameni, Revani, Shagu, Slimica, të gjitha fshatra shqiptare, që vetëm fare pak vite më vonë do të mbeteshin tej kufirit. Lumi, që kalonte përmes fushës, gjarpëronte nën shelgje e pemë dhe humbiste tej në këmbë të Malit të Thatë. Kodrat e bukura që vishnin të dy anët e grykës së lumit, dukeshin si të lara në argjend.

Babë e bir pinë ujë te çezma e Gjergos, aty pranë varrit të dhespotit, dhe i ati u kthye dhe bëri kryq. Ai nënqeshi:

"M'u tek lumi i Veleçishtit / Na u mbyt veqil i Krishtit. / Atje s'mbytej asnjë pulë, / Na u mbyt dhespot me vulë".

- I kujt dhespoti është ky varr, o babae

- I dhespot Fotit, dihet ...

- Që vranë para katër vjetësh çeta e Spiro Ballkamenitë

Anastasi kishte vështruar nga



Aleksadër Meksi për Kostë Çekrezin

"Qenia e tij kundërshtar i regjimeve autoritariste, pushtuese e diktatoriale ia mohoi këtë vend për më se një gjysmëshekulli me heshtje dhe harresë të qëllimshme. Në Shqipëri mbizotërojnë mitet, heronjtë kordhëtarë që vetëm ata kanë luftuar pushtuesit duke i mundur, vetëm ata bënë pavarësinë, shtetin e diktaturën, të mirat e të këqijat etj. Po kështu në arte, letërsi e shkencë".

gryka e luginës ku shtrihet fshati i tyre, Ziçishti, dhe kishte thënë vetullngrysur:

- Paçka, nuk të hajet dora për të bërë një kryq e për të thënë: "Ndje, o Zot, ku ra!"

Djali e dinte mirë se pse e kishin vrrarë dhespot Fotin në malin e Moravës dhe të zezat që kishte bërë me dorën e ca të ligjve ndaj fshatrave të Ballkamenit dhe Negovanit, kundër patriotëve shqiptarë që kërkonin gjuhën shqipe. I pat dëgjuar ndodhitë dhe të treguarat në takimet e Lidhjes Ortodokse që ishte themeluar në shkurtin e një viti më parë në Korçë nga patrioti Mihal Grameno.

Këto biseda zinin vend edhe mbremant në sheshin e vogël të Ziçishtit nga burrat që ngjasin muhabetet dhe luajn kartat e bix-

Kostë Çekrezi për Shqipërinë

"Vend misterioz", "Vend i mrekullive", "Shqipëria e panjohur", "Më e errët se Afrika e errët"; këto janë vetëm pak nga cilësimet jo të zakonshme për vendin që banohet nga populli më i vjetër në Europën Juglindore...

Sidoqoftë, sot nuk ka dyshim se shqiptarët janë raca më e vjetër në Ballkan... Pavarësisht nga kjo, problemi i Shqipërisë është një libër i palexuar jo vetëm për publikun e gjerë, por edhe për njerëzit që janë seriozisht të interesuar për të.



Anastasi Çekrezi, babai i Kostë Çekrezit

hozit. Kërkesa për përdorimin e gjuhës shqipe në shërbesat ortodokse zuri të përhapet me shpejtësi, madje edhe nëpër fshatra. Në Progër dhe Tren, fshatarët ishin marrë vesh që të mos e qasnin dhespotin, para se t'u japë leje të mehojnë shqip në kishën e tyre. Madje në Tren, fshati e kishte përzënë priftin kundërshtar. Edhe në Dardhë, ca ishin për shkollën shqipe, si Dhamo Çeku, e të tjerë, mes tyre mësuesi i greqishtes Ligor Suljoti, për të kundërtën. Edhe në Ziçisht ishte e njëjta gjendje: ca e kundërshtonin, ca e mbronin. Gaço Dhaskalli ishte kundër.

- Më ngjan se je pëzier në atë shoqatën "Lidhja Orthodokse" dhe kërkoni të kënduarat e tropeve shqip... Duan meshë shqip, shkolla shqip. Të kanë parë që ngjisin letra në dyert e kishave; mos më thuaj jo!

I biri nuk i ktheu përgjigje.

U nisën tatëpjetë Bradvicës. Te Shën Thanasi i Gjyresit, atje ku udha ngushtohet mbi shkëmb, te vendi i quajtur Kallat, u takuan me një burrë që ngiste pas një gomari trupmadh dhe që e grahte çdo cast: - Ush, o derr pe derra! Kosta kishte bërë buzën në gaz.

Burri, që kishte ulur kokën pas barqeve të gomarit, e grahu së dyti: -Hë, më të çaftë kauri!

Rrugëtarit ishte muhamedan që nga e folura. Kishte veshur një fustanellë të bardhë dhe qillota po të bardha, por që dukej se i ishin lerosur aq keq nga pluhuri i rrugës, sa që ishin bërë të hirta. Në kokë kishte vënë një feste të zezë, dhe tallagani i vjetër dhe i gjerë ia mbulonnte supat dhe krahët nga ku i dilnin arnat e zeza, qepur mbi bërrylat e fanellës së leshit.

Burrat e njohën shoqi-shoqin dhe Anastasi mbajti këmbët.

- Si je, zotërota dhaskal Anastasi Ata fëmijë Vetë, zonzjënë Mirë i keë

- Lavdi Zotit, Ibrahim efendi, ju si jeni andej nga Çipanië

- Shyqyr, shyqyr. Ja, paçë ca bulmet kadeje dhe thashë të hidhem gjer Korçë. Ndofta e shes, a e këmbëj me ndonjë farë misri.

Atë e bir kishin hyrë në fshat. Në të djathtë të udhës, kisha e Shën Kollit, me livadhin rreth saj kundërmonite lulegreqëzat dhe maraqet që zbardhnin lëndimin. Kaluan lumin nëpër urën e drunjtë dhe u futën në mëhallën e sipërme. Te shtëpia e Petrove u tokën me Gaqon Petrin, kryeplakun e fshatit, që u foli i pari greqisht.

Kosta nuk iu përgjigj.

Anastasi e kishte parë tërë inat se, ndërsa Gaqua i fliste greqisht, në gjuhën e shkollës, ai i kishte kthyer kurrizin. S'ishin shumë larg në moshë të Por që t'i ishin mend me ato pesë fjalë greqisht të mësua ashtu vjedhurazi, kushdo që të ishte folësi, nuk e hopepste dot.

Ndoshta, dhe tërë ai indulgenizëm i mëvonshëm ndaj grekëve, do t'i vinte edhe për shkak të kësaj urrejtjeje që kishte për burrat e fshatit, kurbetçinj të kthyer pas vitësh të gjata në malet e Athos-it apo të Pisoderit e deri të Thrakës që muhabetet i këmbenin greqisht atje përpara dyqankës së Vasil Ogenrit dhe jo në gjuhën e mëmës, shqip.

Ndajnatëhera e asaj mbremjeje qershori, por dhe më tej, ishin një harlisje pas botës së rinisë së tij, me vërsnikët dhe shoqëzat e fshatit. Natyra e bukur me pemë dhe gjelbërim, me lumin që kalonte mes përmes fshatit, ishin një këndëllje e këndshme në atë oazë të qetë dhe të begatë, që do ta sjellë ndër mend

dhe në librat e këndimeve për çunat, që botoi më 1921-shin, Ziçishtin e tij, "në rrëzë të malit Moravë, në një vend extraordinaryisht të bukur".

DREJT UNIVERSITETIT

Ato ditë të vjeshtës së 1910 ishin përhapur zërat se në fshatrat përreth kishin ndodhur të pabëra dhe të pandodhura nga taksidarët turq. Lajmet që vinin herë-herë, për vrasje e plaçkitje sa nga taborë turq, aq edhe nga grekët, ia kishin shoshitur mendjen të riut Kostë Çekrezi.

"Ata kishin ardhur papritur dhe i kishin thënë se djali i tij duhet të shkente ushtar, në ushtri me turqit. Më pas, ushtarët nga Anadoli e kishin rrethuar katundin, kishin hyrë nëpër shtëpi, kishin hapur sëndukët dhe kishin grisur dyshekët me kashtë. I kishin thënë se po kërkonin për pushtë të fshehura. Kur fshatari u kishte thënë se nuk kishte pushtë, ata e kishin rrahur për vdekje. "Kaur!", i kishin thënë, na jep armët ose do të të vrasim!" Ai fshatar kishte pasur ca para dhe ua dha që ta linin me aq. Tani, priftin e kishës së fshatit e kishin prangosur dhe e kishin çuar në konak. Ashkursun e dinte se për çfarë".

Ai që kishte treguar këtë histori nga Ziçishti që kalimtar i rastit në udhën drejt Korçës dhe sapo ishte kthyer nga fshatrat afër Kosturit. Bënte be e rrufe pa të kishte parë me sytë e tij: Fundja, në Greqi nuk do të kishte këtë makth dhe ligësi shpirtit.

"Turqit, turq hesapi, po grekët më tjetër duhet të jenë". E ëma i kishte thënë ato ditë se vuçe Vllogjua ishte përgjigjeje me kartë dhe kishte thënë: "Ma dërgoni djalin këtu në Athinë, se do kujdesem unë për të". Kostë Çekrezi kishte fituar të drejtën të shkonte në Universitetin e Athinës, por të ëmës, Thomaisë, i ishte dukur larg, ndaj kishte preferuar Selanikun dhe i biri do mësonte në shkollën e Lartë Turke të Selanikut. Studimi në një nga universitetet e Greqisë ishte një e drejtë që e gëzonin të gjithë të diplomuarit në gjimnazet greke jashtë Greqisë. Në Athinë, prej kohësh, kishte shkuar për studime edhe i kushëri i nga nëna, Vasil Xhaçka, ndonëse ishte dy vjet më i vogël. I ati i kishte vdekur dhe e kishte lënë Vasilin dy vjeç, kështu që Evlogji Kurila e pat marrë të motrën, nënën e Vasilit, të mbetur të ve dhe e kishte martuar në Greqi. Vasilin ishte rritur në shtëpinë e Çekrezëve. Të dy Kostë Çekrezi dhe Vasil Xhaçka, shkollimin, punën, përndjekjet, fatin dhe, madje, edhe jetën dhe fundin e saj do t'i kishin thuarje njëllë, që gjatë viteve '30 kur drejtonin së bashku, në Tiranë, gazetën "Telegraf", "Ora", "Vatra e Rinisë", "Diana", derisa mbyllën sytë.

Kosta do të shkente. Ja në fillim të vjeshtës, ja më tej, në atë kohë kur në fshat fillonin dhe frynin erërat e ftohta dhe gjethet e pemëve, të dardhave dhe thanave, merrnin ngjyrë të kuqe të përflakur.

Te shtëpia e Gaço Turkut gratë kishin larë grurët nëpër ujërat e jazit dhe çupa e tyre, syzeza Glliqiri, hynte e delte nga porta e madhe për mbi çezmën e mbuluar nga llamarinat e bardha. Ai u rrahëve poshtë e përpijetë dhe qëndroi te postafi. Atë çezmë do ta kujtonte me mall, shumë vite më vonë, në pranverën e 1926-ës, kur, së bashku me Vasilin, kushëririn, iu vunë punëve për të shtruar të gjitha rrugët e fshatit me kalldrëm dhe

Jeta e panjohur e Kostë Çekrezit në rininë e tij

(31 mars 1892- 10 janar 1959)

→ Vizion nga faqja 17

mbuluan çezmat me llamarinat të shndritshme dhe sylinarë prej bronzi, -kokë luani, -të cilat i rezistuan kohërave për një gjysmëshekul.

Diku nga livadhet ndanë fshatit këndohej këngë: "Sapo shkrepë dielli./Malet vetëtinë./Gjynah perëndie,/Kush ta shkopsit gjinë". Këngë të bukura për vasha të bukura.

Vajza u afrua tek çezma. Ngriti sytë dhe e vështrroi ballazi.

- Do të shkoj, Gliqiri, në krye të shën Sotirit, ja dy-tri ditë pas tij.

- Edhe ti për Amerikë!

-Jo, në Greqi! Do të vazhdoj shkollën në Selanik. Dobarem të shpëtoj prej ushtrisë së turkut, -kishte thënë nën zë. -Ja, Thomanë e Nases dhe Kovaçin i kanë degdisur kushe-di se nga, andej nga guri i Kamjes. Nuk rrihet në këtu.

Frymët u bashkoheshin përmbi postafin e gurtë.

Ato ditë i ishin dukur të gjata, të verdhulluara. Fshati thuajse kishte mbetur pa burra. Vetëm deri në atë vjeshtë, që kurse ishte hapur Amerika, kishin shkuar 24 djem asaj udhe, prej të cilëve vetëm më pak se gjysma u kthyen në mëmëdhe dhe të tjerët mbetën deri në fund të jetës së tyre atje, pa e kapërcyer më Atlantikun.

Mëngjesin e asaj dite që duhet të nisej ishte si i idhëmuar. Pa shumë gaz në buzë. E ëma, Thomaidha, u ngrit herët dhe, kur i shoqi priste me mushkën ngarkuar, ajo i nxori përpara derës, mbi pllocat e oborrit, kusinë me ujë dhe i tha me zë të ulët:

-Derdh çazë ujë, bir i nënës, që të më ktheesh shpejt e mos më mbesh në udhët e botës, o bir, se të kam të vetëm, se të kam dritën e syve, o bir.

Atëherë, atij iu ngushtua më fort fyti nga mallëngimi. Tërë beharit, e ëma kishte ndezur qiri në kishë dhe nuk kishte dashur që i biri të merrte udhët, por ja që kështu ishte e shkruar. Asaj udhe kishin shkuar të shumtë dhe e burrave të fshatit, plot nga vërsnikët e tij që në moshën dymbëdhjetë vjeç. Evlogji, daja i Kostës, kishte marrë udhët e kurbetit në moshën katërbëdhjetë vjeç...

Kosta iu afrua enës me ujë në pragun e portës dhe, pa kthyer kokën nga e ëma, i pat vërvitur një shoqel të fortë dhe e kishte rrokullisur nëpër oborr. Kishte kërcyer përperjtë mushka nga poterja. I ati e kishte vështruar nën mustaqe. "Nga xhimsi juaj ka ngjarë, kot lodhesh", sikur donte t'i thoshte të shoqes...

Kishin kaluar heshtazi lëndinën e madhe në të dalë të fshatit dhe kishin marrë udhën e arabëve.

KTHIMI NË AHDHE

Me sa duket, uji i kuisë, i derdhur dhe vërvitur me tërsëllëm, kur ishte nisur për të vijuar studimet në shkollën e Lartë Turke të Selanikut, kishte qenë një ogur i paqhtë.



Djem çikshitarë, moshatarë të Çekrezit, Boston 1914

Ai u kthye në vendlindje vetëm pas dy vitësh e pak muajsh. Kur kishte zbritur shkallët për herë të fundit të atij dimri të gjatë, nga ndërtesa e shkollës së Lartë Turke të Selanikut, në këmbë të statujave dhe busteve të njerëzve të shquar, djaloshi sillte ndërmend se lavdia e Perikliut, të gjigantëve të Maratonës dhe të tjerëve që Greqia e lashtë kishte parë, -ky entuziazëm romantik, -shpesh plagosej nga sjellja e grekëve të sotëm, megalomanë, cinikë, përbuzës dhe lakmitarë ndaj fqinjëve shqiptarë. Por, përveç Selanikut, për një farë kohe si braktisi studimet jetoj edhe në Athinë; nga behari i 1912-ës deri në fillim të pranverës kur u kthye në Shqipëri.

Zbriti trenin në Follorinë dhe kërkoi me sy të gjente bashkudhëtarë për në Korçë. Rruga e gjatë nga Athina e kishte lodhur, por dhe e kishte kënaqur në soditjen e vendeve, kodrave dhe fushave që gjarpëronin në anë të detit.

Historia e këtij vendi të lashtë ishte, për të, e pandarë nga njerëzit gazmorë, që nuk dallonin fort prej bashkëkombësve të tij. Flisnin me zë të lartë, qeshnin me gurgullima të forta dhe visheshin thuajse njësoj në të dy anët e malit të Pisoderit. Me fustanella të bardha, kalca të dhirta, tallaganë të shkurtër dhe bluza për mishi të leshta, të punuara me shtiza. Leshi ishte malli më i dukur të cilin banorët e atyre anëve tregtonin dhe përdornin për nevojat e veta.

Kryengritësit shqiptarë në gushtin e 1912-s kishin hyrë në Shkup. Jehona e kësaj kohe të trazuar ish-çer përhapur në tërë Greqinë e veriut e deri në Bullgarinë fqinje. Pasojat e rrëmujën e luftës ai i dallonte tani në stacionin e trenit. Flitej se Turqia ishte shtrënguar, prej forcës së kësaj kryengritjeje, t'u jepte autonomi administrative katër vilajeteve shqiptare dhe grekët po e shihnin me dyshim qëndrësën e shqiptarëve, duke iu kundërvënë hapur krijimit të një shteti autonom shqiptar. Pavarësinë e Shqipërisë nuk e mendonin të afërt. Madje, fqinjët as që e dëshironin një

gjë të tillë. Ai e kishte ndier këtë në sa e sa debate që kishte hasur me studentët grekë dhe profesorët e tyre gjatë atij viti. Këtë e shihte edhe të krekosja apo rurdhja e buzëve që bënin grekët, kur ishte fjala për pavarësinë shqiptare. Ai kishte shkruar dhe botuar edhe një artikull të gjatë në gazetën greke "për fqinjësi të mirë edhe pas kësaj". Dhe e vërteta është se kishte plot figura të shquara kombëtare, sidomos jashtë mëmëdheut, si "Noli dhe shokët e tij, që nuk e mendonin pavarësinë kaq të afërt. Ata flisnin e arsye-tonin ende me argumente e të dhëna të tejkaluara", ndërsa Kosta ishte të më afër realitetit të kohës.

"Shpirti i tij atdhetar u zgjua kur ky njeri (K. Çekrezi-A.), "që rrinte në buzën e detit, një ari që 's'kishte tjetër emër veçse Shqiptar, me sytë e ngulur mbi valët që vinin e iknin të shkumbëzuara dhe i thëthitur në mendime të dëshpëruara", u zgjua nga një lajm, duke hapur me hidhërim gazetën, mëkë kish frikë se këto do t'i shtonin helmim dyke lajmëruar zaptimin e qyteteve të tjerë të Shqipërisë, mbet i mahnitur prej një lajme që e shkruanin të gjitha gazetat. Ishte një lajm që i prurë lotte në sytë, po këtë herë lotte gëzim, që i mbushi shpirtin plot ngazëllim dhe që i dboj q'andë gjithë mendimet e zes dyke i prerë me nënshtypjen e saj të pamasëshme, fuqjen e fjalës; disa kohë mbet i nemitur dhe vetëm sytë e tij i shinë ngjitur mbi këtë lajm të gazetave".

Dashuria për mëmëdheun duket arsyja më e fortë që e bëri Kostë Çekrezin, në fundin e atij viti, të linte Greqinë dhe studimet dhe të merrte rrugën e kthimit për në atdhe. Kjo dashuri do ta bënte vitë më vonë, kur gëzonte të gjitha privilegjet e mundshme si profesor i universitetit shtetëror të Nju Jorkut, në gushtin e 1925-ës, që të kthehej në Shqipëri dhe t'i ujqërgjigje kur e pyesin se "C'shije i gjen kësaj rrojajeje në Shqipëri, pasi ke jetuar 11 vjet me radhë në Amerikë dhe ke shijuar atje tërë të mirat e një qytetërimi të سورë Atyre që më pyesin, do shkruante tek Telegraf-i i 14 gushtit 1927, "dua

tu them që jeta në Shqipëri ka një magji të stërhollë për mua; qëndroj në Shqipëri, -brenda në konditat më të kundërta të jetesës - që të vazhdoj shërbimin tim për këtë vendin tim!"

Dhe shërbimet e Çekrezit ndaj atdheut do të jenë të panumërta deri në ditën që mbylli sytë në 10 janar 1959.

Shënime

Efthim Dodona, "Gazeta Shqiptare", 20 gusht 1999. Të dhënat janë nxjerrë nga dosja e Konstandin A. Çekrezit, sipas deklaramenteve të regjistruar në universitetin e Harvard-it, 1916. Kostë Anastas Çekrezi përdori tri forma të emrit të tij: Kostë Çekrezi, sip thirrjeve në vendlindje, në Zicisht; Konstandin Çekrezi dhe Constantine A. Çekrezi pas përfundimit të Harvardit. Në do t'i përdornin të tri format, sipas kontekstit dhe burimit të informacionit.

2 Po aty;

3 Po aty;

4 Marrë nga periodiku "Tempulli" (1724-1914): "Shkollat e Mitropolisë së Korçës".

5 Po aty;

6 C. A. Çekrezi, "A mund të përdoret gazeta si vegël armimore", gazeta "Telegraf", 24 korrik 1927.

7 Constantine A. Çekrezi, "Albania, past and present"; "The Macmillan Company", New York, 1919 (shih edhe botimin në gjuhën shqipe: Kostë Çekrezi, "Shqiptaria e shkuara dhe e tashmja, botimet "Naimi", Tiranë 2012).

8 Gazeta "Telegraf", 29 maj 1927, faqe 4. Pjesa më e madhe e tyre janë vërsnikë me K. Çekrezin, ndërsa Gëzim Petre është mri i madh ndër ta, në këtë kohë është kryepilati u Zog u xhelozia.

9 C. A. Çekrezi, "Telegraf", 7 prill 1928, f. 1. 10 Një i tillë ndodhet edhe sot në familjen e Piro Nicos nga Zicisht. Në shtëpinë e tij, Kipo Nipo, pati sjellë nga Amerika edhe një makinë "Kadillak" për të cilën mbreti Zog u xhelozia dhe donte t'ia blinte me flori, sapo e pa rrugëve të Tiranës. Por i zot i "Kadillakut" ishte më kapadai se Zogu, bixhozchi i klasit të parë, dhe nuk ia shiti.

11 Sotir Andoni, "I fundit i Kavaliotëve", "Naim Frashëri", Tiranë, 1986, f. 156.

12 "The Charleston Gazette", edidh, 18 Korrik 1928.

13 Foti Kalpudhis, dhespoti i Korçës dhe Kosutrit, vrrarë më 9 shtator 1906 në udhën Korçë-Bradyçik.

14 Edelin E. Jacques, "Shqiptarët", Kadikoy - Istanbul, 1996, f. 454.

15 Po aty; f. 455.

16 Gazeta "Dielhi", Boston mass, 3 prill 1908, f. 3.

17 Edelin E. Jacques, "Shqiptarët", Kadikoy - Istanbul, 1996, f. 455.

18 Burim i cituar: familja e Çekrezit kishte miqësi të hershme me një familje në fshatin Çiponë në Devollin.

19 C. A. Çekrezi, "Telegraf", 29 prill 1928, f. 4.

20 "Center for Democracy and Reconciliations in Southeastern Europe", Shkup 2007, f. 44.

21 Evlogji Kurilla (1880-1961), enëllë gjeodist dhe shkrimtar, posedues i bibliotekës më të madhe në Athinë e kohës.

22 Nasho Jorgaqi, "Fan S. Noli", OMBRA GVG, Tiranë 2005.

23 C'uaru e bija e Vasil Xhaçkës, Sofia, shkup 2015.

24 Nofkë që fshatarët i kishin ngjitur Gazeta Zicishtit për shkak të fshatit, si pjesë e emërtesë turke.

25 Gazeta "Telegraf", mars 1926, lajmërore për shtririmin e rrugëve të Zicishtit dhe punët e tjera botore me kontributin e kurbetinjeve zicshitarë të Amerikës dhe të Greqisë.

26 Sotir Andoni, "I fundit i Kavaliotëve", botimet "Naim Frashëri", Tiranë 1996, f. 64.

27 Dobrem: më e pakta, të pakën, fundja...

28 Thoma Andoni, Anastas Kovaç, vërsnikë më të, në atë vit shërbenin si ushtarë në territorin Guri i Kamjes - Moglicë.

29 Sipas të thënave të Kaci Nastos, bashkëdhëtar me Çekrezin (1902-1989).

30 Ishte zakoni në Zicisht që një burim që nisej për udhë të largët, duhet të derdhte sa më pak ujë nga një enë e mbushur, me qëllim që të kthehej sa më shpejt në atdhe prej emigrimit.

31 Foti Cici, Evlogji Kurilla: rrefim i identitetit kulturor: "Përpjekja", V. 20, 2005, f. 113-127.

32 Dokumenti i vetëdeklarimit të Kostë Çekrezit për t'u regjistruar në "Harvard", 10 tetor 1916.

33 C. A. Çekrezi, "Albania, past and present"; "The Macmillan Company", New York, 1919, f. 115.

34 C. A. Çekrezi, "Albania, past and present"; "The Macmillan Company", New York, 1919, parathënja e Charles Donëer Hazen.

35 From Ekipedia, The free encyclopedia, Florida - Kistoria.

36 Beqir Meta; Federata Panshqiptare "Vatra", Globus R, Tiranë, 2002, f. 40.

37 Kristo Frashëri, burim i cituar, në takim me autorin e librit, maj 2018.

38 Nasho Jorgaqi, "Jeta e Fan S. Noli", OMBRA GVG, Tiranë, 2005, f. 272.

39 Kostë Çekrezi, "Përlindja e Shqipërisë", "Lokë dëshpëruarë lotë gëzim", shkrim autobiografik dhe tregon gjendjen e autorit në ditët e shpalljes së Pavarësisë, më 28 Nëntor 1912, datë 28. Vjeshtë e tretë, f. 6.

40 Gazeta "Përlindja e Shqipërisë", Nr. 26, datë 28. Vjeshtë e tretë, f. 9.

T
TREGIM

NGA ROLAND GJOZA

Thikat, sa herë ju kam thënë, se nuk e kanë vendin këtu. Dhe i hynte nga e para sistemimit të sirtarit të enëve te kuzhinës.

Gruaja, një aktore e famshme, bënte buzën në gaz me një pezëm e lodhje disi të përmbajtur, sikur të thoshte; ma hëngre shpirtin, o zot!

Ajo ikte vruiltas për provat e Joneskos, ndërsa ai vinte përparësen e saj, një cohë me lule, dhe fillonte të përgatiste drekën.

Ishte një nga regjisorët më të mëdhenj.

Pastaj i kujtohej ajo puna e ftesave dhe nxitonte të hapte dritaren nga ana e rrugës. Priti goli na dilte ajo te cepi i pallatit. I foli nga lart për shpërndarjen e ftesave, veçoi ato të regjisorëve, që s'i kishin bërë ndonjë të keqe. Ai mbante mëri. Kishte ditëlindjen pas një muaji, po rregulli e donte që ftesa të ishte në dorën e secilit, që të kishin kohë për t'u menduar, ndoshta edhe për t'u marrë njëfarësoj me të, sepse regjisorii KK ishte disil harbut në mbledhjen e Këshillit Artistik ku miratoheshin skenarët e filmave. Po ç't'i bënte ai zeri, a heshtet para gabimeve trashanike, logjikës strikte dramaturgje, që shpesh bëhej për e lajthitjeve artistike?

Gruaja, Silva Xh tundi kokën, atë përsosmëri greke, finesë e përkorë, që ia kishte ngrënë kokën KK-së kur ishte i ri, i sapodiplomuar në Moskë. Ajo ishte e fejuar me një kolonel nga krahina e saj, një lokalitet i humbur i veriut. Po ëndërronte të bëhej aktore. Ishte shumë e bukur; tejet joshëse, me një kurm të zhdërvjellët, gjeste tunduese, gjer dhe fjala kur e nxirte nga goja, të trondiste me një mbresë shoja.

Publiku mahnitej me figurat e saj, që sido që të ishin, partizane, apo mjekë, mësuese, apo shefe komuniste, të emociononin prej natyrshmërisë, vërtetësisë dhe sidomos, prej atij feminiteti sensual, që e kishte të lindur. Dhe në ato figura kishte dorë i shoqi, regjisorii KK.

Ai e linte pa gjumë. E vinte të punonte pa kohë. I rrinte mbi kokë dhe kur mendohej se gjithçka më në fund që përkyer, ai e shikonte me mëzri, i pakënaq duke belbëzuar: nuk është keq, drejt ta hajë! Dhe kur ajo merrte çmime, ai i jepte atë dorën e thatë, që priste shtrëngim prej tjetrit dhe të mundonte me vështrimin e mistershëm, po sidomos me heshtjen e rëndë.

Ajo ishte shumë e përzemërt, i takonte anës tjetër; temperamentit shpërthyes, ndjenjës, emocionit përplot gabime, që s'bien fort në sy, se i mbulon natyrshmëria dhe vërtetësia. Po ai vinte në plan të parë arsyen, logjikën e flohtë. Dhe pasi ia sqaronte me një gjuhë tejet profesionale, qëllimshëm të thejshet e tejet të kuptueshme, kinse për të ("...megjithëse kane kaluar mbi 35 vjet ai më shikon si një aktore

Një rrëfim gati psikologjik i zgjidhur këndshëm nga autori

SURPRIZA

boshe") varg e vister dobësitë që dilnin se ishin më fort të dukshme, se të mirat, shtonte me cinizmin e tij të zakonshëm, që e kishte bërë vetmitar, pa miq: "e dashur, ti gjithmonë i merr lehtë vërejtjet e mia, nuk ke vullnetin e duhur për t'i korigjuar. Ja... Ajo ngrihej dhe ikte me sytë e rrëmbushur dhe, gjatë kalimit nëpër tavolinë, dëgjonte ta uronin; je yll, të duam shumë, ç'ka më tepër se ty Sofi Loren?

Ai ishte shumë xheloz. Merrte në telefon rojen e portës të Teatrit; Dolën nga provat? Po, kanë kohë që kanë dalë, janë në klub. Pirro i ka ftuar për një kafe... Ajo shkëlqeu... Sa herë është ajo në skenë, unë lë Xhepin këtu, duartrokas i pari... Shko shiko, ç'bëhet atje... i thuaj se kam kohë që e pres te parku.

Ajo dilte me ndonjë aktor, partner në rol, duke diskutuar dhe, atje, pikërisht atje, në fillim të parkut, i kujtohej, jo pa një rrëqethje që e bënte akull të ftohtë, se ai e priste, jo në stol, po i fshehur pas ndonjë peme, me dylbi në sy. Duhet ta ketë parë, sigurisht e ka shquar dhe, për më tepër, ky aktori që po e shoqëron është i ri dhe tejet i pëlqyeshëm si maskull.

Ndahemi? I thotë me një fill zë, me turp, ndahemi se ai ka dalë... I pëlqen të më shikojë vetëm... Po ai teveqel, aktor biçimi, kremar e fodull, njeri publik, i përkëdhelur, as që hante pykë, nuk shquhej prej saj pasi t'i shpjegonte mirë e bukur teorinë e Stanislavskit dhe atë të Brehtit për egon dhe alteregon e aktorit. Ndryshimi qëndron... ngrinte zërin ai, se aktorët flasin rëndom me zë të lartë, edhe pse janë mësuar të bëjnë përshtypje me çdo kusht, pra ndryshimi qëndron në këtë se Stanislavski i jep përparësi emocionit të drejtpërdrejt...

Po ajo s'e dëgjonte më, e linte dhe vraponte nëpër park. Një muaj skena xhelozie. Ai të puthi. Une të pashë me dylbi. Je në vete? Ti ndjell, e ke në gjak, të pëlqejnë kur ta varin, po ata janë...

Sy të buhavitur, ndërprerje të befta të provave për të gjetur një cep e për të qarë. Duhet të duronte, megjithatë, ai, pikërisht ai, me pedantizmin dhe cerebralitetin e tij të skajshëm, bashkë me atë drejtë ironie të pështrir, e kishte bërë kaq të famshme.

Atëherë bëja punën e shefit. Ai ishte në shtëpi, shkruante një skenar bazuar në një roman të madh, të përkthyer në shumë gjuhë. Ish-te mjeshtri i skenarit. Eja nga shtëpia, më tha, kam gatuar diçka speciale, flasim... Kur mbërrita atje, gjeta një njeri të dera. Nuk ka njeri, më tha. I bie e i bie, po s'po e hapin. Kush jeni ju? I vëllai. Vija nga larg. U hap dera. Ai ishte pas saj, përgjonte. Nuk e hapi kanat, po fare pak, nxorri dorën dhe shtrëngoi dorën e të vëllait.

Gabin i përsëritur, i tha, sa herë të kam thënë, ta haje drejt, që kur të bësh këmbë këndej nga Tirana, të më lajmërosh, të paktën, një javë përpara, që të marr masat... U drodha, e ndjeva veten keq, doja t'ia mbathja. Dera u hap më shumë.



Ai mbante përparësinë e gruas në brez dhe një lugë në dorë.

Na futi brënda. I vëllai u ul në divan dhe nuk e hapi gojën. KK më nxori përpara fruta deti dhe salcëra të ndryshme, verë, po ajo që të bënte me fort përshtypje ishte servirja pa një cen. Në grykën e shishes së verës ai kishte ngecur një picetë të bardhë kërç të re, që dhe palosjet i kishte si të ujdësura me art rigoroz.

Ky shkrimtari, më tha, ta shkruajë edhe njëherë romanin sipas skenarit tim. Nuk e njeh fare atë ligjësi krejt të veçantë dramaturgjike që i jep kockë mishit të artit. Prej dramaturgjisë vuan e tërë letërsia shqipe.

Nuk vura re në këtë ligjëratë që më la pa mend, ndonjë fodullëk apo kryelartësi prej skenarit të sapombaruar që vërtet e kishte qarë. I thoshte gjërat kësajsoj, se ashtu i kuptonte. Ai vërtet bënte të pamundurën që çdo gjë që nxirrte nga duart të ishte të paktën në hulli të përkryerjes. Dhe këtë, e them me bindje, se e kishte arritur. Po s'dinte të përmbahej e të sillej njëfarësoj që të mos keqkuptohej. Rëndshëm keqkuptohej e shahej, po kur ndonjë punë e tij shfaqej, i linte të gjithë pa gojë. Salla mbushur e plot e përplot, s'ndjehej miza, madje dhe më i poshtri e përbaltësi, shkonte i shtrëngonte dorën e pari, duke fshirë sytë. Ata që lehinin, më pas, e kishin nga cmira, që ai ngjalle tërbueshëm. Të nesërmen e prisnin si mbret, po ai kishte sjelljet e një oborrtari, sepse asnjëherë nuk ishte i kënaqur me veten.

Guxova t'i them njëherë, ashtu më tym, më tepër për të shfrytëzuar ndaj tij, se njeriu grumbullonte prej atij njeriu mëri; Temë e

sallë kardiologjie ku bëhet prova e biçikletës? (Ishte një skenë e tillë në skenar. Kjo pyetje i bëhej skenaristit dhe regjisorit bashkë. Jo, ishte një lloj përgjigje si të flakej nga krahu i kundërt dorashka e duellit. E pra, kjo mosnjohje vihet re në tërë ndërtimin e skenarit. Kaq. E mbyllte gojën. Ajo konsideratë që ishte ngritur prej dy orësh, shembje e rroposej prej dy fraze, në një minutë të vetme e s'kishte si të mos fyheshe rëndshëm si prej një keqdashjeje, dhe për më keq, një poshtërsie. Po s'ishte ashtu. Kur dilte filmi, vërtetja e tij e dikurshme, që pothuajse s'kujtohej më, rikthehej si temë e ditës në kinostudio. Po askujt nuk i vinte të thoshte se KK e kishte shquarit i pari këtë vërejtje. Rëndom, artisti i vërtetë jokonformist, që e shpreh hapur mendimin e tij, e që në 90% të rasteve është i drejtë, ngatërrohet qëllimshëm me njeriun, që ne rastin tonë linte për të dëshiruar.

I kishim marrë ftesat që para një muaji për ditëlindjen jubilarë të KK-së. Nuk kishte ftuar shumë vetë. Bëheshim pothuajse 30. Ku do ta bëjë? Sigurisht, në shtëpi. Kjo sigurisht nuk vihej në diskutim. Ai s'ishte as i kafeneve, as i restoranteve. Edhe kur e ftonin në ndonjë darkë qeveritare, nuk shkonte. Atje jam i huaj, bëj pa dashje performancën idiote të përshatjes, pra, s'jam unë, gravata ime në grykën time, këmba ime në këpucën time. Në shtëpi jam zot vetë, dëgjoj të tjerët, më tepër, natyrisht, po më vjen mirë që të gjithë janë të vetëdijshëm që ndodhen në një shtëpi të huaj dhe demonstronë ndrojtjen, vetëpërmbytjen, kujdesin për të nderuar zotin e saj dhe këto mua më pëlqejnë fort se më japin gjithmonë ndjesinë kërenare të një avantazhi më shumë.

E përfytyronim me atë përparësinë e djallosur, të lidhur me kujdes në bel, në krye të punëve të kuzhinës dhe nuk dinim me saktësi ç'bente Silva Xh në rolin e përcaktuar qartë prej tij, fill e përpe e rigorozisht, po e merrnin me mend njëfarësoj sikletin e saj të madh.

Kishte veshur kostum, kravata i rrinte pikë për pikë siç donte ai, kjo dukej mirëfilli, u përkul pak dhe sajoi, se ai nuk dinte, një buzëqeshje që i doli si shtijake, dhe ne hymë brenda, nuk e di pse, pa fjalë. Na pritë errësira dhe nuk dinim si të orientoheshim. E dinim që kishte bërë regjisorë dhe në ditëlindjen e tij. U ndezën qirinjtë në shandane, plot 50 qirinj, sa moshë e tij dhe hijet tona u shquan dukshëm ndërsa ne mbetëm si fantazma. Ngriti gotën, morëm dhe ne gotat tona dhe i cikëm buzë më buzë, ndërkohë, kur se kishim mëndjen, shpërthyen tridhjetë, aq sa ishim të ftuar, tapa shampanjash që na ranë kokës ndërsa shkumbëzimi flakërues stërpiku gjithçka si me një të qeshur klouni. Njerëzit e shtëpisë që vunë në lëvizje këtë mizaskenë u zhdukën sakaq prapa një dere që u mbyll pa

zhurmë. Nuk gërvinin dyert e tij si ato tonat, se ai vinte në punë dhe për çdo hollësi banale skrupulozitetin e tij rigoroz. Pastaj zumë vend në karriget që kishin emrin e secilit prej nesh. Kollitje, qërim fyti, psherëtimë, fshirje hundësh, për të mbushur njëfarësoj boshllëkun e krijuar, se ai s'na i vari më, po pa fare ndrojtje filloji të na ndajë supën në ca pjata fajance që bënin përshtypje ngacmuese. Qepshja futej lehtë në supjerën e mahnitshme prej kristali blu dhe nxirrte prej andej një grimë supe larushitëse prej barishteve dhe lloj lloj sajesas kulinarie, të mësuar dhe të shpikura prej tij. Veç përparësinë nuk e lidhi në brez. Iu kthymen njëri-tjetrit dhe nisëm të gjallërojmë mungesën e mizaskenës me humor. Dikush më pëshpëriti; Të bën përshtypje diçka? Jo. Shiko me vëmendje, mungon një person i rëndësishëm... Silva Xh. Më në fund KK e kishim në krye të tryezës, ndërsa anash tij, rrinte një karrige bosh. Po s'kishte emër atje që ta merrnin vesh se e kujt ishte. Po! Pajëve të gjithëfarëshme, ballëkut të hajes së zgjedhur dhe gatuan me aq finesë sa për t'u pastruar zili, prisnim tortën e ditëlindjes që s'po dukej ende. Vajti ora njembëdhjetë, njëmbëdhjetë e gjysmë, ai përherë i rezervuar, kallp në humor, po i pazëvendësueshëm kur bëhej fjaleë për trajtime çështjesh delikate të artit, fill në ora dymbëdhjetë pa një çerek, na foli diçka për shpansin, atë ankh pritës të surprizës dhe pa e bërë në pyetjen, e dha vetë përgjigjen me një buzëqeshje të mprehtë në buzë e hidhim një salcë të panjohur darkës, sone atë që mungon rëndom, sepse, ta themi pa e fshehur, rëndomësia dhe përsëritja e gjërave mbyt sebebet tona. Ju ka bërë përshtypje një mungesë dhe gjatë gjithë kohës keni ngritur një pyetje; Ku është? Pse të mungojë? Pra darkës së zakonshme të një ditëlindjeje i është shtuar dhe një veshje e përkorë arti. Sepse jemi artistë dhe s'bëjmë dot pa të.

Poll kështu me elokuencë të shkathët gjer në orën dymbëdhjetë dhe fiks në atë cast prej një sahati në mur, që s'e kishim vënë re për shkak të dritës së mekur të qirinjve, doli një qyq dhe bëri ku ku dymbëdhjetë here, dera u hap, Silva Xh e veshur me një fustan të zi me refleksë të puthitur pas kurmit të derdhur seksapil, hyri ngadalë duke mbajtur në duar tortën e madhe me pesëdhjetë qirinjtë të ngulur drejt në tre rrahitë ngjyrë kaftë prej kokollatës, mbi të cilën ishte shkruar urimi për KK. Hapat e saj të lehtë e të menduar, (kushedi sa prova kishte bërë për këtë të ecur) u shoqëruan prej sonatës Apasionata të Beethovenit.

E ndau ai vetë tortën. (as këtu s'kishte besim tek ajo), aq këllë duhej të ishte secila prerje, sa të përshkohej prej asaj drite qirinjtë.

Silva Xh qëndronte në këmbë. Ajo nuk u ul në karrigen e saj, gjersa torta u nda dhe ai i tha të ulet.

Kjo ishte, tha KK. Dikush duartrokoi, pastaj duartrokoi të gjithë. Atij i pëlqeu shumë që mizaskena e tij e fundit, ajo e surprizës, pati aq sukses, po nuk e dëgjoi atë që miku im ngjitur më pëshpëriti në vesh; E shkreta, Silva Xh.

...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri ishte relativisht e mirë, por e pa demonstruar fare në faqen e parë të "Gazeta Shqiptare". Për fat të keq, ndihma ndaj këtij suplementi kulturor nuk është as nga vetë Kompania. Zëri i redaktorit shkon në eter edhe pse prej javësh, muajsh kërkon një ndihmë vizive në reklamimin e saj. Shkrimi kryesor iu la një artikulli përgatitur kohë më parë nga Agron Alibali për të drejtën zakonore shqiptare, por trajtuar në formë shumë publicistike. Kjo sprovë e titulluar "E drejta dokësore shqiptare tek "Brezniti e Hankonatëve" rreket të përcjellë disa anë të së drejtës së pashkruar shqiptare të fushës civile, të pasqyruara në veprën e Kadaresë "Brezniti e Hankonatëve". Përndryshe, aspektet më prekëse e dramatike të së drejtës dokësore shqiptare, ato në fushën penale, që lidhen me gjakun, gjakmarrjen, besën, mikpritjen etj, janë trajtuar gjerësisht dhe në këndvështrime të ndryshme nga kritika vendase dhe e huaj, sipas Alibali, që me një mesazh të vonët nga Ëashington-i na u ankua seriozisht për mungesën e pasqyrimin të shkrimit. Vizioni një përgjigje e munguar nga redaktori, që nuk diti se çfarë të shpjegonte.



Marshi i anti-vlerave dhe i gjërave sipërfaqësore kanë marrë revansh të paparë dhe ato e kanë të pamundur të ndalen. Humori banal, muzika tallava, letërsia kitch apo arti në përgjithësi pa identitet dhe dorëzimi para politikës është një dhimbje e madhe, shkroi ai.

Këtë javë vazhduam pjesën e tretë me përshkrimin për jetën e Rilindasit të shquar Sami Frashëri, përgatitur nga Kujtim Nuro, një Osmanolog i shquar, që rregulloi argumentin e gazetarit Hikmet Feridun Es e ka botuar dikur në gazetën "Aksham"(Stamboll), në Dhjetor të vitit 1944-Janar 1945.

Poeti çek Vladimir Voland na erdhi me një cikël poetik shumë të spikatur, përkthyer me impenjim nga Eraldo Hatija. Autori i njohur vinte pas shumë kohësh në faqet e "Milosao". Në këtë numër patëm vend edhe për një shkrim në Oslobogjenje, një nga gazetaret e përditshme më të vjetra në rajon, mbi librin me tregime "Shpinë burri" të Arian Lekës, botuar në Serbi gjatë vitit 2018 nga "Partizanska knjiga, shkruar nga Gjorgje Krajišnik.

Numri ishte relativisht i mirë, por duhej të ishte pak më i prekshëm. Redaktori punoi relativisht arsyeshëm por duhej të kishte pak impenjim më të madh...

Redaktori realizoi një argument lidhur me mundësitë që arti derdh në jetën tonë të përditshme. Po a mundemi vallë të shikojmë më në shpirtin tonë? -vërejtje ai. Me gjërat që po ndodhin në Shqipëri duket realist e pamundur.

POEZIA

Publicisti i njohur vjen me këtë cikël poetik që i dedikohet ndjesive të tij, të lidhura ngushtë me vendlindjen dhe me të gjithë shtratin e vet mitik në një rregjistrë gati burimor. Autori mundohet të vendosë një barazpeshë të këtyre ndjesive në poezinë e ardhur për publikun në vëllimin e tij më të ri poetik...



NGAALEKSANDËR ÇIPA

AVULL NË BRYMË

Nuk u ngri moti, por tringjet e drurëve u veshën me brymë dhe akull për më tepër, të mos të ndiejnë se si pëshpërima bëhet fjala e jetës, mes nesh, dhe jo tjetër. Nuk ndërruan qiejt e as Hëna nuk ndroi, bëri atë rrugë që mijëra vjet ka bërë. Në gjithë këtë ngricë, fryma jonë e përbashkët është avull që ngroh një frut të parënë. Ky dimër që shkon dhe në mall na ka lënë, e shton ngricën, të ftohtën e mbajti. Në akull të tij edhe ti edhe unë, përcollëm dhjetorin dhe janari na zgjati. E shkëlëm këtë mot me diell dhe ngricë me shpirtin dhe gazin puplor dhe peshues. Në ditët e tij u ndjemë aq ngrohtë, ne mbetëm në avull, veç dimri u bë shkues. Motin ku ne ndiemë se shpirti na vloi në stinën me avull që kish kohën gjithë brymë. I donim pemët të flinin nën akull se fryma e pyllit mbars gjethet në një stinë. Nuk u ngri moti, por tringjet e drurëve u veshën me brymë dhe akull, për më tepër Që të mos ndienin se pëshpërima jonë, jetës së frymë të po i shtonte fletët.

E PAQTË

E paqtë ti shkon me hap të lehtë, Këtu ku jam rrëmujë më le. Ta lehtësoj mungesën tënde, Nga vetja ime po të nxjer. Nuk themi më: si ish e ngjau? Ta fshijmë prej vetes çka nuk bën vend. "Për të gënjyer kohën, duku sipas kohës", Kjo thënie e Shekspirin më sillte në mend. Unë mbeta fluger në rrëmujë e paqtë në rrugën tënde ti ike Me ty dashuria ka një vendlindje gjithnjë, Sikurse mendimi në Athinën antike.

AKSIDENTIN ME TY E NDAN NJË PUTHJE

Sa herë në udhëtime ti më përmend rrezikun, Se shpejtësia për mua është adhurim i vjetër Unë kam tekën dhe ti kështillën, kalojmë një rrezik dhe presim një tjetër Nesër, s'është bashku do të kryejmë një rrugë Do të shkojmë diku, do të ndalim më tutje.

Aksidentin me ty e ndan një puthje.

PRIT, THOTË NATYRA

Prit, më tha pema, se nuk kam shterrur rrathët, Gjethet e rëna, janë flijim për rizzjimin,

Në kursorën time ka rritje padukja. Dhe këngë e përhershme është gjelbërimi. Prit, më tha lumi që kurrë s'e ndali ujin, Po imazh i kahershëm i rrjedhjes mbeti. Në brigje të tij u lanë përherë gurët, Ikja, silueta e mirazhe m'i derdhi. Prit, më tha mali, se po më ikën dëbora, Sa pak po më shfaqet viteve të fundit, Kam vizitore më shpesh vetëtimat, Dhe zërat e mjegullës janë heshtja dhe mundit. Prit, më tha deti, se të gjitha pritet, kanë pikëtakimi me mua, prej ujit. Unë heshta ndanë tij, i përkohshëm i frymë, E di që durimi rron e vdes prej unit.

PËR SHPIRTIN JE FE

Gjenevë 2015 Në kupën e qiellit rri butë një re As e pi kush dhe askund nuk bie Në qiell kalimtar për Tokën bëj be Aty ku gjendesh dhe për shpirtin je fe.

Pjerrinës qiellore si udhëtar rrëshqas Ke humbur në sy, në mendje bëj gaz. Ku gjendesh e di, me veten po flas. Shkoj larg, kaq larg, dhe mbetem aty, pas.

Në fushën e qiellit u tret dhe një re, Siç humbi silueta jote atje. Në qiej udhëtarit të njëtrajtshtmen sheh. Dhe ngjet që një zonjë në Tokë e ka fe.

NË TEL TË NËNTË SI ORFEU

Do të vdesë si asgjë edhe kjo brengë që gëlltis kjo dhimbje do të rreshtë dhe për t'u thënë s'do kem mundësi.

Të dyja janë një dhe të dyja do të shkojnë askund, në thellësitë e panjohshme të shpirtit tim të përkohshëm.

Kam pasur kaq ditëbukura, në këtë jetë paqetësi, të gjitha më duhen e i dua paharrim, por s'di ç'do të ngjasë me të ardhmet e pritshme?! Pasi në të afërtat ditë, ti s'ke më asnjë kuptim. Një portë përjetimesh po më mbyllet pas shpine para syve një portë të panjohurash kam, e kam hapin më të ngathët dhe në dobësi të syve me horizontin, mbulime mjegullash ndajmë. Do të vdesë si asgjë kjo e sotme e përbashkët, në kudhër kujipti po e fus distancën e nisur. Mentor i mërzive në qëndroftë shpirti, elegjinë në tel të nëntë të lirës, si Orfeu ta kam lidhur.

MË THA NJË GUR...

(Sipas ngasjes nga Ali Podrimja) Më tha një gur në Akrokerkaune:- Njerëzit dhe vetëtimat nuk janë kujtesa ime! As deti nuk ka histori për dallgët e veta, më tha guri-shkëmb, në Male të Vetëtimës... Më thotë ai gur dhe kur iki larg: Do të lagem dot si rëra e të djeg si zalli. Se detin era e madhe e tund, jo nga thellësia, po nga dallga përmbi. Dhe pastaj lëvizjet...janë histori, Pavarësisht nga njerëzit dhe nga vetëtimat... Më thotë ai gur në Male të Vetëtimës...!

IM AT KA NJË HALL PËR QIEJT

Me qindra cigare ndez e sulmon mushkëritë,

Dhe qiejve u jep sinjale me tymin. Ka kohë që sytë i janë strukur Nën lëkurën e lodhur të fytyrës, Si në zgafellë shkëmbinsh ende fsheh, Metafora manushaqesh të shpirtit. Nën këmbët e tij është deti, Gjiri magjik i Himarës, monofonia tjetër. Po sytë tek malet i ngre, ka aq subjekte... Dhe heshtjen e ngjall si baladë të vjetër.

Ka një hall për qiejt e pafundëm ku qdo e përkohshme si e përhershme rri! ... Im At ka një hall për qiejt...në sy...

RRUGËS LLOGARA-HIMARË

Deti është vetëm dhe unë jam në rrugë. Si hala më shpjojnë mungesat që s'rrështhin. Jam nisur në Himarë të gjej tim Atë, Homerik i parënë, bard që s'humb vreshtin. Shkel brigjet me vrull, zog i pastinë, Mbërrita kaq shpejt te zall i Çezarit. Të gjitha historitë i bëra stivë, Homerit a Odiseut t'i flas të parit? Zalli dhe rëra qysh në zanafillë, Janë triumfi mbi Detin dhe dallgët plaka. Aty ku zgjohen gjithë metaforat antike, Shfaqen e shuhen ngjyrat e rralla. S'ka mite që lindin dhe mite që vdesin, Në brigjet e vjetra të visit Himarë. Aty veç derdhen në gjenerata zënkat, Pë atë që s'kthehet dhe atë që s'është marrë. Në ecje më zunë ca tinguj kambanash, Një meshë e kaltër s'e di ç'frymë jep, Në visin homerik të kohës sime, Ka përherë grimca për libër të shenjtë.

DETI NUK KA PORTË

Për tek deti mos kërkë portë, ku mund të hysh si në shtëpi. Dallga kurrë nuk është një shkallë, As ngjitesh, as zbrer në thellësi. As oborr si tek shtëpia nuk ka, Trokitja nuk vlen për të hyrë. Deti është botë e ujët para nesh, Ka shije të kriptën, shijon zanafillë. Tek rëra e paktë, ku shkel këmba, Janë guaska e gurë të lëmuar, I formësoi Koha ndër kohë, Perëndi e tokës s'pat dur! S'pati dur t'i mbledhë të gjitha, Nga koha homerike e këtej, Po këngë e stërkalave në breg, S'do mundë më zhurmat t'i kthejë. Tek Deti s'ka portë për të hyrë, Të futesh ku fryma nuk mban. Vetëtroket mbi tokën si zemër, dhe dallgën e shpërndan në çdo anë. Deti nuk ka portë ku të hysh...

DYSHOJ SI I VERBËR

Bota është një, e re dhe e vjetër, Fetë iluzivisht na përshkruajnë një tjetër. Fetarisht po ta shpreh dyshimin e egër: Të besoj verbërisht, por Dyshoj si i verbër.

Opinioni **i** Ditës

Bankat si pjesë e sigurisë kombëtare

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... shpresa më e fortë për rritjen ekonomike të qëndrueshme të Shqipërisë, nëpërmjet kredive që japin. Bankat e nivelit të dytë janë asete kombëtare dhe pjesë e sigurisë sonë kombëtare. Kur vidhet një sasi e depozitave të qytetarëve shqiptarë (10 milionë euro) nga barku i një aeroplani në aeroportin ndërkombëtar të Rinasit, kjo përbën cenim të sigurisë sonë kombëtare. Prandaj dhe duhet të ndërhyjë shteti. Ushtria, si një garanci më shumë, ia vlen të qëndrojë në ruajtje të mjediseve të sigurisë së aeroportit për një kohë relativisht të gjatë. Duhet kthyer besimi të rrugët normale të të bërit biznes dhe të ushtrimit të aktivitetit banke. Shpresojmë që kompania shtetërore austriake e fluturimit (Austrian Airlines) të kthejë mbrapsht vendimin e saj për të mos lejuar transportin e vlerave monetare të bankave në fluturimet e veta. Veprimi i marrë në kushtet e krijuara të një pasigurie të theksme. Bankave tregtare duhet t'u mundësohet të transportojnë lirisht paratë e qytetarëve tanë, për aktivitetin e tyre. Lëvizja, transferimi i parave jashtë vendit është një procedurë normale e bankave kudo në botë. Edhe tek ne, bankat e nivelit të dytë, bankat tregtare një pjesë të parave që nuk i përdorin për të dhënë kredi dhe që i kanë nga depozituesit (euro, dollarë, paund britanik, franga zvicerane, etj.), i investojnë. Mund t'i investojnë këto para thjesht duke kryer aktivitet këmbimi valutor (këtu tek ne niveli i këmbimit për valutat është pak më i mirë se sa në tregjet valutore në Vjenë ose Zvicër, për shembull) dhe duke i këmbyer eurot, dollarët, frangat zvicerane apo paundet e shqiptarëve në tregjet e huaja. Ose (dhe kjo është pjesa më e madhe e aktivitetit të tyre normal jashtë vendit) bankat tregtare i vendosin paratë në institucionet financiare jashtë vendit (bankat mëma ose banka të tjera), si formë alternative e investimit. Ky transferim kryhet fizikisht dhe kjo është një marrëdhënie që bankat e kryejnë duke përdorur shoqëritë private të sigurisë fizike në transportin rrugor dhe duke paguar kompanitë e fluturimit për atë ajror. Grabitja e Rinasit ishte e rëndë jo vetëm për sasinë e madhe të parave që u vodhën, por pse ndodhte për herë të dytë në pak më shumë se dy vite (shkurt 2017, prill 2019). Qeveria jonë duhet të punojë me qeverinë austriake, nëpërmjet kanaleve diplomatike dhe kanaleve të tjera, për të siguruar se janë marrë të gjitha masat që ngjarje të tilla të rëndë të evitohen në të ardhmen. Duhet autoriteti dhe



forca e qeverisë sonë, pse mbyllja e këtij "rubineti" të natyrshëm për bankat për të lëvizur paratë që e kanë të lirë dhe nuk e shfrytëzojnë është me shumë rëndësi. Përfytyroni sikur vendimi i Austrian Airlines për të mos pranuar para fizike nga bankat në fluturimet e tyre të qëndrojë për një kohë të gjatë. Mund të bllokohet lëvizja dhe përdorimi i qindra milionë eurove, dollarëve, frangave zvicerane apo

stërlinave angleze. Sepse vërtet kemi rreth 7 miliardë euro depozita të shqiptarëve në euro, lekë, dollarë etj, por ama çdo vit bankat arrijnë të japin vetëm 1.1 miliardë kredi. Prandaj dhe e kanë domosdoshmëri të investojnë përtej kufijve shqiptarë një pjesë të depozitave që pranojnë. Bllokimi i pjesshëm i këtij investimi jo vetëm godet bankat tregtare këtu tek ne, por të gjithë ekonominë tonë. Ak-

Mund të bllokohet lëvizja dhe përdorimi i qindra milionë eurove, dollarëve, frangave zvicerane apo stërlinave angleze. Sepse vërtet kemi rreth 7 miliardë euro depozita të shqiptarëve në euro, lekë, dollarë etj, por ama çdo vit bankat arrijnë të japin vetëm 1.1 miliardë kredi. Prandaj dhe e kanë domosdoshmëri të investojnë përtej kufijve shqiptarë një pjesë të depozitave që pranojnë.

tiviteti banke duhet të vijojë normalisht. Vjena është epiqendra e transfertave fizike të parave për bankat. Nuk mund të jetë as My-nihu apo Londra, ku kemi fluturime të tjera të drejtpërdrejta nga Rinasit. Kjo, pse këto tregje nuk janë seli të bankave mëma të bankave të huaja që veprojnë tek ne. Në të kundërt, bankat tona tregtare mund të jenë të detyruara të ndërrojnë partnerë për marrëveshjet e tyre të investimit të parave të lira jashtë tregut shqiptar. Kjo mund t'ua vështirësojë aktivitetin. Si vend, si shoqëri e qeveri nuk kemi asnjë interes t'ua vështirësojmë jetën bankave që ushtrorjnë aktivitet tek ne. Përkundrazi! Prandaj dhe qeveria jonë duhet të jetë në mbështetje dhe të provojë të bindë qeverinë austriake që të qetësojë dhe të ushtrorë ndikim sigurues pranë kompanisë shtetërore të këtij vendi mik me ne. Shumë interesa jo vetëm të botës bankare, por edhe të qytetarëve-depozitues shqiptarë janë në lojë.

HOROSKOPI

DASHI

Koha është në anën tuaj sot më në fund! Pas një periudhe të gjatë ndjesie sikur të mos kishit kontroll mbi kalendarin tuaj, jeni përsëri në krye. Gjëja e parë që duhet të bëni është që të mendoni për veten dhe të relaksoheni.

DEMI

Sot të kuptuarit e një situatë të panjohur mund të mos jetë aq e lehtë sa zakonisht. Ka një ajër të fortë konfuzioni, që po lundron dhe po sulmon shumë njerëz, përfshirë edhe ju. Kthejeni përqendrimin të çështjeve të thjeshta, por me prioritet.

BINJAKET

Ju padysim dini se si të krijoni një atmosferë të mirë për njerëzit që kenë pranë, por sot meritoni të bëni një pushim. Kjo është një mundësi e mrekullueshme për të eksploruar diçka të re dhe për të provuar diçka, që nuk mund ta kenë provuar më parë.

GAFORJA

Nëse dikush hutohet nga diçka që ju thoni sot, bëni mirë që ta sqaroni me detaje. Duhet të qartësoni mendimet dhe të flisni shkurt. Sa u përket çështjeve financiare, duhet të tregoni më shumë kreativitet për të shtuar alternativat.

LUANI

Jeta juaj e përditshme po kalon nëpër disa kthesa kompleksoze, të denja për një thriller klasik Hollivudjan. Lajmi i mirë është se ju mund ta ndaloni këtë nëse doni! Fokusojeni komunikimin të disa njerëz të rëndësishëm për planet dhe projektet e ardhshme.

VIRGJERESHA

Duhet të tregoheni më të pjekur në vendimet që kanë të bëjnë me dashurinë. Situatat emocionale përdorin në avantazhin tuaj. Mos lejo-ni që një pengesë e vogël të bëhet shkak për probleme të mëdha.

PESHORJA

Nëse do t'ju duhet të qëndroni zgjuar deri në mesnatë për të përfunduar disa detyra të lëna pas dorë, atëherë bëjeni. Nuk këshilloheni që të shkaktoni vonesa me afatet, sepse mund të dëmtoni reputacionin tuaj.

AKREPI

Përpikuni t'i kuptoni njerëzit sot, duke shmangur fërkimet me personat të cilët kanë një opinion ndryshe nga ju. Në dashuri do t'ju duhet të bëni një hap pas për të shmangur geqkuptimet.

SHIGJETARI

Sot bota ka diçka të mrekullueshme për t'ju treguar, kështu shijoni përvojën! Paraja mund të mos jetë në gjendje të blejë lumturinë, por mund t'i bëjë njerëzit të ndihen mirë. Në dashuri jo gjithçka shkon sipas planit.

BRICJAPI

Ka ardhur momenti që të zhvillonit një bisedë, të cilën e keni shtyrë prej kohësh. Të dëgjoni me kujdes dhe të përqendri qartë do të jetë më e rëndësishmja. Në punë keni nevojë për më shumë nxitje, veçanërisht në aspektin financiar.

UJORI

Askush nuk po ju pengon në rrugën tuaj, pra gëzoni kushte fantastike për sukses. Por, jo gjithmonë muga pa pengesa është garanci për t'ia dalë mbanë. Nëse nuk tregoni guxim, asgjë nuk mund të funksionojë. Kjo gjë vlen edhe në dashuri.

PESHQIT

Mos u habitni nëse sot disa njerëz ua thonë gërat troç. Kjo do t'ju ndihmojë që të jeni më realistë. Në punë do t'ju duhet të tregoni më shumë përkushtim për të arritur suksesin që dëshironi.

Dje në "FAZ"

Asnjë të ardhme diktaturave ushtarake!

Nga Rainer Hermann

(vijon nga faqja 1)

... të paktën hë për hë kundër-revolucionin e tyre, në kundërshtim me të gjitha protestat masive. Kjo në një kohë kur prestigjin ato kanë kohë që e kanë humbur. Meqenëse i patën çuar vendet e tyre drejt pavarësisë, të cilën më vonë edhe e mbrojtën, ato qenë të besueshme për një kohë të gjatë. Veç kësaj, në shtetet e reja ato kanë qenë institucioni, në të cilin që i mundur avancimi social edhe për njerëz nga shtresa të varfra.

TË ETURA PËR PUSHTET, TË NGURTËSUARA DHE KORRUPTË

Por e gjitha kjo bën pjesë në të kaluarën e idealizuar. Ushtarakët erdhën në pushtet me premtimin që të krijojnë një shtet të fortë, për ta shkurtuar me shpejtësi prapambetjen në zhvillim ndaj Perëndimit. Por në dekadat e shkuara te ata u forcua etja për pushtet, u bënë të ngurtë dhe u korruptuan. Aparati i sigurisë nuk i shërbente më mbrojtjes së vendit nga armiqtë e jashtëm, por mbajtjes nën kontroll



të popullit. Hendeku midis ushtrisë, si simbol i shtetit të fortë dhe i shoqërisë së cilës i kishin hequr zotësinë për të vepruar u bë më i thellë dhe më i gjerë. Për shkak të të menduarit si në një lojë me

shumën zero - po t'i jap diçka tjetrit, unë kam më pak - shtetet e dominuara nga ushtria ofrojnë pak shanse për avancim dhe nuk ofrojnë më konkurrencë të shëndetshme.

Presioni në kazan u desh që nga ky shkak të shtohet, derisa kazani shpërtheu për herë të parë në fillim të vitit 2011. Aty ku ushtria, aparati i sigurisë dhe shteti i thellë qenë (dhe janë ende të dobët), u bë e mun-

dur që si në Tunizi dhe në Marok - të formohej një pluralizëm i ri shoqëror. Përkundrazi, kudo ku ushtria ka se çfarë të humbasë nga ato që i kanë dhënë me bamirësi, është e gatshme për gjithçka, për të mbrojtur piramidën e pushtetit dhe për të eliminuar liritë shoqërore.

Algjeria dhe Sudani kanë përparësinë që tetë vjet pas kulmit të parë të protestave masive arabe të mësojnë nga përvojat e shteteve të tjera, për të shmangur kështu gabime. Demonstruesit në Algjeri dhe në Sudan vërtet që e pranojnë që ushtarakët nevojiten në një periudhë tranzitore, për të garantuar rendin. Por ata ngulin këmbë edhe që në organet tranzitore të jenë të përfaqësuar, krahas ushtarakëve, edhe civilët.

ORA E NDALUR NË EGJIPT


Vendimtare do të jetë me sa përgjegjësi do të vepronë ushtarakët. Në shembullin e Egjiptit ata vërtet mund të shohin se si mund ta qetësosh një vend me represion. Por koha e diktaturave të plumbta ka kaluar. Ato mundet ta ndalin orën - si në Egjipt. Por e ardhmja nuk u përket atyre.

Te gjitha te rejat nga jeta ipave

BLUE TOOTH THASHETHEME MADE IN ALBANIA

Gazetë shtunë falas me GAZETA SHQIPTARE

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Immanuel filozof.
4. Parashitesë për këteje.
8. Argento aktore.
11. Gjysmë erotik.
13. Janë mamece pa kufij.
15. Rastet pa set.
16. Në mes të dhomës.
18. Rrapo pa çifte.
19. Gardner aktore.
20. Charlie Mingus.
21. Janë pjesë të antenës.
23. Eshhtë e tregut në kapitalizëm.
24. Eshhtë lojtari underi 21.
26. Janë njëvendëshe në Formula 1.
28. Qarkullon vetëm në shqipëri.
30. Ishin komandantët si Çerçiz Topulli.
32. Kishte 100 porta.
35. Në krye të aktorëve.

36. Gjysma e slitës.
38. Inicialet e Reitman.
39. Nganjëherë nuk e vlem qiranë.
43. Një ishull si Bikini.
44. Nisin nga kreu.
45. Një satelit i Uranit.
46. Janë kapo.
48. Shahu i fundit.
49. Janë klasike me tutu.
51. U printe humbje.
52. Në fund djathtas.
53. Instrumenti i Ravi Shankar.

VERTIKAL

1. Një së larti bëhet me stilin fosbury.
2. Kaçaturian kompozitor.
3. Kush nuk di mbytetë.
5. Inicialet e Harris aktore.
6. Një tabu islamike.
7. Ka satelit Ariel.
8. Dy asa.
9. Kështu janë mbrojtjet e palëvizshme.
10. Mund të skadojë.
12. Eshhtë edhe ajo zanore.
14. Ishite futbollit i Holandës.
17. Ishin bakantet.
21. Janë garat me gregarë.
22. Një njëvjeçar.
23. Tekat pa kufij.
25. Një ekip i Kazanit.
27. Fillojnë aksionin.
29. Eshhtë hidrokarbur.
31. Gruaja e Ben Hur.
33. Skuadër greke.
34. Barack në shtëpinë e bardhë.
37. Capirossi i MotoGP.
40. Nuk i tregohen babait.
41. Mund të jete fetar.
42. Jessica aktore.
43. Marsi i akejve.
46. Tri të parat në klasifikim.
47. Gjysmë tatimi.
50. Mbyllin fushata.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Eshhtë hokartari.
8. Loja me full.
13. Kaas këngëtare.
14. Përdoret kundër malaries.
15. Këndohet në opera.
16. Pak formalitete.
17. Eshhtë legjenda.
18. Të fundit konak.
19. I mbjell... katastrofa.
24. I bëjnë të luajturit.
25. Fillojnë mpirjen.
27. Janë trupa qiellorë.
28. Qendër në kaos.
29. Preferojnë vjet e hënën.
30. Tri të parat në atletikë.
31. Beton pa kufij.
32. Ente Autonome Tiranë.

VERTIKAL


1. Catherine aktore.
2. Një vijë e lakuar.
3. Tatim pa kufij.
4. Lidhet në... fyt.
5. Inicialet e Camus.
6. Në kokë të xixëllonjës.
7. Fillojnë hapur.
8. Kishin flamur të zi.
9. Ndezur në aparatë.
10. U shkra nga Kipling.
11. Janë mistere për t'u zgjidhur.
12. Rastet pa set.
14. Ai ekzekutiv tani është bashki.
16. Eshhtë edkumi në palestër.
20. Grandi aktore.
21. Eshhtë gjarpër.
22. Një pëlhurë sintetikë.
23. I bëjnë testet me një set.
24. Një monument... për kujtim.
26. Adheu i Papa Eojtyla-s.
27. Mund të jenë me katër kohë.
29. Një ushtarak me... numër.
30. Emri i Salacrou.
35. Telefoni në kartvizitë.
37. Numri i oktetit.
38. Kukulla e Ibsen.
40. Thyhet me dy kafshata.
44. Rajone Autonome Lokale.
46. Ekstreme në ekstreme.
48. Mbyllin një manastir.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

			3	5		2	9		
		8	4		6		7		
	5	6	9			8			
5				2	9				3
2		9				6			4
1			6	3				5	2
		3			7	5	6		
	9		8		3	1			
	7	2		9	1				8

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9


Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	5	4	6	2	9	3	7	8
9	7	3	4	8	1	6	5	2
2	6	8	3	7	5	4	9	1
7	9	2	5	6	8	1	3	4
8	1	5	7	3	4	9	2	6
3	4	6	9	1	2	7	8	5
4	3	1	8	5	7	2	6	9
6	8	9	2	4	3	5	1	7
5	2	7	1	9	6	8	4	3

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm



PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

1. IMMANUEL
4. PARASHITESË
8. ARGENTO
11. GJYSMË
13. MAMECE
15. RASTET
16. DHOMË
18. RRAPO
19. GARDNER
20. CHARLIE MINGUS
21. ANTENË
23. TREGUT
24. UNDERI
26. FORMULA 1
28. SHQIPËRI
30. ÇERÇIZ TOPULLI
32. PORTA
35. AKTORË

FJALËKRYQI (2)

1. HOKARTARI
8. LOJA
13. KAAS
14. MALARIA
15. OPERA
16. FORMALITETE
17. LEGJENDA
18. KONAKI
19. KATASTROFA
24. LUAJTURIT
25. MPIRJA
27. QIPELLORË
28. KAOSI
29. HËNË
30. ATLETIKË
31. BETON
32. TIRANË

33. NJË METËR
34. NJË STACION
36. NJË ALFABETI
39. NJË PJESË
41. NJË TRAJNER
42. NJË ARENË
43. NJË UNIKITET
45. NJË BOTË
47. NJË SHTYPSË
49. NJË TOTALE
50. NJË MANASTIR

Argëtim filozofik

- Mërzitja është një humbje kohe ... asgjë nuk ndryshon, me përjashtim ngatërrimin e mendimeve dhe vjedhjen e lumturisë tuaj !!!

- Gjithkush dëshiron të shkojë në parajsë, por askush nuk dëshiron të vdesë.

- Fjalët i zgjedhin ata që shkruajnë. Kuptimin, ata që lexojnë.

Thënie të mençura

- Kur bëni një zgjedhje, mos mendoni nëse kjo është e drejtë apo e gabuar ...
- Mendo të jetë vetëm ajo që me të vërtetë ti dëshiron!!!
- Më mirë të heshtësh për njëqind gjëra që duhet të flasësh, se sa të flasësh për një gjë që duhet të heshtësh.

